



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 38/2024 regjistër (JR)
Datë 15.10.2024

Nr. 6 i vendimit
Datë 21.01.2026

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 21.01.2026, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Neritan Hoxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 786, datë 18.07.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Neritan Hoxha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilave rezultoi si më poshtë:

2.1. ILDKPKI-ja dërgoi pranë Komisionit *aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Neritan Hoxha*¹, ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procedurave të kryera nga grupi i punës, fillimisht dërgoi raportin² në të cilin konstatoi përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Neritan R. Hoxha. Pas kërkesës së Komisionit, DSIK-ja, në vijim të të dhënave shtesë nga autoritetet verifikuese, në raportin e përditësuar nr. {***} prot., datë 23.01.2023,³ ka ndryshuar konstatimin fillestar, nga përshtatshmëri, në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Neritan Hoxha.

2.3. KLP-ja, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit një raport⁴ të

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 31.12.2019, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Neritan Hoxha, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Neritan R. Hoxha”, deklasifikuar plotësisht nga Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZh), me vendimin nr. {***}, datë 14.10.2022.

³ Raporti i deklasifikuar pjesërisht nga KDZh-ja me vendimin nr. {***}, datë 30.01.2023.

⁴ Raporti nr. {***} prot., datë 07.02.2023, “Për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha”.

hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, i hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, të dhënave e dokumenteve që e shoqërojnë atë, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të KLP-së, Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore etj.

3. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit të kryer për të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 786, datë 18.07.2024, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Hoxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbështetur në konkluzionet si më poshtë:*

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë vetting, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*iii. Subjekti ka kryer deklaram të rremë në lidhje me çmimin e pasurisë të blerë në {***}, Elbasan, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.*

iv. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

v. Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurive në pronësi / posedim / përdorim, në kuptim të nenit D/5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

Në lidhje me të dhënat e administruara nga ana e organeve ligjzbatuese, ato janë trajtuar në pjesën e vlerësimit profesional, për rrjedhojë, Komisioni e sheh të panevojshme për të analizuar pretendimet e subjektit në lidhje me këtë kriter, për sa kohë nuk i ka kaluar barrën e provës.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Shkeljet e konstatuara [...] nuk janë të tilla, që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

3.4. Në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë:

Në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4,

paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i këtij sistemi.

Në këto rrethana përfshihet problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë [...], që lidhen me: (i) deklaratimet kontradiktore të subjektit në lidhje me kohën e njohjes me bashkëjetuesen e tij, si dhe përpjekjen për të përjashtuar veten e tij nga përgjegjësia në lidhje me pasuritë e krijuara prej saj; (ii) depozitimin nga ana e tij të deklaratave noteriale të cilat nuk përputhen me vetë deklaratimet e subjektit, por as me dokumentacionin e administruar nga Komisioni; (iii) deklaratimet kontradiktore në lidhje me të ardhurat dhe pasuritë e prindërve të tij; (iv) mungesën e burimeve të ligjshme të pasurive, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se nuk mund të përbëjnë shkak më vete për shkarkimin e subjektit. Në këtë vlerësim të Komisionit, mbahet në konsideratë sjellja e subjektit në lidhje me pasuritë e regjistruara formalisht në pronësi të prindërve të tij, për të cilat, nga hetimi rezultoi se subjekti ka tentuar t'i fshehë ose t'i paraqesë në mënyrë të pasaktë këto pasuri, duke deklaruar të dhëna të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të tij dhe, për pasojë, Komisioni ngriti dyshime se këto pasuri mund të jenë në pronësi / posedim të fshehur të subjektit të rivlerësimit, por, për shkak se nuk u provua plotësisht ky dyshim, ato do të konsiderohen në tërësi të rivlerësimit të subjektit.

Gjithashtu, subjekti ka shfaqur mangësi të theksuara në lidhje me vlerësimin profesional, [...], mangësi të cilat, në këndvështrim të Komisionit, nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të Magjistraturës.

Në vlerësimin e Komisionit, këto rrethana do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash, mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.

II. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

4. Kundër vendimit nr. 786, datë 18.07.2024, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, duke i kërkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”): (i) kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes; (ii) shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave; (iii) ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha.

4.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se përfundimet e arritura nga Komisioni janë tërësisht të gabuara dhe nuk mbështeten nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ. Shkaqet themelore të ankimit lidhen me gabimet në përcaktimin e fakteve, analizën e provave dhe interpretimin e zbatimit të ligjit nga Komisioni në dhënien e vendimit. Në tërësinë e tyre, gabimet faktike dhe ligjore të vendimit të Komisionit janë aq të rënda sa e bëjnë vendimin “tepër arbitrar” dhe “rast të drejtësisë së mohuar”. Për këto arsye, subjekti i drejtohet Kolegjit për korrigjimin e këtyre gabimeve, duke mbajtur parasysh të drejtën themelore kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në respektim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”).

4.2. Shkaqet procedurale të ankimit, në mënyrë të përmbledhur, lidhen me pretendimet se vendimi objekt ankimi është marrë: (i) në shkelje të parimeve të përcaktuara në nenet 6 dhe 8 të KEDNj-së, si dhe nenin 42 të Kushtetutës, për një proces të rregullt ligjor; (ii) në interpretim të gabuar të provave të administruara; (iii) në një frymë të theksuar paragjykimi kundrejt subjektit të rivlerësimit, të inicuar me barrën e provës dhe, më tej, me mënyrën e zhvillimit të procesit në seancën dëgjimore; (iv) në cenim të dinjitetit të personit, duke paragjykuar që çdo pasuri e krijuar nga rrethi i tij i familjes përbën pasuri të fshehur të subjektit, dyshim që nuk u provua, por që u konsiderua në vlerësimin tërësor të procesit të tij; (v) në vlerësim të gabuar të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

4.3. Shkaqet e ankimit, që i përkasin themelit të çështjes lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, do të analizohen në rubrikat respektive të këtij vendimi, për secilën pasuri dhe dosje penale të trajtuar.

5. Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, (në vijim “ligji nr. 49/2012”), subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrime lidhur me ankimin ndaj vendimit objekt shqyrtimi, në të cilat i përmbahet shkaqeve të ngritura në ankim. Me këto parashtrime, subjekti ka paraqitur akte shkresore, të cilat kërkon të administrohen në cilësinë e provës në këtë proces.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit për rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

7. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt shqyrtimi, e cila po gjykohet mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha, kundër vendimit nr. 786, datë 18.07.2024, të

Komisionit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazën e dokumenteve.

9. Trupi gjykues i Kolegjit, fillimisht analizoi shkaqet procedurale të ankimit, të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe respektimin e jetës private e familjare, parashikuar nga neni 6, pika 1, dhe neni 8, të KEDNj-së, duke vlerësuar si vijon:

9.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se, Komisioni ka vepruar në shkelje të parimit të sigurisë juridike, në drejtim të mosrespektimit të jurisprudencës së institucioneve të rivlerësimit, si dhe në shkelje të parimit të ligjshmërisë, për shkak të ekzistencës së gjykimeve të kundërta dhe, si rrjedhojë, shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, për respektimin e jetës private.

9.1.1. Për mënyrën se si iu ngarkua barra e provës⁵, subjekti i rivlerësimit në ankim shprehet se kishte pritshmëri legjitime të zbatohet jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit dhe e Komisionit, sipas së cilës, subjektet e rivlerësimit nuk kishin pasur përgjegjësi disiplinore. Referuar qëndrimin të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”)⁶, Komisioni, si çdo gjykatë, duhet të miratojë një qasje dinamike dhe evolutive, dhe se çdo shmangie nga jurisprudenca duhet të shoqërohet me një deklaratë thelbësore të arsyeve që kërkojnë largimin nga qëndrimet e mëparshme. Dështimi i Komisionit për të dhënë arsye bindëse për largimin nga praktika e mëparshme e ekspozon atë ndaj kritikave për standard të dyfishtë, duke minuar kështu besimin e publikut në procesin e *vetting*-ut. Në ankim, subjekti sjell në vëmendje jurisprudencën⁷ e Komisionit dhe Kolegjit për qëndrimin e mbajtur lidhur me përdorimin e kursimeve të prindërve, të cilët nuk kanë qenë subjekte deklaruese.

9.1.2. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij, sjell në vëmendje se pretendime të tilla nuk përbëjnë shkak *a priori* për të konsideruar të padrejtë vendimin e Komisionit. Çdo vendimmarrje e ankimit e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, në përputhje me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij, bazuar në veçantitë e fakteve dhe rrethanave të çështjes në shqyrtim dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike. Komisioni, në zbatim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, ka të drejtën të analizojë dhe të evidentojë saktë marrëdhënien juridike, që lidh subjektin e rivlerësimit me pasuritë e evidentuara në këtë proces, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane, që mund të ngrejë dyshime se këto pasuri mund t’i përkasin subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të. Kjo praktikë është në përputhje me qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar dhe nuk duhet perceptuar si paragjykim apo standard i dyfishtë ndaj subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë, sa i përket vlerësimit për çështjet e shtruara në ankim, që lidhen me pasuritë e krijuara para emërimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, përpara njohjes së tij me bashkëjetuesen apo vlerësimit si të ligjshme të kursimeve dhe të ardhurave, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, vlerës provuese të deklarimeve dhe akteve shkresore, apo

⁵ Lidhur me: i) pasuritë e prindërve apo të bashkëjetueses, të cilat Komisioni i ka konsideruar pasuri të fshehura; ii) pasaktësitë e kryera në deklaratat periodike vjetore, për të cilat nuk konstatohet pamjaftueshmëri financiare; iii) kursimet e krijuara nga punësimi i prindërve, të cilët nuk kanë qenë subjekte deklaruese; iv) të ardhurat të cilat provohen tej çdo dyshimi se janë krijuar prej tyre apo të ardhurat e bashkëshortes/bashkëjetueses.

⁶ Shih çështjet “Atanasovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, nr. 36815/03, prg. 38, 14 prill 2010; “Domenech Aradilla dhe Rodriguez Gonzalez kundër Spanjës”, nr. 32667/19 dhe nr. 30807/20, janar 2023, ende jo përfundimtare.

⁷ Vendimet nr. 185, datë 23.07.2019, nr. 327, datë 23.12.2020, të Komisionit; vendimi nr. 26/2023 (JR), paragrafi 14.10, i Kolegjit; vendimi nr. 20/2023 (JR), paragrafët 11.5 - 11.10, i Kolegjit.

interpretimin e shkakut të shkarkimit, “cenim i besimit të publikut”, ato do të analizohen nga trupi gjykues gjatë trajtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me themelin e vlerësimit të pasurisë. Në vijim të arsyetimit më sipër, lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, e parashikuar nga neni 8 i KEDNJ-së⁸, trupi gjykues nuk konstaton që veprimet/procedura e ndjekur nga Komisioni të tejkalojë qëllimin e procesit të rivlerësimit e të kenë cenuar këtë të drejtë të subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

9.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vendimi i Komisionit për dhënien e një mase ekstreme disiplinore, atë të shkarkimit nga detyra, është bazuar në doza të larta paragjykimi, duke cenuar subjektin e rivlerësimit, jo vetëm në drejtim të karrierës individuale, por edhe në drejtim të dinjitetit njerëzor dhe në dimension familjar. Arsyetimi i vendimit të Komisionit përmban në vetvete konkluzione kontradiktore, argumente të paqarta, në shkelje të hapur të një procesi të rregullt ligjor, të cilat, jo vetëm nuk gjejnë mbështetje në kuadrin ligjor të procesit të rivlerësimit, por janë marrë në interpretim të gabuar dhe paragjykues të provave të hetuara dhe të paraqitura nga subjekti përgjatë procesit, të cilat janë në harmoni dhe në përputhje me vetë deklaratimet e tij dhe me qëllimin e procesit të rivlerësimit.

9.2.1. Në analizë të këtij shkakut ankimor, trupi gjykues vëren se subjekti pretendon përdorimin nga Komisioni të shprehjeve me konotacione negative, me tendencë paragjykimin e përgjigjeve të tij, ndërkohë që përmbajtja e vendimit objekt ankimi e bën të pabazuar këtë pretendim. Trupi gjykues konstaton se Komisioni e ka bazuar vlerësimin e tij në provat e administruara dhe legjislacionin e zbatueshëm, duke evidentuar, sipas rastit, deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, të cilat, në vlerësim të tij, kanë afektuar besueshmërinë e qëndrimeve të mbajtura nga subjekti i rivlerësimit, sa i përket pasurive, të ardhurave dhe çështjeve të tjera të trajtuara në të. Hetimi administrativ në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha dhe disponimi i Komisionit në përfundim të procedurave të tij duket që është shtrirë brenda kufijve ligjorë të parashikuara në këtë proces, pa pasur qëllimin për të paragjykuar çështjen apo cenuar dinjitetin njerëzor apo familjar të subjektit të rivlerësimit.

9.2.2. Lidhur me pretendimin se Komisioni shfaq dukshëm qëndrime kontradiktore në vendimmarrjen e tij, subjekti referon se: (i) në pjesën më të madhe të konkluzioneve të arritura, Komisioni shprehet se *konkluzioni nuk mund të përbëjë shkak autonom për shkarkim*, ndërkohë, në përfundim, disponon me masën ekstreme disiplinore; (ii) Komisioni parashton se *subjekti ka qenë bashkëpunues përgjatë procesit të rivlerësimit*, ndërkohë, në vijim të vendimit, shfaq *pakënaqësi* për bashkëpunimin e subjektit, dyshime të ngritura *a priori* dhe pa një bazë të arsyeshme logjike mbi sjelljen e subjektit, dhe përgjigjet e dhëna prej tij.

9.2.2.1. Nga analizimi i vendimit objekt ankimi, trupi gjykues vëren se për secilin nga konstatimet, përkatësisht: (i) mungesën e konstatuar të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së ndodhur në {***}, Tiranë, të blerë në vitin 1998, kohë në të cilën subjekti nuk ka qenë në detyrë; (ii) deklaratimet kontradiktore lidhur me kohën e njohjes me bashkëjetuesen, në raport me përpjekjet e subjektit për t'u shmangur nga përgjegjësia në lidhje me apartamentin në

⁸ “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.

emër të bashkëjetueses në Elbasan, shitja e të cilit ka shërbyer për krijimin e pasurisë së saj në rrugën “{***}” Tiranë në vitin 2015; (iii) pasaktësinë në mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting* të huas prej 100.000 lekësh, të marrë nga i vëllai, G. H., Komisioni e ka vlerësuar si të pamjaftueshme për një shkak autonom shkarkimi nga detyra dhe e ka marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë/vlerësimin tërësor të procedurave, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016⁹. Në dritën e kësaj dispozite ligjore, Komisioni ka vlerësuar edhe mungesën e burimeve financiare për pagesën e këstit të parë për pasurinë “apartament”, të ndodhur në {***}, Tiranë, mungesën e burimeve financiare për blerjen e automjetit në vitin 2012, apo konstatime të tjera të evidentuara në vendimin objekt shqyrtimi. Në vlerësim të trupit gjykues, praktika e ndjekur nga Komisioni nuk tregon asnjë qëndrim kontradiktor dhe vjen në përputhje me qëllimin e kësaj dispozite ligjore, dhe jurisprudencën e deritanishme të institucioneve të rivlerësimit. Problematikat të cilat nuk kanë pasur një peshë apo ndikim ligjor, të atij niveli sa të bëjnë të zbatueshëm në mënyrë autonome një shkak shkarkimi nga detyra, janë mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit përkatës apo vlerësimit tërësor të çështjes/procedurave.

9.2.2.2. Sa i përket çështjes së bashkëpunimit, trupi gjykues konstaton se në paragrafin 23 të vendimit objekt shqyrtimi, Komisioni shprehet se subjekti *ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ*. Në vijim të vendimit, në paragrafët 161 dhe 185, Komisioni ka vlerësuar përkatësisht se: (i) lidhur me kredinë në shumën 3.100.000 lekë, të financuar nga NBG ShA, *subjekti i rivlerësimit nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin, në kuptim të nenit 48 të po këtij ligji*, pasi ka tentuar të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë kredi, nëpërmjet deklarimeve kontradiktore, të cilat e kanë bërë të pamundur dhënien e një vlerësimi të plotë për këtë kredi; (ii) lidhur me deklarimin pranë NBG Bank të apartamentit në rrugën “{***}” si adresë banimi, *refuzimi për të dhënë shpjegime nga ana e subjektit duhet të klasifikohet sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, si dhe do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë*. Ndonëse *prima facie*, konkluzionet e Komisionit në këtë drejtim duket sikur kundërshtojnë njëri-tjetrin, për vetë pozicionimin e tyre në këtë vendim, duket se i referohen vlerësimit të Komisionit për aspekte të ndryshme të procesit. Më konkretisht, në aspektin formal, Komisioni e konsideron bashkëpunues subjektin për disponibilitetin e tij për t’iu përgjigjur pyetjeve dhe dhënë shpjegime mbi barrën e provës brenda afatit kohor të lënë në dispozicion, ndërsa mungesën e bashkëpunimit e konstaton në aspektin substancial, në deklaratimet e paplota dhe qëndrimet konkrete të mbajtura nga subjekti i rivlerësimit në dy rastet e sipërpërmendura. Në këto kushte, trupi gjykues nuk i vlerëson kontradiktore konkluzionet e Komisionit në vendim e, aq më pak, dyshime të ngritura pa një bazë të arsyeshme logjike mbi sjelljen e subjektit dhe përgjigjet e dhëna prej tij, siç pretendohet në ankim.

9.3. Në vijim të ankimit, subjekti pretendon se shkarkimi i tij nga detyra nuk gjen mbështetje në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi është bazuar vetëm në rrethana paragjykimi, si dhe duke i kaluar barrë prove që tejkalon frymën dhe qëllimin e procesit. Në vlerësimin dhe interpretimin sistematik dhe logjik që i bëhet Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nuk

⁹ “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

mund të zbatohet si sanksion ndaj subjekteve të rivlerësimit masa disiplinore e parashikuar nga neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, nëse organet verifikuese nuk gjejnë dëshmi pozitive se subjekti ka paraqitur të dhëna të rreme, me qëllim fshehje të pasurisë. Konkluzioni i Komisionit se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe “tentativë” të fshehjes së pasurisë, edhe pse në referim të vetë Komisionit, “të pavërtetuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm”, në rastin konkret, është tërësisht i pabazuar, për pasojë, nuk mund të përlligjë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

9.3.1. Trupi gjykues sjell në vëmendje se interpretimi mbi zbatueshmërinë e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, gjendet i trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit. Gjithashtu, vëren se Komisioni në vendim ka arsyetuar konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe është gjendur në kushtet e parashikuara nga shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni, të cilat, për pasojë, bëjnë të zbatueshëm një shkak shkarkimi nga detyra, siç është neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, deklarimi i pamjaftueshëm i kriterit të pasurisë. Po kështu, në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes, Komisioni ka gjetur të mjaftueshme problematikat e konstatuara për të zbatuar edhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur objekt i analizës në Kolegj është vlerësimi nëse subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, dhe nëse konkluzioni i arritur nga Komisioni është i bazuar në ligj dhe në prova, vlerësimi i trupit gjykues do të jepet në përfundim të analizimit të shkaqeve të ankimit që i përkasin themelit të çështjes.

9.3.2. Lidhur me referencat në qëndrimin e mbajtur nga GjEDNj-ja në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”¹⁰ dhe në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”¹¹, që, sipas subjektit të rivlerësimit, janë të aplikueshme në rastin e tij, trupi gjykues sjell në vëmendje që Kolegji, në çdo rast, i është referuar qëndrimeve të mbajtura në jurisprudencën e tij dhe vendimeve të GjEDNj-së, të dhëna në kuadër të procesit të rivlerësimit, për aq sa ato gjejnë zbatim në rastin objekt gjykimi, dhe i përgjigjen një situatë faktiko-juridike të ngjashme.

9.4. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka analizuar paragrafët e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, me pretendimin se parashikimeve të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, nuk mund t’u jepet një kuptim më i gjerë lidhur me shkarkimin nga detyra, sesa parashikon dispozita kushtetuese. Nga interpretimi sistematik i neneve 59 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se, për sa kohë neni 61, pika 1 e këtij ligji parashikon se shkarkimi nga detyra jepet si masë disiplinore kur subjekti ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe, në situatat kur Komisioni nuk gjen dëshmi pozitive për fshehje të pasurisë, ky është i vetmi shkak për të cilin mund të merret kjo masë disiplinore në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë. Nëse subjekti nuk ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, automatikisht do të konsiderohet se arrin nivel të besueshëm në këtë kriter, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, konkluzioni i Komisionit është i pambështetur në prova

¹⁰ Shih çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, “403. Gjykata vëren më tej se shkarkimi nga detyra është një sanksion i rëndë disiplinor – nëse jo më i rëndi – që mund të vendoset ndaj një individi. Marrja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon shqyrtimin e provave të qëndrueshme në lidhje me etikën, integritetin dhe aftësinë profesionale të individit në fjalë”.

¹¹ Shih çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, “85. [...] Në të njëjtën kohë, jo çdo rast i vogël mosrespektimi i regjimeve të deklaratave të pasurive apo çdo mospërputhje e parëndësishme midis shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme, duhet t’u japë jetë sanksioneve disiplinore të rënda, të tilla si shkarkimi nga detyra”.

dhe në parashikimet ligjore të cilat normojnë këtë proces. Argumentet dhe konkluzionet e Komisionit lidhur me pamjaftueshmërinë, deklarin e rremë dhe fshehjen e pasurisë nuk gjejnë mbështetje në asnjë prej akteve shkresore provuese.

9.4.1. Kolegji, në jurisprudencën¹² e tij prej më shumë se 8 (tetë) vitesh, ka konsoliduar qëndrimin e tij lidhur me aplikimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në raport me parashikimet e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në drejtim të arritjes së nivelit të besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, i përcaktuar në nenin 59, pika 1, shkronja “a” e po këtij ligji. Në rastin objekt shqyrtimi, si përmendur më sipër, për këtë kriter, Komisioni, ndër të tjera, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit është gjetur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, deklarin të rremë dhe fshehjes së pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, të cilat kanë bërë të aplikueshëm nenin 61, pika 3 e këtij ligji dhe, për pasojë, kanë cenuar nivelin e besueshmërisë së kërkuar për vlerësimin e pasurisë. Vërtet subjekti nuk gjendet në kushtet e deklarin të dyfishit të pasurisë së ligjshme sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, por secili nga paragrafët e kësaj dispozite, paraqet një situatë ligjore që përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

9.5. Nga analizimi i ankimit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, për kallëzimet/procedimet penale të trajtuara në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, ka pretenduar se Komisioni nuk ka arsyetuar se përse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe përse ai nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës. Duke mos parashtruar arsyet në të cilat ka mbështetur vendimin, Komisioni, sipas subjektit, jo vetëm ka shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe dhënien e një vendimi të arsyetuar, por edhe ka cenuar në thelb mundësinë e ankimit efektiv. Trupi gjykues, nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, nuk konstaton mungesë arsyetimi për konkluzionin e arritur. Për secilën çështje të trajtuar, Komisioni ka evidentuar gjerësisht prapësimet e dhëna nga subjekti mbi barrën e provës dhe, në përfundim, është shprehur nëse i gjen ato bindëse ose jobindëse. Trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit është i arsyetuar dhe nuk ka cenuar të drejtën e subjektit për ushtrimin e një ankimi efektiv. Për sa më sipër, pretendimi gjendet i pabazuar.

10. Ashtu si përmendur më sipër, së bashku me parashtrimet e paraqitura në Kolegji, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe një sërë aktesh shkresore, të cilat kërkon të administrohen në cilësinë e provës. Këto akte janë paraqitur për të mbështetur pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me: (i) aktivitetin e peshkimit të ushtruar nga babai; (ii) të ardhurat e subjektit nga projekti “{***}” i INSTAT-it; (iii) adresat e vendbanimit / vendqëndrimit të subjektit dhe prindërve; (iv) të ardhurat nga emigracioni; (v) kredinë e financuar nga NBG Bank në vitin 2009, në vlerën 3.100.000 lekë; (vi) të ardhura të nënës; (vii) akte mbi pronësinë e banesës në rrugën “{***}”, Tiranë.

¹² Shih ndër të tjera vendimin nr. 19/2019 (JR), paragrafi 22.15, vendimin nr. 39/2023 (JR), paragrafi 16.1, të Kolegjit.

10.1. Lidhur me aktivitetin e peshkimit të ushtruar nga babai, subjekti i rivlerësimit, përveç dokumentacionit të depozituar në Komision¹³, ka paraqitur edhe akte shtesë¹⁴, në drejtim të mbështetjes së pretendimeve mbi të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet.

10.2. Lidhur me të ardhurat nga projekti “{***}”, INSTAT, subjekti ka paraqitur: (i) vërtetim nr. {***} prot., datë 14.10.2025, Drejtoria e Arkivit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore; (ii) vërtetim nr. {***} prot., datë 13.10.2025, nga INSTAT, i cili vërteton se Neritan Hoxha ka qenë punonjës i kontraktuar në kuadër të regjistrimit të popullsisë dhe banesave, nga data 01.09.2002 – 16.09.2002; (iii) shkresë, “Për emërimin në punë, kontrollor i projektit {***}”, lëshuar nga INSTAT (pa numër, datë, vulë); (iv) kontratë pune, datë 01.09.2002, ndërmjet z. Neritan Hoxha dhe INSTAT, për periudhën 01.09.2002 – 15.09.2002; (v) vlerësim pune, datë 05.02.2002, lëshuar nga drejtori i INSTAT; (vi) printime nga *Youtube*, mbi procesin e

¹³ Aktet në Komision: 1) shkresë nr. {***} prot., datë 16.10.1992, e Këshillit të Rrethit Elbasan, për emërimin e z. R. H. drejtor në {***}; 2) leje peshkimi artizanal, datë 04.10.1993, për shoqërinë “{***}”, lëshuar nga Drejtoria e Peshkimit, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit; 3) vendim nr. {***}, datë 12.05.1995, i Gjykatës së Rrethit Tiranë, për regjistrimin si person juridik, të shoqërisë “{***}” ShPK; 4) plan biznesi për vitin 2009 “Për aktivitetin e prodhimit e tregtimit të peshkut”; 5) mandatarkëtimi nr. {***}, datë 28.06.1996, pagesë takse peshkimi; 6) mandatarkëtimi nr. {***}, datë 26.01.1998, për pagesën e lejes së peshkimit, 1998, nga F. F., R. H.; 7) mandatarkëtimi nr. {***}, datë 11.02.1997, për pagesën e lejes së peshkimit, 1997, nga F. F., R. H.; 8) veprim arke, Raiffeisen Bank, datë 14.12.2006, pagesë për licencë peshkimi, viti 2007, nga R. H., si person fizik; 9) veprim arke, Raiffeisen Bank, datë 06.03.2009, pagesë për licencë peshkimi, viti 2007, nga R. H., si person fizik; 10) mandatarkëtimi nr. {***}, datë 16.02.2000, për pagesën e lejes së peshkimit, 2000, nga F. F., R. H.; 11. Mandatarkëtim, Banka e Kursimeve, datë 16.04.2004, pagesë për licencë peshkimi, 2004, R. H.; 12. Vendimi nr. {***}, datë 13.02.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për regjistrimin si person fizik.

¹⁴ Akte të tjera shkresore: (i) kërkesë ankimore nr. {***}, datë 14.04.2003, e R. H., drejtuar Ministrisë të Bujqësisë dhe Ushqimit; (ii) kërkesat nr. {***}, datë 06.05.2003, nr. {***}, datë 03.12.2003, nr. {***}, datë 25.07.2005, drejtuar Ministrisë të Bujqësisë dhe Ushqimit / Drejtorisë së Peshkimit; (iii) kallëzim penal, datë 20.01.2006, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i R. H. kundër F. F. dhe M. H., për falsifikim dokumenti; (iv) vendimi nr. {***}, datë 16.01.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, për deklarimin fajtor të të pandehurit M. H., për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”; (v) kërkesë e R. H., drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për çregjistrimin e vendimit nr. {***}/2001; (vi) vendim nr. {***}, datë 19.12.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për çregjistrimin si persona fizikë të R. H., M. H. dhe F. F.; (vii) vendim nr. {***}, datë 31.03.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për regjistrimin person fizik të F. F.; (viii) plan biznesi, firmosur nga administratori R. H. “Mbi rritjen dhe tregtimin e peshkut në liqenin e Belshit, Elbasan, për vitet 2010 – 2015”; (ix) tabelë për të dhënat e liqeneve të Dumresë, për Ndërmarrjen e Rritjes dhe Zënies së Peshkut (shkrim dore); (x) lista e liqeneve ku ka ushtruar aktivitetin shoqëria “{***}” ShPK; (xi) dy leje higjieno-sanitare për objektin, dhënë R. H., për zënie peshku në Belsh, për vitin 1994 dhe 1996; (xii) mandatarkëtimi për pagesën e taksës së pastrimit, që i përket periudhës 1993 – 1995; (xiii) mandatarkëtimi nr. {***}, datë 05.04.1995, për arkëtimin e shumës 100.000 lekë nga administratori R. H., si kapital themeltar për krijimin e personit juridik, “{***}” ShPK; (xiv) mandatarkëtimi nr. {***}, datë 18.07.1995, dhe mandatarkëtimi nr. {***}, datë 18.12.1995, nga administratori R. H., për llogari të Degës Tatim-Taksa Elbasan; (xv) mandatarkëtimi nr. {***}, datë 18.12.1995, nga R. H., për llogari të Sigurimeve Shoqërore Elbasan; (xvi) mandatarkëtimi nr. {***} datë 24.09.1993, dhe mandatarkëtimi nr. {***}, datë 29.03.1995, arkëtuar nga R. H., për llogari të Drejtorisë së Metrologjisë dhe Kalibrimit; (xvii) dy dokumente fletëporosi, me nr. {***}, datë 07.04.1995, për pagesën nga R. H., për Drejtorinë e Higjienës; (xviii) kuitanca nr. {***}, datë 15.10.1993, për leje peshkimi “{***}” ShPK; (xix) vërtetim nr. {***}, datë 06.06.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; (xx) vendim, datë 01.03.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, që ka vendosur pranimin e kërkesës së R. H. për anulimin e vendimit “Për dënim administrativ”, nr. {***}, datë 27.07.2016, të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Elbasan; (xxi) vendim nr. {***}, datë 19.06.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit, për ndryshimin e vendimit të sipërcituar dhe rrëzimin e padisë.

regjistrimit të popullsisë; (vii) shkresë nr. {***} prot., datë 30.12.2025, INSTAT, se subjekti ka qenë pjesë e projektit {***} në qershor 2001, i paguar sipas legjislacionit.

10.3. Për të mbështetur pretendimet që apartamenti në emër të babait, në rrugën “{***}”, Tiranë, nuk është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimi dhe se ai ka filluar të banojë në këtë apartament prej vitit 2022, ka depozituar një sërë aktesh, për të provuar se në këtë apartament kanë banuar prindërit deri në shkëmbimin e apartamenteve mes tyre në këtë vit: (i) faturë tatimore, datë 31.07.2019, dhe tarifë transporti dhe instalimi, {***}; (ii) vërtetim nr. ekstra prot., datë 12.07.2021, Bashkia Përrenjas, për shlyerjen e detyrimit të kopshtit për fëmijët e tij, E. dhe E. H., për periudhën shtator 2019 – shkurt 2020; (iii) formularë regjistrimi, E. dhe E. H., shkolla “{***}”, Pogradec, viti shkollor 2021 – 2022; (iv) Pagesa bankare pranë OTP Bank, dega Pogradec, datë 27.10.2021, datë 12.01.2022, datë 16.02.2022, datë 05.04.2022, datë 21.06.2022, me përfitues {***}, “pagesë ushqimi dhe mësimdhënieje për E. dhe E. H.”; (v) formularë regjistrimi, {***}, datë 26.02.2011, Neritan Hoxha; (vi) formularë aplikimi për vizë kanadeze, për R. H. dhe N. H.; (vii) nxjerrje llogarie, datë 27.05.2020, Credins Bank ShA; (viii) fletë riparimi të klientit nr. {***}, datë 21.11.2016; (ix) shkresë nr. {***} prot., datë 27.11.2025, e “ASC” (“{***}”), së bashku me dokumentacionin bashkëngjitur, për vitin 2015, rezulton adresë te pallati “{***}”, ndërsa formulari i vitit 2020 rezulton me adresë te rr. “{***}”; (x) *email*-e të printuara nga adresa {***}@yahoo.com, datë 24.12.2015, 02.01.2016, 16.01.2016, 17.01.2016; (xi) shkresë nr. {***} prot., datë 18.12.2025, e “{***}”, së bashku me dokumentacionin bashkëngjitur, lëshuar nga “{***}”, CD; (xii) vërtetim nga Njësia Bashkiake nr. {***}, se R. H. është banor i kësaj njësie, rr. “{***}”; (xiii) kërkesë drejtuar INSTAT, datë 13.11.2025, dhe përgjigje nr. {***} prot., datë 03.12.2025; (xiv) formularë regjistrimi, “{***}”, datë 07.09.2011, së bashku me faturën nr. {***}, R. H.; (xv) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.06.2017 e z. R. H., dhe dokumente pronësie; (xvi) certifikatë garancie nr. {***}, datë 22.09.2013, për frigoriferin e blerë nga R. H.; (xvii) vërtetim, datë 15.01.2026, i kryeplakut të Njesisë Bashkiake nr. {***}, se R. H., nga viti 2009 deri 2022, ka banuar te rruga “{***}” (ish-{***}), kati {***}, në pallat {***}-katësh. Aktualisht banon në adresë të re, rruga “{***}”, kati {***}, pallati {***}-katësh.

10.4. Subjekti ka paraqitur akte shkresore lidhur me të ardhurat nga emigracioni: (i) shkresë nr. {***} prot., datë 13.10.2025, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, së bashku me procesverbalin e seancës, ku R. H. ka deklaruar se ka qenë emigrant në Greqi, 1997 – 2000; (ii) kërkesa, mandate postare, *email*-e, prokura, si në gjuhën shqipe dhe greke / anglisht, lidhur me kërkesat drejtuar Bankës Kombëtare të Greqisë, për informacion lidhur me llogarinë / depozitën bankare për periudhën janar 1998 – shtator 2000, një pjesë e të cilave dorëzuar më parë në Komision, ashtu si dhe kërkesa drejtuar Ambasadës së Greqisë, për pajisjen me vizë të R. H., dhe komunikimet elektronike për këtë qëllim. Lidhur me kredinë në vitin 2009, në vlerën 3.100.000 lekë, subjekti ka depozituar shkresën nr. {***} prot., datë 14.01.2026, të ABI Bank, së bashku me dokumentacionin, ndërsa, lidhur me të ardhurat e nënës, listën e pagesës së rrogave të personelit, {***} Belsh, gusht 1996. Për banesën në rrugën “{***}”, Tiranë, ka paraqitur kontratë shitblerje nr. {***}/{***} rep. / kol., datë 22.07.2008; dokumente të tjera pronësie; prokurë e përgjithshme dhe dokumente të tjera. Përpos sa më sipër, në listën e akteve bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti ka renditur: (i) aktin normativ nr. {***}, datë 23.03.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për qëndrimin e përkohshëm në shtëpi të të dënuarve”; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 13.10.2025, e Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan; (iii) foto e një arme të

ftohtë “thikë” në A3, lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 18.11.2018; (iv) kontratë shitje pasurie, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.2024, me objekt truall i ndodhur në {***}, Elbasan; (v) vërtetim nr. {***} prot., datë 14.01.2026, i Shkollës 9-vjeçare “{***}”, Belsh, lidhur me të dhënat për shkollimin e znj. A. H.

11. Nga analizimi i këtyre akteve, të paraqitura për herë të parë në Kolegj, trupi gjykues, përveçse konstatoi se jo të gjitha rezultojnë të jenë paraqitur në formën e duhur ligjore, vlerësoi se ato nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga nenet 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas së cilave, deri në pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja, ndaj, për këto arsye, nuk lejoi marrjen e tyre dhe i përjashtoi nga analiza e mëtejshme, në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes. Trupi gjykues vlerësoi se, edhe në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, marrja e këtyre akteve shkresore në cilësinë e provës është e panevojshme dhe e parëndësishme për vendimmarrjen e Kolegjit.
12. Lidhur me formën e shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, bazuar në analizën më sipër, vlerëson se nuk gjendet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, që do të legjitimonte kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike dhe, për rrjedhojë, vijoi shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të këtij ligji.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

*B/1 - Për pasurinë “truall me sipërfaqe 300 m²” dhe “shtëpi banimi mbi të, me sipërfaqe 100 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, {***}*

13. Komisioni ka arritur në përfundimin se *subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë, në shumën (-) 1.458.600,60 lekë. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016. [...] duke marrë në konsideratë faktin që është krijuar në vitin 1998, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrë, Komisioni vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme nuk mund të përbëjë shkak autonom për shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016.*
14. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton këtë konkluzion, me pretendimet se: (i) Komisioni në vendim ka trajtuar konstatimet e rezultateve të hetimit administrativ, duke mos marrë në konsideratë argumentet shteruese apo provat e plota shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të ardhurat e prindërve, që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. (ii) Për këtë pasuri, e cila nuk është krijuar me të ardhurat e subjektit, as gjatë ushtrimit të funksionit si prokuror, hetimi nuk mund të kryhet mbi bazën e së njëjtës metodologji, që organet e rivlerësimit përdorin për pasuritë e krijuara gjatë periudhës së rivlerësimit. (iii) Kontributi në familje, edhe nga të ardhurat nga emigracioni në Greqi, nuk lidhet drejtpërdrejt me provueshmërinë e këtyre të ardhurave, por me besueshmërinë e faktit se kjo pasuri është krijuar me punën, mundin e ndershmërinë e familjes së subjektit. Ndryshe nga sa pretendon Komisioni, sjellja e subjektit ka

qenë transparente dhe gjithëpërfshirëse, për të siguruar një informacion sa më shterues për të ardhurat e prindërve, pavarësisht se kjo sjellje është vlerësuar negativisht, duke ndikuar në vlerësimin tërësor të procesit. (iv) Përpjekja e subjektit për të përfshirë dhe sqaruar të gjitha burimet e familjes nuk përbën tendencë për “devijim” të burimit, pasi pasuria është krijuar përpara se ai të ishte magjistrat. (v) Komisioni nuk ka marrë në analizë dhe nuk ka argumentuar përse aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë fuqi provuese për të vërtetuar ekzistencën e aktivitetit të ushtruar nga babai, i cili ka qenë burimi kryesor i krijimit të të ardhurave të familjes së tij. Në mënyrë të padrejtë, Komisioni nuk ka përmendur në vendim raportin e kontrollit të ushtruar nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, lidhur me këtë aktivitet.

15. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

15.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pasuria nr. {***}, në z.k. {***}, Tiranë, përbërë nga truall me sipërfaqe 300 m² + 100 m² shtëpi banimi mbi të. Blerë në vitin 1998, në shumën 1.800.000 lekë, shtetasit Xh. H. Burimi: Kursime personale dhe familjare (pa filluar funksionin). Pjesa takuese: 100 %*”. Pasuria është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2004, pa specifikuar burimin e krijimit.

15.2. Kjo pasuri është përfituar me kontratën e shitblerjes (truall dhe shtëpi banimi) nr. {***}/{***} rep./kol., datë 28.05.1998, nënshkruar mes shitësit Xh. H. dhe blerësit Neritan Hoxha, kundrejt çmimit 1.800.000 lekë. Nga informacioni i përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2021, pasuria është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 17.06.1998.

15.3. Gjatë kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja më datë 21.03.2016¹⁵, i pyetur lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se është krijuar me kontribut të prindërve, pasi ai, në atë vit, ishte student. Blerja është bërë në emër të tij, duke qenë djali i madh i familjes, pasi babai, në atë periudhë ka qenë emigrant në Greqi dhe, për lehtësi procedurash, u arsyetua nga prindërit që veprimet të kryheshin nga ai. Kjo pasuri vazhdon të jetë e regjistruar në emër të tij, deri në momentin kur të bëhet rregullimi i pasurisë familjare. Sa i përket burimit të krijimit, subjekti ka sqaruar se kanë qenë të ardhurat nga shitja e apartamentit në Belsh, i privatizuar në emër të prindërve, si dhe të ardhurat nga emigracioni i babait dhe kursimet nga pagat. Në ILDKPKI, subjekti ka depozituar deklaratë dore të datës 23.03.2016, të babait R. H.¹⁶, i cili deklaron se në periudhën shtator 1997 deri në gusht 2000 ka qenë emigrant në Greqi. Në vitin 1998, ka blerë një shtëpi, por duke qenë se nuk ndodhej në Shqipëri, u ra dakord që shtëpia të blihej në emër të djalit dhe kështu figuron deri më sot.

15.4. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar *kursime personale dhe familjare*, ndërsa në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, ai pretendon si burim: të ardhurat nga shitja e apartamentit në Belsh, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.09.1996, në shumën 670.000 lekë; të ardhurat e babait nga ushtrimi i aktivitetit të

¹⁵ Referuar procesverbalit të datës 21.03.2016, “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 11.03.2021.

¹⁶ Në disa akte, emri i babait të subjektit rezulton “R.”, ndërsa në disa të tjera “R.”, që përputhet me aktet e Gjendjes Civile.

peshkimit; të ardhurat e babait në fondacionin “{***}”, të investuara në shoqëritë piramidale të asaj periudhe, si në vetë fondacionin “{***}”, në fondacionin “{***}” dhe shoqërinë huamarrëse “{***}”, ku janë përfutur të ardhura të konsiderueshme, sipas kushteve kontraktore të ofruara nga këto shoqëri në atë kohë; të ardhurat e subjektit, vëllait dhe babait të tij, nga puna si emigrantë në Greqi. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shtuar si burim edhe të ardhurat nga bursa e studimit, e përfutur nga Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan dhe Universiteti i Tiranës.

15.5. Trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim ka analizuar secilin nga burimet e krijimit, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1998.

15.5.1. Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti privat i babait nga peshkimi, për periudhën 1994 – 1998, trupi gjykues konstaton se, me të drejtë Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat në masën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

Së pari, subjekti nuk depozitoi dokumentacion për krijimin e këtyre të ardhurave, pagimin e detyrimeve tatimore dhe fitimin e realizuar, ndonëse gjatë hetimit administrativ në Komision paraqiti një numër të konsiderueshëm aktesh për të provuar që babai e kishte ushtruar në mënyrë të pandërprerë këtë aktivitet. Këto akte provojnë që babai i subjektit ishte emëruar drejtor i {***}, Belsh, më datë 15.10.1992, ndërmarrje e cila më pas u privatizua nga anëtarët e saj, duke ushtruar aktivitetin si shoqëria “{***}” ShPK, si dhe nga viti 1996, babai i subjektit ka ushtruar aktivitetin e zënies dhe tregtimit të peshkut në liqenin e Belshit, si person fizik, regjistruar me vendimin nr. {***}, datë 17.02.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar akte që i përkasin periudhës 1993 – 1995, të cilat lidhen me regjistrimin dhe aktivitetin e shoqërisë “{***}” ShPK, në të cilën babai i tij ka qenë administrator dhe një nga 13 bashkëpronarët e shoqërisë. Për sa i përket periudhës nën analizë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe akte, që i përkasin personit fizik “R. H.” për periudhën 1996 – 1998, të tilla si licencë akuakulture, e datës 22.03.1996, licencë peshkimi për vitet 1997 dhe 1998, formularë SB5 dhe formularë SV2¹⁷. Nga analizimi i akteve që përmbajnë të dhëna mbi të ardhurat, trupi gjykues konstaton se: (i) në formularin SVa, për shoqërinë “{***}” ShPK, të ardhurat e realizuara për vitin 1995 rezultojnë në vlerën 70.000 lekë për 13 bashkëpronarët, dhe nuk përcaktohet nëse këto të ardhura janë fitim neto dhe mbi to janë shlyer detyrimet tatimore; (ii) formularët SB5 dhe SV2 të personit fizik, për vitin 1996 dhe 1998, përfshijnë nën emrin e personit fizik edhe z. F. F., dhe në to nuk specifikohet që të ardhurat e realizuara përbëjnë fitimin neto pas shpenzimeve dhe shlyerjes së detyrimeve tatimore.

Së dyti, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se babai i tij, për periudhën shtator 1997 deri gusht 2000, ka qenë emigrant në Greqi.

Së treti, pretendimin e subjektit që marzhi i fitimit për vitet 1995 – 1999 të llogaritet 68.42%, sipas atij të rezultuar për periudhën 2015 – 2023, për të cilën ofrohen të dhëna nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, trupi gjykues e gjen të pabazuar, pasi nuk mund të aplikohet i njëjti marzh fitimi për periudha kohore të ndara prej 20 vitesh.

¹⁷ Formulari SB5, “Peshkim në ujërat e brendshme” për personin fizik, R. H. dhe F. F., për vitin 1996, 33 kv ballëgjërë dhe 6 kv krap; -- formulari SV2, për vitin 1998, për personin fizik, F. F. dhe R. H., të ardhura të realizuara: 150.000 lekë, sasia e peshkut: 15 kv; formulari SV2, po nga personi fizik, të ardhura të realizuara 640.000 lekë (ky formular rezultoi në nënshkruar vetëm nga F. F., si titullar i licencës); sasia e peshkut: 32 kv.

Së katërtri, mospërmendja nga Komisioni në vendim e raportit të kontrollit nr. {***} prot., datë 21.07.2006, të ushtruar nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion pranë Kryeministrisë, në lidhje me zbatimin e procedurave ligjore dhe administrative në dhënien e licencës së peshkimit z. F. F., dhe shtimit të emrit të tij në licencat e peshkimit të lëshuara për z. R. H. në vitet 1997 – 2001, nuk ndryshon vlerësimin për këtë rast. Sikurse konstaton edhe Komisioni, subjekti ka qenë i paqartë lidhur me përfshirjen e z. F. F. në aktivitetin e babait, pasi njëherë e paraqet atë si të punësuar nga babai dhe, nga ana tjetër, të ketë abuzuar me licencën në emër të tij. Referuar nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni gëzon diskrecion ligjor për vlerësimin e provave dhe, fakti nëse nuk citohen në mënyrë analitike apo vlerësohen ashtu sikurse pretendon subjekti, nuk dëshmon që nuk i janë nënshtruar analizimit apo vlerësimit.

Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson të mos konsiderojë në analizë financiare të ardhurat e pretenduara nga ky aktivitet i babait si burim krijimi për pasurinë e analizuar.

15.5.2. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shoqëria huamarrëse “{***}”, Komisioni ka vlerësuar se pretendimet e subjektit nuk mbështeten në prova, duke mos u ligjëruar kështu të ardhurat e përfituara nga firmat piramidale. Trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, që kërkon nga Kolegji të përfshijë shumën prej 1.200.000 lekësh në të ardhurat familjare për vitin 1996. Ashtu si edhe Komisioni, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht se në vendimin e pushimit të akuzës, marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2001, konkludohet se veprimet e babait të subjektit nuk përbëjnë veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, kjo nuk do të thotë që këto të ardhura, të pretenduara në shumën 1.200.000 lekë, të jenë të ligjshme. Subjekti ka pretenduar se kursimet e familjes dhe të ardhurat e babait në fondacionin “{***}” janë investuar në shoqëritë piramidale të asaj kohe, përfshirë këtë fondacion. Këtë shumë, subjekti është munduar ta provojë me 6 (gjashtë) mandate¹⁸ pa datë, të cilat nuk janë të firmosura dhe të vulosura nga fondacioni. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 26.04.2024, të Shoqërive Huamarrëse në Administrim, dhe akteve bashkëlidhur, rezulton se më datë 20.09.1996 është lëshuar nga fondacioni “{***}” autorizimi i Drejtorit të Përgjithshëm, i cili emëron z. R. H. misionar në filialin Belsh, por nuk disponohen të dhëna sa ka qenë periudha e punësimit dhe paga për këtë pozicion pune. Në këtë shkresë thuhet se nuk disponohen të dhëna se sa lekë janë arkëtuar në këtë filial nga misionari R. H., as informacion mbi numrin e kreditorëve apo tërheqjet prej tyre. Gjithashtu, nuk disponohen të dhëna nëse z. R. H. ka dorëzuar lekë te Fondacioni “{***}”, kurse personat Neritan, N. dhe G. H., si dhe M., P. dhe B. M. nuk rezulton të kenë kryer depozitim ose tërheqje në ish-firmat piramidale. Nga aktet e vëna në dispozicion nga subjekti, nuk evidentohet ndonjë e ardhur në formë page për R. H., ndonëse ai figuron si misionar në praktikën e procedimit penal. Në procesverbalin e datës 26.02.1997, në Drejtorinë e Përgjithshme të ish-Bankës së Kursimeve, nga ekspertët e saj, në prani të misionarit të filialit, z. R. H., citohet se janë kryer 80 pagesa përpara afatit, pa urdhër të presidentit të fondacionit “{***}” dhe, në mandate nuk ka asnjë

¹⁸ Mandat nr. {***} regj. nr. {***}, kësti 200.000 lekë, tatimi 5%, vlerë 10.000 lekë, përfituesi R. H.; mandat tërheqje nr. {***} regj., kësti 200.000 lekë, tatimi 5%, vlerë 10.000 lekë, përfituesi Neritan Hoxha; mandat tërheqje nr. {***} regj., kësti 200.000 lekë, tatimi 5%, vlerë 10.000 lekë, përfituesi G. H.; mandat tërheqje nr. {***} regj., kësti 200.000 lekë, tatimi 5%, vlerë 10.000 lekë, përfituesi N. H.; mandat tërheqje nr. {***}, regj., kësti 200.000 lekë, tatimi 5%, vlerë 10.000 lekë, përfituesi D. H.; mandat tërheqje, nr. {***} regj., kësti 200.000 lekë, tatimi 5%, vlerë 10.000 lekë, përfituesi A. H. (e cila, në vitin 1997, ka qenë vetëm 8 vjeçe).

shënim, as për datën, dhe as për urdhëruesin e pagesës. *Shuma e përfituar padrejtësisht mbi principalin për 80 rastet është 5.918.000 lekë [...] shumë e cila është dëm pasuror, shkaktuar fondacionit. Për 19 raste, nga misionari R. H. janë paguar, ai vetë, bashkëshortja, vëllai, fëmijët, kunata dhe, katër raste miqtë, ku padrejtësisht është përfituar shuma mbi principalin, 1.458.000 lekë. [...].* Babai i subjektit rezulton të ketë kthyer shumën 776.000 lekë, si dhe ka pranuar të kthejë shumën 1.089.000 lekë, në këto kushte rezulton e paqartë, arsyeja përse subjekti i rivlerësimit do të sillte këto prova, të cilat, përveçse të paqarta, nuk mbështesin pretendimet e tij. Duke ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi si Komisioni, trupi gjykues vlerëson se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen të ligjshme.

15.5.3. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit nga shitja e apartamentit në Belsh, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.09.1996, kundrejt çmimit 670.000 lekë, trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka përfshirë ato në analizën financiare kumulative të periudhës 1994 – 1998, të familjes së babait të subjektit, z. R. H., praktikë e njohur tashmë në jurisprudencën e Kolegjit. Në analizën e kësaj periudhe, janë përfshirë të gjitha veprimet e ndërmarra nga babai i subjektit, si shitja e banesës në Belsh, ashtu edhe depozitimi i shumës 500.000 lekë pranë shoqërisë “{***}”, një ditë më pas¹⁹. Pretendimet e subjektit se kjo shumë prej 500.000 lekësh ka burim të ndryshëm nga shitja e apartamentit në Belsh një ditë më parë, dhe se të ardhurat nga shitja janë ruajtur në banesë dhe kanë shërbyer drejtpërsëdrejti në blerjen pas dy vjetësh të pasurisë në Tiranë, mbeten në nivel deklarativ dhe të pambështetur në prova.

15.5.4. Lidhur me të ardhurat nga bursa e studimeve për vitin akademik 1996 – 1997, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, dhe për tri vitet akademike 1997 – 2000 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, trupi gjykues gjen të drejtë arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen e tyre në analizë financiare. Duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij²⁰, si dhe nisur nga vlera monetare e bursës së pretenduar prej 6.000 lekësh në muaj, akorduar për 9 (nëntë) muaj të vitit, dhe qëllimin për të cilën ajo akordohet, trupi gjykues vlerëson se kjo lloj mbështetjeje financiare, edhe nëse ekziston, nuk mund të pretendohet si ardhur/burim për krijimin e një pasurie.

15.6. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë “truall me sipërfaqe 300 m²” dhe “shtëpi banimi mbi të, me sipërfaqe 100 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, {***}, Tiranë, në vitin 1998. Ndryshe nga Komisioni, që duke marrë në konsideratë faktin që kjo pasuri është krijuar në një kohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrë, e ka vlerësuar këtë mungesë financiare në kuadër të vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues në Kolegj nuk vlerëson që ky konstatim të ndikojë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Ndonëse legjislacioni i posaçëm për rivlerësimin kalimtar nuk vendos kritere kohore lidhur me

¹⁹ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 26.04.2024, të Shoqërive Huamarrëse në Administrim, depozituar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se babai, R. H., ka depozituar pranë shoqërisë “{***}”, më datë 18.09.1996, shumën 500.000 lekë, nga të cilat janë tërhequr 160.000 lekë deri në janar 1997 dhe kanë mbetur gjendje 340.000 lekë.

²⁰ Në vendimin 9/2018 (JR), Kolegji ka arsyetuar se: “81. Bursa akordohet si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese, pa përfshirë luksin. Një ndër arsytet për të cilat edhe studentët punojnë gjatë të qenët në universitet, është për shkak të përballimit të shpenzimeve, për të cilat nuk është e mundur të përballohen vetëm me bursën e akorduar nga universiteti. [...]”.

provueshmërinë e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive në pronësi apo përdorim, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në vlerësimin e tij për këtë pasuri, trupi gjykues mban parasysh faktin se në momentin e krijimit në vitin 1998, subjekti i rivlerësimit ishte duke ndjekur studimet pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, dhe filloi detyrën si prokuror në vitin 2004, pra mbas gjashtë vitesh nga blerja e pasurisë, si dhe si burim për krijimin e kësaj pasurie, nuk rezultoi të kenë shërbyer të ardhura nga angazhimet apo punësimi i subjektit të rivlerësimit, për të analizuar të shkuarën e tij, në drejtim të integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike.

*B/2. Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 62,1 m²+ 14,5 m² verandë”, ndodhur në {***}, Tiranë*

16. Komisioni, për këtë pasuri ka arritur në përfundimin se subjekti rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën (-) 68.345 lekë, e cila nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.
17. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se Komisioni gabon kur arsyeton lidhur me përfshirjen e të ardhurave nga prindërit, pasi në asnjë rast, subjekti i rivlerësimit nuk e ka pretenduar një fakt të tillë. Në çdo lloj mënyrë analize, më vete apo bashkë me familjen, analiza financiare rezultoi me balanca pozitive përkatësisht, çka provon se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të plotë financiare për krijimin e depozitave, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, për blerje apartamenti, në masën 6.880 euro.
18. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

18.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi pasurinë “apartament me sipërfaqe 62,1 m² + 14,5 m² verandë”, ndodhur në {***}, Komuna {***}, Tiranë, kontratat e nënshkruara për përfitim të saj, pagesën dhe burimin e krijimit si *kursime personale, pa filluar funksionin, dhe kursime personale nga paga dhe depozita bankare, të deklaruara më parë pranë ILDKPKI-së, si dhe hua në NBG Bank, në shumën 20.000 euro*. Kjo pasuri rezultoi të jetë porositur nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes së datës 13.01.2007, nënshkruar me shoqërisë ndërtuese, “{***}” ShPK dhe porositësit, Neritan Hoxha, kundrejt çmimit 27.000 euro. Kësti i parë 6.880 euro është shlyer ditën e lidhjes së kësaj kontrate, me mandatarkëtimin nr. {***}, datë 13.01.2007. Në këtë kontratë nuk është përcaktuar se kur do të bëhet pagesa e kësaj kontrate, ndërsa kontrata përfundimtare e shitblerjes, nr. {***} rep., nr. {***} kol., është nënshkruar me palëve kontraktore më datë 28.12.2015.

18.2. Në deklaratën periodike vjetore 2007, subjekti ka deklaruar se ka tërhequr nga Tirana Bank ShA më datë 05.01.2007, 627.000 lekë, e përbërë nga depozitë dhe interesa të llogarisë, të datës 02.08.2005, datës 11.03.2005, datës 03.11.2004 dhe datës 15.12.2004. Po ashtu, ka deklaruar edhe kontratën e sipërmarrjes datë 13.01.2007, vlerën e shlyer 6.880 euro dhe gjendjen e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, prej 20.120 eurosh.

18.3. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ABI Bank ShA²¹, rezultoi se më datë 28.01.2008, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit, ka lidhur kontratën e kredisë, nr. {***} rep.,

²¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 18.09.2023, të ABI Bank ShA (ish-NBG Bank ShA).

nr. {***} kol., me NBG Bank ShA, nëpërmjet së cilës është financuar me 20.000 euro, me afat 15 vite, me qëllim blerjen/rikonstruktimit të një apartamenti në {***}, Komuna {***}. Në cilësinë e dorëzuesit rezultojnë R. dhe N. H. Nga llogaria e subjektit në NBG Bank ShA, më datë 26.02.2008 është disbursuar kredia në shumën 20.000 euro dhe, në të njëjtën ditë, subjekti ka transferuar 19.720 euro për pagesën e apartamentit.

18.4. Sa i përket këstit të parë prej 6.880 eurosh, ai është deklaruar dhe rezulton të jetë shlyer me tërheqjen nga subjekti i rivlerësimit, të shumës 627.000 lekë, nga depozita në emër të tij në Tirana Bank ShA, pranë së cilës janë kryer këto veprime bankare: (i) më datë 04.11.2004²², subjekti depoziton në arkë, me përshkrimin “Depozitë në arkë Neritan Hoxha”, shumën 200.000 lekë, të cilën e transferon në depozitë me afat maturimi 6 muaj; (ii) më datë 16.12.2004, subjekti depoziton në arkë, me përshkrimin “Depozitë në arkë Neritan Hoxha”, shumën 100.000 lekë. Këtë shumë e kalon në depozitë me afat maturimi 6-mujor; (iii) më datë 02.08.2005, nëna e subjektit, N. H., depoziton në arkë me përshkrimin “Depozitë në arkë, N. H.”, shumën 200.000 lekë. Këtë shumë e kalon në depozitë me afat maturimi 6-mujor; (iv) më datë 05.01.2007, subjekti i rivlerësimit ka kryer tërheqjen e plotë të shumës 627.000 lekë, të përbërë nga të tria këto depozitime pas maturimit.

18.5. Në rezultatet e hetimit administrativ, depozitimin prej 200.000 lekësh të kryer nga nëna e subjektit, Komisioni nuk e mori në konsideratë, në kushtet kur prindërit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për këtë depozitim, për rrjedhojë, i është kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit mbi konstatimin se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme, në vlerën 831.860 lekë (6.880 euro), për kryerjen e pagesës së këstit të parë të kësaj pasurie.

18.6. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij ka sqaruar se, si burim kanë shërbyer kursimet personale para fillimit të funksionit, nga pagesa e Shkollës së Magjistraturës, në shumën 772.790 lekë për periudhën tetor 2002 – shtator 2004. Subjekti, gjatë studimeve, pretendon të ketë punuar gjatë muajve prill 2001 – shtator 2002 në censusin 2001, i quajtur {***}, i organizuar nga INSTAT, por nuk ka mundur të sigurojë dokumentacion për të ardhurat e përfituara, pasi nga interesimi i bërë në këtë institucion, rezulton pagesa e sigurimeve shoqërore vetëm për 4 muaj, dhe jo për të gjithë periudhën. Po kështu, edhe kursimet nga paga si prokuror kanë shërbyer për krijimin e ½ të depozitës prej 100.000 lekësh, e krijuar më datë 15.12.2004, pra pasi kishte përfituar vetëm 2 (dy) paga nga puna si prokuror. Depozitat bankare të deklaruara më parë pranë ILDKPKI-së përfaqësojnë depozitat e çelura, ose para detyrës (2.000 USD më datë 28.07.2003) dhe 2 (dy) depozitat në USD dhe lekë pranë Tirana Bank ShA, të çelura dy javë pas fillimit të detyrës, më datë 03.11.2004.

18.7. Në vijim, subjekti ka sqaruar se, duke qenë në një ekonomi të përbashkët familjare me prindërit, pjesa më e madhe e bursës së Shkollës së Magjistraturës prej 772.790 lekësh është kursyer. Sa kohë ka qenë student në Shkollën e Magjistraturës, bursa ka qenë pjesë e të ardhurave familjare, të cilat, së bashku me çdo shpenzim tjetër, janë menaxhuar në mënyrë të përbashkët. Komisioni do të duhej të merrte parasysh të gjitha kursimet e subjektit nga Shkolla e Magjistraturës për depozitimin e shumës 2.000 USD, dhe për kontributin me ½ pjesë të depozitave të tjera. Mundësia për kursimin e bursës sipas subjektit, ka ardhur edhe për faktin se familja e tij ka mundur të mbulojë shpenzimet jetike familjare deri në fund të vitit 2004, që

²² Komisioni e ka konsideruar depozitën të çelur më datë 16.04.2004, ndërkohë që është çelur më 04.11.2004.

përkon me fillimin e detyrës. Subjekti gjithashtu kundërshton analizën e Komisionit, që tregon pamundësi financiare të familjes së subjektit. Kjo, sipas tij, vjen për arsye se Komisioni nuk merr në konsideratë asnjë të ardhur të babait nga aktiviteti i tij i peshkimit, ndërkohë që nëse merren parasysh këto të ardhura për periudhën 1994 – 2004, familja do të rezultonte me një mundësi të konsiderueshme për kursim. Subjekti pretendon se, si analiza financiare e familjes më vete, ashtu edhe ajo e subjektit të rivlerësimit, tregon qartësisht mundësi financiare për të krijuar kurse në krijimin e depozitave të subjektit, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë ndërtimore, në masën 6.880 euro.

18.8. Komisioni, për të mos rënduar pozitën e subjektit, ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare mundësinë për kursim të subjektit nga të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës, në vlerën 584.879.50 lekë, por nuk do të përfshijë të ardhurat e familjarëve të tjerë, për të cilat nuk provohet burimi i ligjshëm, pasi përfshirja e tyre në analizë do të rëndonte pozitën e subjektit. Trupi gjykues konstaton se rezultati negativ i Komisionit në vendim, prej (-) 68.345 lekësh për depozitimet në vitin 2004, vjen si rezultat i analizës për periudhën 2002 – 2004, të subjektit të rivlerësimit, në të cilën janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e tij jetike, si dhe ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, duke përfshirë të ardhurat e përfituara nga subjekti nga Shkolla e Magjistraturës dhe të ardhurat e përfituara pas emërimit në detyrë, sipas vërtetimeve përkatëse, shpenzimet jetike dhe ndryshimin e gjendjes së likuiditetit, trupit gjykues konfirmon mungesën e burimeve financiare (-) 68.345 lekë për depozitimet në vitin 2004, që kanë shërbyer për pagesën e kështit prej 6.880 eurosh. Mungesa e konstatuar nga Komisioni dhe e konfirmuar në Kolegj, për shkak të vlerës jodomethënëse të saj, nuk u mor në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

B/3. Për pasurinë “automjet” “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 2012, në vlerën 450.000 lekë

19. Komisioni ka vlerësuar se subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme, në shumën (-) 115.696 lekë, e cila nuk mund të shërbejë si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por duke marrë në konsideratë kryerjen e veprimeve të subjektit me automjetin tip “Ford, si dhe deklaratimet e tij kontradiktore, ky rezultat do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të pasurisë.
20. Subjekti i rivlerësimit në ankim për automjetin “Mercedes Benz” pretendon se, lidhur me pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2012, konkluzioni i Komisionit është i pasaktë. Subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit që të konsiderojë si burim për blerjen e automjetit, pakësimin e gjendjes *cash* që ai ka pasur në banesë nga viti 2011, ashtu sikurse ka deklaruar saktësisht në deklaratën e pasurisë *vetting*, në deklaratat periodike vjetore dhe në përgjigjet gjatë hetimit administrativ.
21. Nga analizimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si më poshtë:
 - 21.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Automjet, tip “Benz - Mercedes” [...], vit prodhimi 1998. Blerë në vitin 2012, në shumën 450.000 lekë. Burimi: kurse personale nga paga si prokuror dhe të ardhura nga shitja e mjetit, tip “Ford” [...]. Kjo pasuri është përfituar përmes kontratës së shitjes së pasurisë së luajtshme, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.07.2012, kundrejt çmimit 450.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.*

21.2. Në deklaratën periodike vjetore 2011, subjekti ka deklaruar: “*Shitje e mjetit, tip “Ford” [...] më datë 15.12.2011 [...] vlera 350.000 lekë*”; si dhe “*Gjendje në shtëpi, në vlerën 500.000 lekë, kursime nga paga + të ardhura nga qiraja e shtëpisë + të ardhura nga shitja e mjetit*”.

Në deklaratën periodike vjetore 2012, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, në vlerën 500.000 lekë, si dhe: “*Gjendje në shtëpi në vlerën 100.000 lekë, kursime nga paga*”. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se çmimi i blerjes së këtij automjeti është ai i cilësuar në kontratën noteriale, 450.000 lekë, por është deklaruar 500.000 lekë, duke përfshirë shpenzimet e disa shërbimeve që i ka bërë mjetit, si dhe shpenzime të tjera.

21.3. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2012, si burim krijimi për automjetin “Mercedes-Benz”, të ardhurat nga shitja e automjetit “Ford Fiesta”, apo të ketë deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në shtëpi, Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, nuk i ka përfshirë ato në analizë financiare, duke konstatuar mungesë burimesh financiare, në vlerën (-) 115.696 lekë. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ky konstatim nuk është i saktë. Në deklaratën periodike vjetore 2011, ai ka deklaruar shitjen e automjetit “Ford Fiesta”, në vlerën 350.000 lekë, si në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhimet”, ashtu edhe në rubrikën “Ndryshime të interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”. Në të njëjtën rubrikë, ka deklaruar: *gjendje në shtëpi, në vlerën prej 500.000 lekësh, kursime nga paga + të ardhurat nga qiraja e shtëpisë + të ardhura nga shitja e mjetit*. Në deklaratën periodike vjetore 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit “Mercedes - Benz”, si dhe gjendjen *cash* në shtëpi prej 100.000 lekësh, pra dukshëm, sipas tij, gjendja *cash* është pakësuar në shumën 400.000 lekë, si pasojë e blerjes së automjetit më datë 11.07.2012. Në këto kushte, subjekti pretendon se analiza financiare për mundësinë e blerjes së kësaj pasurie do të rezultonte me një balancë pozitive prej 422.028 lekësh.

21.4. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore, rezulton se për herë të parë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në shtëpi në vitin 2011, për të vijuar më pas në deklaratat periodike vjetore 2012 – 2016. Në secilën prej këtyre deklaratave, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar “shtesa apo ndryshime” të kursimeve *cash*, por gjendjen e tyre. Pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe formulari i deklarimit në rubrikën përkatëse, faqja 3 e formularit, që i përket pasqyrimit të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për [...] *ndryshimet (shtesa dhe pakësime) nga “deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit”, që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]*. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë, duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare, dhe mospërbushja e këtij detyrimi sillte pasoja për subjektet deklaruese.

21.5. Përpos sa më sipër, nga analiza financiare për vitin 2011, duke konsideruar gjendjen *cash* në shumën 500.000 lekë, dhe duke mos përfshirë të ardhurat nga qiraja e banesës ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, dhënë dajës, M. F., në shumën 150.000 lekë, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në vitin 2021, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në shumën (-) 217.994 lekë.

21.5.1. Komisioni, në lidhje me këto të ardhura nga qiraja, ka vlerësuar se subjekti nuk ka paguar në kohë detyrimet tatimore, detyrim të cilin e kishte në rolin e qiradhënësit, për sa kohë është një kontratë mes dy individëve. Subjekti ka qenë në dijeni të mospagimit të këtij detyrimi, pasi edhe në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar të ardhura në vlerën e plotë, pa u zbritur pagesën e detyrimeve tatimore, për rrjedhojë, bazuar edhe në orientimet e Kolegjit në vendimin nr. 15/2021 (JR), për sa kohë subjekti i ka paguar detyrimet tatimore me vonesë, e cila është shkaktuar nga veprimet e subjektit dhe jo nga mosdijenja e tij, të ardhurat nga qiraja nuk do të përfshihen në analizën financiare.

21.5.2. Subjekti i rivlerësimit në ankim, mospërfshirjen e këtyre të ardhurave e konsideron të padrejtë, jo vetëm në raport me faktet e hetuara, por edhe me rastet e tjera të rivlerësimit, të cilat, në të njëjtat kushte, janë njohur dhe arsyetuar ndryshe nga Komisioni. Kjo logjikë e ndjekur nga Komisioni për ligj pabarazinë përpara ligjit, cenon parimin e ligjshmërisë, po aq sa të mosdiskriminimit. Sipas subjektit, Komisioni, në ndryshim nga praktika e Kolegjit, vendos të mos i njohë këto të ardhura edhe në vendimmarrjen e tij, pavarësisht se subjekti ka prezantuar një sërë rrethanash të rëndësishme, që tregojnë arsyet e pagimit të tatimit me vonesë.

21.5.3. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se këto të ardhura subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar, si në deklaratën periodike vjetore 2011, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Me përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklarinimin e këtyre të ardhurave në datën 15.02.2021, pagesën e tatimit mbi to, gjobën mbi deklarinimin me vonesë, si dhe veprimet bankare pranë Credins Bank ShA, për pagesën e shumës 5.000 lekë, si gjobë për deklarinimin me vonesë dhe për pagesën e shumës 27.535 lekë (*detyrim principal + gjobë + interes*), për periudhën janar – dhjetor 2011.

21.5.4. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për konstatimin se *duket se këto detyrime janë paguar pas plotësimit të deklaratës vetting, për rrjedhojë, nuk do të përfshihen në analizë financiare*. Në prapësim të këtij konstatimi, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se, në kushtet e një marrëdhënieje dajë - nip, nuk është nënshkruar një akt shkresor/noterial, duke pasur parasysh që edhe dispozitat e nenit 803 e vijues të Kodit Civil nuk normojnë nënshkrimin e një akti të tillë. Sipas subjektit, ishte rënë dakord që tatimi të paguhej nga qiramarrësi, por duke qenë se ai ka ndërruar jetë, është e pamundur për subjektin të verifikojë nëse ky detyrim është paguar. Me qëllim që të tregonte kujdesin e duhur dhe në respektim të kuadrit ligjor të këtij procesi, subjekti ka paguar në vitin 2021 tatimin mbi të ardhurat, si dhe gjobën për vonesë në deklarinim. Në mbështetje të argumentit të tij, subjekti sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 26/2023 (JR), paragrafët 13.4 – 13.9, se të ardhurat e përfituara nga qiraja, të cilat janë deklaruar edhe në vitin periodik përkatës, në një periudhë kur ende nuk kishte iniciuar procesi i rivlerësimit kalimtar, pavarësisht se tatimi mbi to është paguar me vonesë, plotësojnë kushtet e burimit të ligjshëm, pasi këto të ardhura përmbushin standardin kushtetues dhe ligjor të së ardhurës së ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Sipas qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, por edhe nga Komisioni, që një e ardhur të konsiderohet e ligjshme, sipas dispozitave të mësipërme, kërkohet të plotësohen në mënyrë kumulative elementet, që dëshmojnë gjurmë të përfitimit të saj në kohën e krijimit, sikurse është deklarimi në deklaratën periodike vjetore, se është e ardhur e siguruar nga burime të ligjshme, e parashikuar nga legjislacioni për tatimin mbi të ardhurat, si dhe pagesa e detyrimeve tatimore për të, elemente që, në vlerësim të subjektit, janë përmbushur në rastin konkret.

21.5.5. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë qëndrimin orientues, në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të Kolegjit, në vendimin nr. 15/2021 (JR), se: 23. [...], në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit, duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie, apo një qëllim për t'u arritur.

Në vendimin nr. 26/2023 (JR) të Kolegjit, të përmendur nga subjekti, situata faktike paraqitet ndryshe, pasi ndërkohë që ish-in deklaruar në deklaratën periodike vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurat nga qiraja ish-in përcjellë nëpërmjet sistemit bankar, gjë që vërtetonte provueshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave, ndërsa në rastin konkret, ndonëse kjo e ardhur është deklaruar në deklaratën periodike vjetore, që në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerën e provës në këtë proces, edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, përsëri mbetet vetëm në nivel deklarativ. Ky konstatim përforcohet nga fakti se detyrimi për të paguar tatimin mbi të ardhurat nga qiraja është shprehur në mënyrë eksplicite në nenin 4, shkronja “g” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe ky detyrim i përket subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha, ndërsa në rastin e referuar, nuk ka qenë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e subjektit të rivlerësimit dhe se, ajo vetë apo bashkëshorti i saj, nuk ish-in palë në këtë marrëdhënie. Po kështu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri u përket prindërve dhe kontrata e shitjes është nënshkruar prej tij, si djali i madh i familjes, ndërkohë që babai ndodhej në Greqi, dhe që subjekti i rivlerësimit e jep me qira këtë pasuri, duke deklaruar si të ardhura të tij shumën e plotë të përfutur nga kjo marrëdhënie. Në këto kushte, ashtu si edhe Komisioni, trupi gjykues, në kontrollin e analizës financiare për vitin 2011, nuk i ka përfshirë ato në mesin e të ardhurave të ligjshme, duke konfirmuar mungesën e burimeve financiare prej (-) 217.994 lekësh për këtë vit. Rezultati negativ i analizës financiare të vitit 2011, afekton ligjshmërinë e gjendjen *cash* në shtëpi të deklaruar për këtë vit, dhe të pretenduar si burim për blerjen e automjetit në vitin 2012.

21.6. Për sa arsyetuar më sipër, nga kontrolli që trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, i ka bërë analizës financiare të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në diferencën negative të konstatuar nga Komisioni, (-) 115.696 lekë, për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, më 11.07.2012, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, mungesë e cila u mor në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

*B/4. Për pasurinë “tokë bujqësore me sipërfaqe totale 2.000 m²”, ndodhur në fshatin {***}, Elbasan, në bashkëpronësi*

22. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj; (ii) ka kryer deklaram të rremë në lidhje me

çmimin dhe kohën e blerjes së saj; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë, (duke mos deklaruar tokën “varosh”), në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “b”, “c”, dhe “ç”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

23. Subjekti i rivlerësimit në ankim kundërshton konkluzionet e Komisionit, duke i konsideruar ato të padrejta dhe të pambështetura në rrethanat faktike e ligjore të situatës konkrete. Subjekti pretendon se: (i) Çmimi i dakordësuar mes palëve në kontratën e shitblerjes, të datës 05.08.2013, është real dhe i vërtetë, dhe përputhet me çmimet e referencës së shitjes së trojeve në atë zonë, si dhe me çmimet e përcaktuara në kontratat e ngjashme të administruara nga subjekti në Komision. Vlera prej 6.000.000 lekësh nuk mundet kurrësi të përfaqësojnë çmimin real të paguar, sikundër konstaton Komisioni në vendim. (ii) Komisioni ka refuzuar t’i analizojë këto kontrata të vëna në dispozicion, me qëllim përmbysjen e barrës së provës për një çmim fiktiv të pretenduar nga Komisioni në kontratën e datës 05.08.2013. (iii) lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti ka fshehur pasurinë, tokë “varosh”, me sipërfaqe 1500-1700 m², Që një pasuri të jetë e tjetërsueshme, duhet të ekzistojë, dhe pala shitëse duhet të zotërojë një titull pronësie. Ndërkohë që, ndryshe nga sa pretendon Komisioni, kjo pasuri / sipërfaqe *varosh* nuk rezulton të jetë e regjistruar në emër të këtyre individëve dhe, për pasojë, referuar edhe parimit të përgjithshëm se askush nuk mund të transferojë të drejta të cilat nuk i ka, për pasojë, parashikimi i kësaj aktmarrëveshjeje është tërësisht i pavlefshëm. Pavarësisht analizës ligjore, aktmarrëveshja nuk është nënshkruar nga subjekti dhe ai nuk ka shfaqur asnjë vullnet ligjor apo faktik për të paguar një çmim të përcaktuar në të apo për të disponuar për një pasuri të konsideruar “varosh”. (iv) Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që analiza financiare të korrigjohet, duke llogaritur tokën “arë”, në {***}, në vlerën 115.150 lekë, dhe duke rezultuar me mundësi për kursime, në shumën 462.967 lekë.
24. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

24.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Pasuria nr. {***} në ZK {***}, ndodhur në fshatin {***}, Elbasan, përbërë nga “tokë bujqësore me sipërfaqe totale 2.000 m², bashkëpronar me 4 persona të tjerë. Blerë në vitin 2013. Sipërfaqja ime, 350 m² x 329 lekë/m² = 115.150 lekë. Zotërimi 17.5%. Burimi: të ardhura nga kursimet personale, nga paga si prokuror”.*

*Blerë 50 m² tokë bujqësore nga bashkëpronari, në pasurinë {***} ZK {***}, {***}, Elbasan. Blerë në vitin 2014, me vlerë 50 m² x 263 lekë/m² = 13.150 lekë. Gjithsej, në pasurinë {***} ZK {***}, sipërfaqe 400 m². Pjesa 20%. Burimi: të ardhura nga kursimet personale, nga paga si prokuror. Këto pasuri, subjekti i rivlerësimit rezultoi t’i ketë deklaruar, respektivisht në deklaratat periodike vjetore 2013 dhe 2014.*

24.2. Së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar aktet me të cilat ka përfituar këto pasuri, si vijon:

24.2.1. Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.08.2013, nënshkruar mes palës shitëse, A., L., A. dhe D. Sh., dhe palës blerëse, Neritan Hoxha, B. Ç., A. B., A. M. dhe A. Sh., me objekt pasurinë “tokë arë”, me sipërfaqe 2.000 m², e ndodhur në {***}, Elbasan, kundrejt çmimit 658.000 lekë (329 lekë/m²), likuiduar jashtë zyrës noteriale, përpara nënshkrimit të

kontratës së shitblerjes. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit ka përfituar sipërfaqen 350 m² të kësaj pasurie të paluajtshme.

24.2.2. Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.05.2014, përmes së cilës A. Sh. dhe L. L.²³ i shesin Neritan Hoxhës 50 m², B. Ç. 100 m² dhe A. B. 50 m², nga pjesa takuese në pasurinë “tokë arë” 2.000 m², në çmimin 52.600 lekë (263 lekë/m²). Referuar kësaj kontrate, përfundimisht Neritan Hoxha bëhet bashkëpronar në tërësi i pjesës 400/2000.

24.3. Nga hetimi i kryer në Komision, rezulton të jenë administruar edhe këto dokumente:

24.3.1. Aktmarrëveshje “Për shitblerje pasurie të paluajtshme”, datë 17.09.2012 (vërtetuar para noterit me nr. {***} rep., të po së njëjtës datë), nënshkruar mes shitësve, A. e D. Sh., dhe blerësit A. B., me objekt “premtim shitje të pasurive”: 1) “tokë arë”, me sipërfaqe 2.000 m², dhe; 2) varosh (“tokë arë” e trashëguar nga i ndjeri M. Sh.), me sipërfaqe afërsisht 1.500 - 1.700 m², e cila kufizohet me “tokën arë” të lartpërmendur, kundrejt çmimit 6.000.000 lekë. Nga kjo shumë, 5.000.000 lekë për sipërfaqen “tokë arë” 2.000 m² dhe 1.000.000 lekë për sipërfaqen “varosh”.

Në këtë aktmarrëveshje citohet: *Ne, të nënshkruarit, pala poseduese e pasurisë së mësipërme, familja Sh., posedojmë pasuritë objekt të kësaj aktmarrëveshje, për të cilat kemi rënë dakord me A. B., A. Sh., B. Ç., Neritan Hoxha dhe A. M., për shitblerjen e sipërfaqes 2.000 m², [...], si edhe një sipërfaqe “varosh” [...], me sipërfaqe afërsisht 1.500 -1.700 m² [...]. Këtë pasuri të paluajtshme, deklarojmë nën përgjegjësinë tonë ligjore e personale, se ia shesim A. B., A. Sh., B. Ç., Neritan Hoxha dhe A. M., përkundrejt vlerës totale 6.000.000 (gjashtë milion) lekë [...].*

Vlera totale prej 6.000.000 lekësh, në marrëveshje dypalëshe është rënë dakord të likuidohet: (a) kësti i parë në vlerën 1.500.000 lekë është likuiduar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare; (b) kësti i dytë në vlerën 500.000 lekë do të paguhet më datë 18.09.2012, nëpërmjet po kësaj banke; (c) vlera e mbetur pa paguar, prej 4.000.000 lekësh, do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës në emër dhe pronësi të palës blerëse. Në vijim të aktmarrëveshjes, thuhet: *Për sa më lart, unë, i nënshkruari A. B., në cilësinë e përfaqësuesit të A. Sh., B. Ç., Neritan Hoxha dhe A. M., deklaroj se e blejmë këtë pasuri të paluajtshme, të përshkruar më lart, duke mos pasur asnjë pretendim për gjendjen e pasurive.*

24.3.2. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.08.2013, e z. A. Sh., subjektit Neritan Hoxha dhe z. A. B., në të cilën subjekti dhe z. B. deklarojnë nën përgjegjësinë e tyre ligjore e personale se, *në lidhje me aktmarrëveshjen nr. {***} rep., datë 17.09.2012, i kanë likuiduar totalisht z. A. Sh. vlerën e shitjes për blerjen e sipërfaqes 2.000 m² “tokë arë” dhe “varosh”, të ndodhura në {***}, Elbasan, dhe nga ky moment, nuk kanë asnjë detyrim financiar ndaj tij, dhe çdo marrëveshje tjetër është e pavlefshme, deklarime këto që konfirmohen dhe nga z. A. Sh. Në fund të kësaj deklarate citohet: *Për sa më sipër, iu lexua me zë të lartë dhe të qartë deklaruesve dhe, meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre, nënshkruhet pa vërejtje para meje, noteres.**

24.4. Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, ndryshe nga sa është parashikuar në kontratën e shitblerjes, ka konstatuar se çmimi real i kësaj pasurie është 6.000.000 lekë, i cili rezulton të jetë paguar përfundimisht më datë 02.08.2013. Së bashku me këtë pasuri, rezulton të jetë blerë edhe një tokë “varosh”, e cila nuk rezulton e deklaruar nga subjekti në deklaratën e

²³ Me kontratën nr. {***} rep., nr. {***}, datë 19.06.2023, shitësi, A. Sh. dhe L. L., u shesin blerësve, M. M., Neritan Hoxha, A. B., B. Ç., E. Ç. dhe A. M., pjesën e tyre takuese në “tokën arë” (400/2.000 m²), me çmimin 444.000 lekë.

pasurisë *vetting*. Në këto kushte, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës me konstatimet se: (a) subjekti ka fshehur pasurinë “tokë”, me sipërfaqe 1.500 - 1.700 m², të blerë nga ana e tij në vitin 2012; (b) subjekti ka fshehur vlerën reale të blerjes së kësaj pasurie, në shumën 6.000.000 lekë; (c) subjekti ka kryer deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting* në lidhje me çmimin real të blerjes së kësaj pasurie; (ç) subjekti ka fshehur, duke mos deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2012 dhe në atë *vetting*, pagesën e kryer për këtë pasuri në vitin 2012; (d) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në vlerë totale prej 1.285.637 lekësh.

24.5. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

24.5.1. Konstatimet e Komisionit lidhur me këtë pasuri janë tërësisht të padrejta dhe të pambështetura në rrethanat faktike dhe ligjore të situatës konkrete. Kjo sipërfaqe është blerë prej tij dhe katër bashkëpronarëve të tjerë, me të cilët ka një miqësi të përbashkët. Duke qenë se pagesa për këtë pasuri është kryer 3 (tre) ditë përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes 05.08.2013, me qëllim pasjen e një dokumenti për të vërtetuar pagesën e çmimit, është nënshkruar paraprakisht deklarata noteriale e datës 02.08.2013. Subjekti ka shpjeguar se me aktmarrëveshjen e datës 17.09.2012 është njohur për herë të parë vetëm me rezultatet e hetimit administrativ dhe, më datë 26.06.2024, i ka kërkuar Komisionit vënien në dispozicion të këtij akti. Aktmarrëveshja nuk është nënshkruar nga subjekti, por vetëm nga z. A. B., i cili nuk ka pasur asnjëherë tagra përfaqësimi për të disponuar në emër të tij, as në momentin e nënshkrimit të kësaj, dhe as më pas. Bashkëlidhur aktmarrëveshjes, por edhe për vitet 2011 – 2012, nuk rezulton të ketë akt përfaqësimi/prokurë për z. A. B., nga z. Neritan Hoxha. Subjekti nuk ka aprovuar në asnjë rast një vullnet të tillë për të blerë këtë pasuri me çmimin e përcaktuar në aktmarrëveshje.

24.5.2. Kjo aktmarrëveshje është një akt absolutisht i pavlefshëm, si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja, pasi kalimi i presupozuar i të drejtave mbi sendin pasuri e paluajtshme kërkon detyrimisht realizimin e tij në formë noteriale, shfaqjen e vullnetit të subjektit nëse do të ekzistonte, si dhe do të duhej të kishte një shkak ligjor të bazuar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesëmarrës as në këtë akt, dhe as në vërtetimin e nënshkrimit të tij. Nga interpretimi logjik dhe sistematik i neneve 676 dhe 690 të Kodit Civil, nuk rezulton që të ekzistojë vullneti i brendshëm i subjektit të rivlerësimit dhe ky vullnet të përputhet tërësisht me shfaqjen e jashtme, pasi ai nuk ka qenë palë në këtë kontratë, nuk ka paguar ndonjëherë atë çmim, nuk e ka nënshkruar atë dhe nuk ka qenë në dijeni të saj.

24.5.3. Subjekti ka sqaruar se në momentin e nënshkrimit të deklaratës noteriale nuk ka vënë re përmendjen në të, të aktmarrëveshjes. Ai ka shpjeguar se është paraqitur në zyrën e noterit thjesht për të nënshkruar, në kushtet e kohës së pamjaftueshme për të lexuar aktin në tërësi dhe me vëmendje, për shkak të angazhimit të madh në punë. Subjekti pranon faktin e neglizhencës së treguar në leximin e deklaratës noteriale dhe sjell si argument se në shkresën e datës 04.07.2024, me të cilin noteri ka përcjellë këtë deklaratë në Komision, nuk rezulton bashkëlidhur aktmarrëveshja, dhe se hartimi i deklaratës noteriale lidhet thelbësisht me kontratën e shitblerjes së nënshkruar prej tij më datë 05.08.2013, për shkak të dhënies së shumës 115.150 lekë paraprakisht, dhe jo me ndonjë akt tjetër paraprak. Nëse do të ekzistonte një fakt i tillë, nuk do të kishte arsye përse të hartohej më pas kontrata e shitblerjes nr. {***}/*** rep./kol., datë

05.08.2013, kontratë kjo e regjistruar rregullisht në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme, dhe ka prodhuar pasoja konkrete juridike lidhur me disponimin e pasurisë nga palët.

24.5.4. Vlera prej 6.000.000 lekësh, sipas subjektit, është një vlerë irracionale për një tokë të llojit “arë”, e gjendur në {***}, ndërkohë që çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes, datë 05.08.2013, i dakordësuar mes palëve, është real dhe përputhet me çmimet e tregut për atë zonë, përcaktuar me akt nënligjor²⁴, sipas së cilit, për vitin 2014, çmimi për pasuritë “tokë arë” në {***}, Elbasan, ishte 220 lekë/m², ndërkohë subjekti e ka përfituar pasurinë me çmimin 329 lekë/m². Gjithashtu, subjekti paraqet kontrata të ngjashme²⁵ shitblerjeje të “tokës arë” në {***}, gjatë periudhës 2010 – 2023, në të cilat çmimi për metër katror varion nga 143 - 800 lekë.

24.5.5. Lidhur me mosdeklarimin e pasurisë “tokë me sipërfaqe 1500 - 1700 m²”, blerë në vitin 2012, subjekti deklaron se ky konstatim është tërësisht i pavërtetë dhe i pambështetur në asnjë akt shkresor provues apo në ndonjë indicie të qenësishme. Kjo pasuri e pretenduar, e konsideruar “varosh”, tokë e paregjistruar, e trashëguar, nuk rezulton askund e pasqyruar si e tillë. Ndërkohë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim, “AShK”), Drejtoria Vendore Elbasan, me shkresën nr. {***} prot., datë 01.07.2024, sqaron se pasuria nr. {***}, e llojit “arë”, me sipërfaqe 2.000 m², kufizohet nga pasuritë në pronësi “shtet”, dhe pronësi të z. A. Sh. dhe z. D. Sh., ndërsa kufiri verior kufizohet me pasuri për të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar i pasurive, dhe kjo drejtori nuk disponon informacion. Asnjë prej pasurive kufitare nuk rezulton të jetë tjetërsuar prej personave që pretendojnë se disponojnë pronë “tokë arë”, e trashëguar nga i ndjeri M. Sh., me sipërfaqe 1.500 - 1.700 m², e ashtuquajtur “varosh”. Të gjitha pasuritë kufitare të pronës prej 2.000 m² janë të regjistruara në pronësi të palëve ose tokë “shtet”, madje ka prej tyre, që janë edhe sipërfaqe të patjetërsueshme (sikundër pasuria e llojit “pyll”, me sipërfaqe 22.352 m² apo pasuria e llojit “shkëmbore”, me sipërfaqe 583 m²).

24.5.6. Ndryshe nga sa pretendon Komisioni, sipërfaqja “varosh” nuk rezulton e regjistruar në emër të personave të lartpërmendur e, për pasojë, askush nuk mund të transferojë te dikush tjetër të drejta të cilat nuk i ka. Në këto kushte, parashikimi në aktmarrëveshje është tërësisht i pavlefshëm. Për sa më sipër, subjekti ka sqaruar se nuk rezulton që ai: (i) të ketë fshehur vlerën reale të blerjes së kësaj pasurie, në shumën 6.000.000 lekë, pasi nuk ka nënshkruar asnjë lloj marrëveshjeje të tillë dhe vlera nuk përfaqëson çmimin real të tregut në atë zonë; (ii) të ketë kryer deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në lidhje me çmimin real të blerjes së kësaj pasurie, por ka qenë i saktë dhe ka deklaruar vlerën reale të çmimit të paguar, duke provuar edhe burimin e ligjshëm të saj; (iii) çmimi i paguar për këtë pasuri është deklaruar saktësisht në

²⁴ Referuar vendimit nr. 89, datë 03.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës”, çmimi i tregut për vitin 2014, për pasuritë “tokë arë” në Gjinar, Elbasan, është 220 lekë/m², si dhe vendimit nr. 514, datë 30.07.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, vlera e tokës është 338 lekë/m².

²⁵ Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2010, çmimi 324 lekë/m²; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.05.2012, çmimi 800 lekë/m²; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.07.2012, çmimi 329 lekë/m²; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.08.2012, çmimi 420 lekë/m²; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.11.2012, çmimi 752 lekë/m²; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2013, çmimi 397 lekë/m²; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2013, çmimi 400 lekë/m²; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.12.2014, çmimi 204 lekë/m² dhe 143 lekë/m²; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.02.2015, çmimi 251 lekë/m²; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.02.2017, çmimi 400 lekë/m²; kontratë shitblerje, datë 19.06.2023, çmimi 234 lekë/m².

deklaratën periodike vjetore 2013, po ashtu edhe në atë *vetting*; (iv) subjekti ka blerë vetëm këtë pasuri të paluajtshme dhe nuk disponon/përdor/zotëron asnjë pasuri tjetër të pretenduar. Së bashku me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti paraqet deklaratën noteriale të deklaruesve, A. B. dhe A. Sh., të cilët mbështesin pretendimet e subjektit²⁶.

24.6. Nga analizimi i akteve të administruara për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton një diferencë të theksuar midis çmimit të përcaktuar në aktmarrëveshjen e vitit 2012 prej 6.000.000 lekësh, dhe çmimit në kontratën e shitjes së vitit 2013, prej 658.000 lekësh. Ndonëse aktet nënligjore që përcaktojnë çmimin e tokës në fshatin {***}, Elbasan, dhe kontratat e ngjashme të shitblerjes të tokës “arë” në {***}, gjatë periudhës 2010 – 2023, duket sikur mbështesin pretendimet e subjektit të rivlerësimit se çmimi në kontratën e nënshkruar prej tij është real, trupi gjykues nuk mund të mos marrë në konsideratë dhe t’i japë peshë, vlerës provuese të akteve noteriale të nënshkruara për këto pasuri. Më konkretisht, në deklaratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.08.2013, të nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, z. A. B. dhe shitësi A. Sh., ata kanë deklaruar nën përgjegjësinë e tyre ligjore e personale se vlera e shitjes për sipërfaqen 2.000 m² “arë” dhe sipërfaqen “varosh”, në lidhje me aktmarrëveshjen nr. {***} rep., datë 17.09.2012, është likuiduar totalisht. Nga analizimi i kësaj deklarate noteriale, trupi gjykues konstaton se qëllimi i vetëm i palëve deklaruese në të, ka qenë pikërisht likuidimi total i çmimit të pasurisë sipas aktmarrëveshjes së datës 17.09.2012. Në kushtet e mungesës së një kontrate paraprake/premtim shitje, që të përcaktonte çmimin e kësaj pasurie, dhe mungesës së parashikimit të këtij çmimi në përmbajtjen e deklaratës noteriale, i vetmi dokument i nënshkruar, mbi bazën e të cilit është shlyer pagesa, është aktmarrëveshja, ekstremitetet e së cilës referohen të sakta në deklaratën noteriale të nënshkruar nga subjekti. Në këto kushte, pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi faktin që nuk është treguar i kujdesshëm, për shkak të mungesës së kohës në dispozicion dhe angazhimit të madh në punë, dhe se vetëm ka shkuar për të nënshkruar deklaratën, apo pretendimet se me këtë aktmarrëveshje është njohur vetëm me rezultatet e hetimit, nuk janë bindëse dhe afektojnë besueshmërinë e deklarimeve të dhëna prej tij, për më tepër, kur deklarata noteriale përbëhet vetëm nga një faqe, dhe vetëm në dy paragrafë të shkurtër përshkruhej qëllimi i deklaruesve.

24.7. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar deklaratën noteriale, e cila referon likuidimin e vlerës së shitjes sipas aktmarrëveshjes së vitit 2012, që parashikon se: (a) kësti i parë, në vlerën 1.500.000 lekë, është likuiduar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare; (b) kësti i dytë, në vlerën 500.000 lekë, do të paguhet më datë 18.09.2012, nëpërmjet po kësaj banke; (c) vlera e mbetur pa paguar, prej 4.000.000 lekësh, do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës në emër dhe pronësi të palës blerëse – subjekti, në kuadër të barrës së provës, ka pasur detyrimin të provonte që shuma të cilën ai, nën përgjegjësinë e tij, deklaronte se e kishte shlyer, nuk ishte realizuar siç parashikohej në aktmarrëveshjen e kontestuar. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë shkresore për të provuar të kundërtën e sa ishte parashikuar në aktmarrëveshje. Në këto kushte, si aktmarrëveshja, ashtu edhe deklarata noteriale, përbëjnë vlerë të plotë provuese.

²⁶ Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.07.2024, z. A. B., ndër të tjera, deklaronte se shtetasin Neritan Hoxha e nje prej vitesh, pasi kanë studiuar bashkë në Fakultetin Juridik në Elbasan dhe kanë ruajtur miqësinë me njëri-tjetrin dhe familjarisht. Ai deklaronte se, ndonëse në aktmarrëveshjen e datës 17.09.2012 ka përmendur dhe personat e tjera ndër ta dhe Neritanin, nuk ka pasur akt përfaqësimi nga asnjë prej tyre, po i ka deklaruar në aktmarrëveshje, pasi edhe ata ishin të interesuar për blerjen e ndonjë sipërfaqe toke në {***}. Ai deklaronte me përgjegjësi se Neritani nuk ka qenë në dijeni të kësaj aktmarrëveshje, e bërë nga ai, A. Sh. dhe D. Sh., me qëllim realizimin në të ardhmen të interesave të tyre pasurore, të cilat për shkak objektive nuk u realizuan.

24.8. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues, në të njëjtën linjë arsyetuese me Komisionin, e ka konsideruar çmimin e paguar për këtë pasuri sipas aktmarrëveshjes, duke arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në lidhje me çmimin dhe kohën e blerjes. Duke u nisur nga të dhënat e aktmarrëveshjes dhe deklaratës noteriale, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë, duke mos deklaruar tokën “varosh” me sipërfaqe 1500 - 1700 m² në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vlerën (-) 825.601 lekë, për të paguar këstin më datë 17.09.2012, dhe në vlerën (-) 221.883 lekë, për shlyerjen e pagesës më datë 05.08.2013, në total, një mungesë prej (-) 1.047.484 lekësh. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të ligjit nr. 84/2016.

*B/5. Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 131 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, regjistruar në emër të babait të subjektit*

25. Komisioni, duke marrë në konsideratë: (i) faktin që ky apartament është rikonstruktuar dhe mobiluar me të ardhurat e subjektit, si dhe është në posedim të tij aktualisht; (ii) shkëmbimin e këtij apartamenti me një apartament me sipërfaqe më të vogël; (iii) refuzimin e subjektit për të dhënë shpjegime të qarta dhe të plota në lidhje me kohën e ndërtimit dhe vlerën e tij; (iv) mungesën e burimit të ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij për ndërtimin e këtij apartamenti; (v) mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit për ndërtimin e këtij apartamenti; (vi) dyshimet për përdorimin e kredisë së marrë nga subjekti, në vlerën 3.100.000 lekë, për ndërtimin e këtij apartamenti; (vii) se subjekti nuk arriti të provojë që ky apartament është përdorur ekskluzivisht nga prindërit e tij – Komisioni krijon bindjen se kjo pasuri është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, në kuptim të nenit 33/5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
26. Subjekti i rivlerësimit në ankim kundërshton konkluzionet e Komisionit dhe ngre këto pretendime: (i) ndryshe nga sa konstaton Komisioni, nuk ka asgjë kontradiktore në deklarinimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore dhe ato të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me përdorimin e kësaj pasurie. Komisioni nuk ka analizuar në vendimmarrjen e tij deklaratën noteriale të fqinjit, që pavarësisht se është kryer përgjatë procesit, është provë thelbësore, që vërteton një fakt të pakontestueshëm nga subjekti, provë e cila mund të sillej vetëm kur Komisioni e ngarkoi me barrë prove; (ii) Komisioni nuk ka analizuar në vendimmarrjen e tij asnjë nga aktet shkresore që provon faktin e përdorimit të kësaj pasurie nga prindërit dhe, aq më pak t’i ketë vlerësuar në harmoni me deklarinimet e subjektit. Përkundrazi, Komisioni mohon në vendim edhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përgjatë procesit, me qëllim për t’i treguar atij sjelljen bashkëpunuese në vërtetimin e ngjarjeve; (iii) Sa i takon shkakut të shkarkimit, se prindërit e subjektit duket se nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e tij, por edhe për shlyerjen e kredisë, konkluzionet e Komisionit janë të padrejta në raport me faktet e hetuara. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë sqarime të qarta dhe të plota për çdo konstatim të Komisionit, duke sqaruar se posedimi i këtij apartamenti ka filluar dhe është deklaruar në vitin 2022, dhe se më parë nuk është përdorur nga subjekti, por nga prindërit e tij. Prindërit kanë pasur mundësi të plotë financiare për investimin në këtë pasuri dhe çdo veprim i kryer për fitimin e të drejtave mbi të, është bërë prej tyre dhe jo prej subjektit. Është tërësisht

irrelevante arritja e konkluzionit mbi fshehje të kësaj pasurie, nisur nga premiset e prezantuara prej Komisionit.

27. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

27.1. Në përgjigjet e pyetësorit standard, më datë 18.02.2021, lidhur me blerjet/investimet/shpenzimet e kryera që nga dorëzimi i deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe blerjen e apartamentit me sipërfaqe 58.10 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, përfituar me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.07.2020, nënshkruar mes shitësve, E. H. dhe B. H., dhe blerësit Neritan Hoxha, kundrejt çmimit 61.750 euro. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti deklaroi të ardhurat nga shitja e apartamentit të zona e “{***}”²⁷, kursime familjare, të ardhura nga paga si prokuror, të ardhura nga aktiviteti i bashkëjetueses si notere, dhe depozita bankare. Në përgjigjet e këtij pyetësori, subjekti saktëson se apartamenti nuk është bërë i banueshëm, pasi ishte e nevojshme kryerja e disa meremetimeve të domosdoshme. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, datë 08.05.2024, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ky apartament nuk është përdorur prej tij dhe aktualisht aty banojnë prindërit. Vlera e mobilimit është 350.000 lekë, të paguara nga subjekti, të deklaruara në deklaratën periodike vjetore 2021, si dhe po prej subjektit janë mbuluar shpenzimet për rikonstruktimin e pjesshëm, në shumën 450.000 lekë, të deklaruara në deklaratën periodike vjetore 2022.

27.2. Nga aktet shkresore të administruara në kuadër të hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar se në kontratat e *overdraft*-it²⁸ të viteve 2014, 2015, 2016, 2017, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit me Credins Bank ShA, është deklaruar si adresë, rruga “{***}”, Tiranë. Po e njëjta adresë deklarohet edhe nga bashkëjetuesja në kontratën e lidhur me Tirana Bank ShA, adresë e konfirmuar edhe në dokumentin “kërkesë për transfertë fondesh, datë 02.10.2015”, pranë kësaj banke. Nga informacioni i përcjellë AShK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.03.2021, pasuria në këtë adresë rezulton në pronësi të z. R. H., përfituar me leje legalizimi nr. 2016, datë 30.09.2009.

27.3. Në këto kushte, nëpërmjet pyetësorit nr. 1, Komisioni i ka kërkuar subjektit, ndër të tjera: (i) informacion se kur ka filluar përdorimin e kësaj pasurie dhe nëse e përdor aktualisht; (ii) vlerën e shpenzuar nga babai për ndërtimin e kësaj pasurie, shoqëruar me dokumentacion provues; (iii) burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij, shoqëruar me dokumentacion provues; (iv) vlerën e shpenzuar për mobilimin; (v) shpenzime rinovimi nëse janë kryer, duke specifikuar vlerën dhe kohën e kryerjes së tyre; (vi) vënien në dispozicion, ndër të tjera, të dokumentacionit të legalizimit të kësaj pasurie.

27.4. Në përgjigjet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në këtë apartament kanë jetuar prindërit, si dhe vëllai dhe motra deri në momentin e shkëputjes së tyre. Subjekti, bashkëjetuesja dhe dy djemtë e tyre, kanë filluar të banojnë në këtë apartament në dhjetor 2022, si deklaruar në deklaratën periodike vjetore të këtij viti. Subjekti shprehet se ai dhe bashkëjetuesja mund ta kenë deklaruar si adresë, vetëm për efekte postare, adresën e sigurt ku mund të gjendeshin prindërit

²⁷ Me kontratë shitje pasurie e paluajtshme, me kusht kreditimi, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.05.2019, apartamenti i ndodhur në {***} ({***}), trajtuar më sipër në këtë vendim), i shitet znj. A. S. kundrejt çmimit 46.000 euro.

²⁸ “Marrëveshje huaje në llogari rrjedhëse (Overdraft)”, datë 29.10.2014, datë 01.09.2015, datë 30.10.2015, datë 27.10.2016, datë 03.11.2017.

prezentë. Lidhur me shpenzimet e kryera për këtë apartament, ai është shprehur se nuk është në gjendje të japë informacion, pasi nuk ka qenë i përfshirë, dhe me këtë proces është marrë babai, i cili me gjithë përpjekjet e subjektit për t'i marrë informacion të saktë e plotë, nuk ka qenë e mundur, për shkak të kalimit të kohës dhe gjendjes së tij shëndetësore. Lidhur me mobilimin, sipas shpjegimeve të prindërve (nënës kryesisht), për një pjesë të mobilimit janë shfrytëzuar mobiliet/pajisjet e banesës paraardhëse. Në total, për një periudhë 2 - 3 vjeçare, është bërë një shpenzim rreth 200.000 lekë dhe, gjatë viteve, janë bërë edhe shpenzime normale, për shkak përdorimi/amortizimi. Lidhur me rinovimin dhe mobilimin aktual, subjekti i rivlerësimit i referohet deklarimeve në deklaratat periodike vjetore 2022 dhe 2023. Nga analizimi i këtyre deklaratave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton që ai të ketë deklaruar si adresë banimi prej dhjetorit 2022, apartamentin në pronësi të prindërve në rr. “{***}” (ose rr. “{***}”). Në deklaratën periodike vjetore 2022, subjekti ka deklaruar rikonstruksionin e pjesshëm të këtij apartamenti në shumën 400.440 lekë, pasi ka marrë autorizimin nr. {***} prot., datë 20.07.2022, nga Njësia Administrative nr. {***}, Tiranë, në emër të pronarit të apartamentit. Ndërsa në deklaratën e vitit 2023, subjekti ka deklaruar shpenzime mobilimi për këtë apartament, në vlerën 500.000 lekë. Për sa i përket dokumentacionit të plotë të legalizimit të këtij apartamenti, subjekti ka sqaruar se nuk i është vënë ende në dispozicion nga ASHK-ja dhe, pas aplikimit në platformën *e-albania*, rezervon të drejtën për të paraqitur dokumentacionin sapo t'i mundësohet.

27.5. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni, duke mos i gjetur bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, nga hetimi i kryer, ka konstatuar se ky apartament është përdorur nga subjekti duke filluar nga viti 2014, kohë në të cilën ai ka deklaruar bashkëjetesën me znj. M. Subjekti është përpjekur të mos japë shpjegime të detajuara në lidhje me këtë apartament, duke pretenduar sëmundjen e babait të tij, ndërkohë që, për apartamentin në rrugën “{***}” Tiranë, i cili sërisht ka si burim të ardhurat e babait të subjektit, prej tij janë dhënë shpjegime të detajuara që i përkasin viteve 1992 – 1998. Komisioni, në kushtet që subjekti ka konfirmuar se ka në posedim këtë apartament, bazuar në dyshimet për fshehje pasurie, ka kryer një analizë financiare për mundësinë e prindërve të subjektit për të krijuar këtë apartament. Komisioni ka konstatuar se subjekti, në më shumë se njëherë, deklaroi se mobilimi i apartamenteve është bërë me mobiliet në banesën paraardhëse. Edhe në këtë rast, subjekti ka bërë të njëjtin deklaram, ndonëse banesa paraardhëse e prindërve të tij është ajo në rrugën “{***}”, e cila vijon të jetë e banueshme, për sa kohë është dhënë me qira. Deklarim i subjektit duket se është bërë me qëllim shmangien e Komisionit nga kryerja e një vlerësimi të plotë të kësaj pasurie, e cila duket se nuk është përdorur asnjëherë nga prindërit e subjektit. Duke qenë se Komisioni e ka pasur të pamundur për të përcaktuar saktësisht kohën e ndërtimit të këtij apartamenti, analiza financiare, si dhe kosto e ndërtimit të tij u përllogaritën sipas të dhënave Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”) për vitin 2009²⁹, kohë në të cilën është bërë dhe regjistrimi i tij. Analiza financiare tregoi se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie, në vlerën (-) 3.483.664,97 lekë. Kjo vlerë duket se përputhet me shumën e kredisë së marrë nga subjekti në vitin 2009, për të cilën ka deklaruar se nuk është përdorur nga ana e tij. Për rrjedhojë, duket se kredia është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të këtij apartamenti.

27.6. Për sa më sipër, Komisioni i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për këto konstatime: (i) apartamenti me sipërfaqe 131 m² është përdorur nga subjekti dhe bashkëjetuesja

²⁹ Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 20.08.2008, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008”, vlera e ndërtimit 27.439 lekë/m² [131m² x 27.439 lekë/m² = 3.594.509 lekë].

e tij, duke filluar të paktën nga viti 2014; (ii) prindërit e subjektit duket se nuk e kanë përdorur këtë apartament; (iii) subjekti duket se ka përdorur shumën 3.100.000 lekë, të marrë kredi nga NBG Bank ShA në vitin 2009, për mbulimin e shpenzimeve të këtij apartamenti; (iv) prindërit e subjektit duket se nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e tij, por edhe për shlyerjen e kredisë; (v) subjekti nuk ka dhënë shpjegime të plota, duke u përpjekur të shmangë Komisionin nga kryerja e një analize të plotë financiare në lidhje me këtë apartament; (vi) subjekti ka deklaruar posedimin e këtij apartamenti në vitin 2022, duke i lënë në përdorim prindërve një apartament me sipërfaqe 58 m²; (vii) subjekti e ka rinovuar dhe mobiluar këtë apartament, duke shpenzuar një vlerë të deklaruar në shumën 900.440 lekë. Për rrjedhojë, duket sikur ky apartament është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

27.7. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si më poshtë:

27.7.1. Subjekti nuk ka dhënë asnjë kontribut për krijimin e kësaj pasurie, nuk gëzon asnjë të drejtë pronësie mbi të dhe, për pasojë, nuk ka pasur detyrim për deklarim për qëllime të procesit të rivlerësimit. Në kushtet kur ky apartament ofron hapësirë më të përshtatshme për jetesën e katër personave, si dhe bazuar në marrëdhënien e ngushtë familjare me prindërit, të cilët, duke u sensibilizuar për nevojat dhe në interesin më të mirë të nipërve të tyre, e lejuan një fakt të tillë. Për pasojë, në vitin 2022, u këmbyen banesat dhe prindërit u vendosën në pasurinë po të ndodhur në rr. “{***}”, në pronësi të subjektit. Fakti i deklarimit të adresës së prindërve në kontratat *overdraft* të viteve 2014, 2015, 2016, 2017, në Credins Bank ShA, ka ardhur vetëm si pasojë e plotësimit nga banka me të dhënat e mëparshme të disponuara nga familja. Ka qenë nëna, që ka deklaruar këtë adresë të cilën subjekti nuk e ka vënë re, as atëherë, as sot. Kur klienti shkon në bankë të kryejë një transaksion, siç është marrja e kredisë, të dhënat personale mbesin po të njëjta.

27.7.2. Subjekti i rivlerësimit e gjen tërësisht të padrejtë konstatimin e Komisionit se subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2014, ndërkohë që nuk ka asnjë provë, që të vërtetojë një fakt të tillë. Në përgjigjet e pyetësorit standard, ai ka deklaruar se për periudhën nëntor 2010 – shkurt 2017, ka banuar në apartamentin e tij në zonën e “{***}”, {***}, ndërsa gjatë periudhës mars 2017 – tetor 2020, në apartamentin në pronësi të prindërve të bashkëjetueses në qytetin e Përrenjasit, për shkak të punës së bashkëshortes, dhe të kushtëzuar nga fakti që kishin dy fëmijë të vegjël. Nga tetori i vitit 2020 e në vijim, ka banuar në apartamentin në emër të bashkëjetueses, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë. Në asnjë prej rubrikave të deklaratës periodike vjetore 2014, subjekti nuk ka deklaruar si adresë vendbanimi adresën e prindërve në rrugën “{***}”. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të fqinjët E. G.³⁰, si dhe një sërë aktesh shkresore që provojnë pagesat utilitare³¹, praktika e aplikimit për pajisje me vizë kanadeze e babait, kontrata për shërbimin e

³⁰ Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.07.2024, ai deklaroi se shtetasin Neritan Hoxha e njeh që në vitin 2005, pasi kanë punuar bashkë në Elbasan, dhe secili ka prenotuar në vitin 2007 një apartament në {***}, zonën e {***}, Tiranë, që ndërtonte shoqëria “{***}” ShPK, në të cilin ai vazhdon banon ende. Sipas deklaruësit, pak muaj pasi lindën fëmijët, Neritani dhe M. u zhvendosën për të jetuar në qytetin e Përrenjasit.

³¹ Faturat tatimore të shitjes së energjisë elektrike, të datës 02.05.2012 e në vijim; aktmarrëveshje për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike, e datës 12.03.2015; procesverbaleve dhe mandate të arkëtimeve, të datës 12.05.2015, 14.07.2015.

telefonisë fikse, dhe për shërbime telekomunikacioni, deklaratën noteriale të fqinjëve të prindërve³², angazhimin si notere të bashkëjetueses në Përrenjas.

27.7.3. Subjekti në vijim ka sqaruar se dyshimi i Komisionit se kredia e marrë prej prindërve në vitin 2009, në shumën 3.100.000 lekë, është përdorur për investimin në këtë pasuri nga subjekti, është i pavërtetë dhe nuk përputhet me aktet, pasi ndërtimi i kësaj pasurie ka qenë realizuar që në vitin 2007, dhe i përfunduar bashkë me procesin e legalizimit në vitin 2009 e, për pasojë, kredia prej 3.100.000 lekësh nuk mund të kishte shërbyer për këtë investim. Po kështu, edhe përputhja që i bën Komisioni pamjaftueshmërisë së konstatuar të prindërve me vlerën e kredisë, është tërësisht e pabazuar në provat dhe faktet e hetuara përgjatë procesit. Në rastin konkret, prindërit nuk janë persona të lidhur dhe nuk kanë asnjë detyrim ligjor për të provuar burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie, me pasojë atribuimin e dyshimeve për fshehje të saj nga subjekti i rivlerësimit. Fakti që ky konstatim ka qenë i gabuar dhe jologjik e provon edhe mundësia financiare për të kursyer në analizën e Komisionit për vitin 2009, prej 3.980.499 lekësh, që stonon, në relevancë me të gjitha vitet e tjera brenda periudhës së rivlerësimit.

27.7.4. Nuk ka asnjë arsye logjike se përse do të duhej të merrej kredia për një pronë tjetër që të investohej në pronën në rrugën “{***}”, ndërkohë që mund të kërkohej një kredi nga prindërit, direkt për ndërtimin e shtesës së apartamentit në rr. “{***}”, Tiranë. Për më tepër, kredia është një e ardhur dhe, si e tillë, ajo jo vetëm që nuk ka asnjë kuptim “të fshihet”, por përkundrazi deklorohet si burim të ardhurash për veprime financiare nga ana e çdo subjekti. Lidhur me kredinë 3.100.000 lekë, pas bisedës me nënën, subjekti risjell në vëmendje arsyet dhe rrethanat që çuan në marrjen e saj, nevoja për t’i blerë një apartament motrës, për shkak të situatës në të cilën ajo ndodhej. Subjekti ka sqaruar se procedura për të përputhur gjetjen e banesës dhe aprovimin e kredisë nuk ishte e lehtë, kështu që u mendua të garantohej njëherë kredia dhe më pas të gjenin një shtëpi të përshtatshme. Në këto kushte, u kontaktua administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, kushëri i të afërmeve të nënës, dhe u hartua kontrata mes babait dhe kësaj shoqërie që të dorëzohej në bankë. Pjesëmarrja e subjektit në këtë veprim të natyrshëm solidariteti familjar ishte për të mbështetur prindërit për një veprim formal, duke nënshkruar një kredi e cila do të paguhej prej tyre. Për shkak të qëndrimit të motrës, nuk u arrit të blihej një apartament për të.

27.7.5. Në vijim të shpjegimeve, subjekti ka sqaruar se, duke mbetur pa përdorur 3.000.000 lekë, prindërit tërhoqën në mars 2010 edhe *cash-in* e lënë kolateral për kredinë e subjektit, pasi i duheshin për të bërë pagesa të tjera. Paralelisht, ai priste përfundimin e punimeve *finitura* të shtesës së apartamentit të tij, sepse ky ishte edhe kushti i pagesës për pjesën e mbetur të çmimit. Fillimisht bëri një shlyerje të rëndësishme të kredisë në NBG Bank. Nuk preferoi ta bënte të gjithën njëherësh, pasi nuk dihej nëse pagesat për banesën mund të dilnin jashtë preventivave të parashikuara. *Finiturat* e brendshme për shtesën e apartamentit përfunduan në pranverën e vitit 2010 dhe, rreth muajve maj – qershor, babai bëri edhe disa pagesa pjesore deri në kompletimin e plotë të pagesës, që i takonte punimeve të kryera gjatë periudhës 2008 – verë 2009 dhe ndonjë

³² Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.07.2024, deklaruesit, P. P., E. T. dhe A. B., banues në rrugën “{***}” (rr. “{***}”) Tiranë, nd. {***}, hyrja {***}, deklarojnë se në katin e katërt të këtij pallati, nga viti 2009 – 2010, kanë jetuar R. dhe N. H. dhe, në fillim, edhe dy fëmijët e tyre, G. dhe D. H., ndërsa prej fundit të vitit 2022, në këtë apartament jeton djali i tyre Neritan Hoxha, e shoqja M. dhe dy djemtë e tyre binjakë.

finiture të kryer gjatë fillimit të vitit 2010. Ndonëse subjekti nuk ka marrë pjesë në këto veprime, e gjykoji të nevojshme të deklarojë hollësitë, pas kërkesës së Komisionit për të provuar të kundërtën e barrës të provës. Subjekti shprehet se nuk ekziston asnjë veprim i vetëm bankar për të provuar qoftë edhe pagesën e një kësti të vetëm prej tij. Përdorimi i kësaj pasurie nga subjekti në vitin 2022 nuk përbën shkak për hetimin e saj, dhe nuk ka asnjë indicie të qenësishme që kjo pasuri të hetohet në mënyrën si është vepruar nga Komisioni. Referuar nenit 259 të Kodit Civil, nga e drejta e banimit nuk rezulton të burojë asnjë e drejtë reale, që lidhet me pronësinë apo posedimin e sendit për përdoruesin. Nuk ka asnjë gjurmë, asnjë veprim që të përlligjë dyshimet e Komisionit mbi këtë pasuri, qëndrim i mbajtur edhe nga Kolegji në jurisprudencën e tij³³, se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor, në kuptim të nenit 3, pika 14, dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të apartamentit të përdorur prej tij, [...], pasi babai i subjektit nuk plotëson kërkesat e këtyre dispozitave ligjore për t'u konsideruar person tjetër i lidhur, që do ta vendosnin përpara këtij detyrimi, i cili konsiderohet në tejkallim të parashikimeve kushtetuese e ligjore.

27.7.6. Sa i takon analizës financiare në lidhje me marrjen dhe shlyerjen e kësaj kredie, sipas subjektit, meqenëse kredia as nuk është përdorur dhe as shlyer prej tij, ajo nuk duhet konsideruar në analizën e subjektit, por në atë prindërve të tij. Në marrjen e kredisë, subjekti ka qenë vetëm, formalisht, për të përmbushur kërkesa burokratike të bankës, ndërkohë që ajo është menaxhuar prej prindërve.

27.7.7. Lidhur me mungesën e të ardhurave të prindërve, ndryshe nga përllogaritjet e Komisionit, i cili është bazuar në çmimin e referencës së EKB-së, duke konsideruar vitin 2009, si vit ndërtimi, subjekti ka sqaruar se, nga ortofotot e vitit 2007 duket që janë ngritur 5 katet e shtesës dhe është vendosur çatia. Nga bisedat e kohës me babain, subjekti është informuar se ndërtimi është shtrirë në kohë; ai ka filluar qysh në vitin 2006 dhe, për vitet 2006 dhe 2007, shtesa kishte arritur në më pak se gjysmën e volumit të punimeve. Pagesat janë bërë për secilin vit. Ndërtimi ka vijuar përgjatë viteve 2008 dhe ka mbaruar në mesin e vitit 2009. Për shkak të disa *finiturave* të brendshme, të cilat u përfunduan në vitin 2010, edhe pagesa e tretë u bë në vitin 2010. Pagesat janë kryer sipas ecurisë së punimeve³⁴. Duke përdorur çmimet e EKB-së për vitet 2006 – 2008, kostoja e gjithë ndërtimit do të ishte 3.457.365 lekë.³⁵ Sa i takon mundësisë financiare të prindërve për të paguar ndërtimin e banesës, meqenëse pagesat janë kryer në vitet 2006, 2007 dhe 2010, rezultojnë se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për ndërtimin e shtesës te rruga “{***}”, Tiranë.

27.8. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se pasuria objekt shqyrtimi në emër të babait të subjektit të rivlerësimit është fituar me leje legalizimi nr. 2016, datë 30.09.2009. Referuar këtij dokumenti, bëhet fjalë për një shtesë anësore, ndërkohë që në dosje mungon dokumentacioni dhe shpjegimi lidhur me pasurinë ekzistuese, pronësinë e saj, sa i përket apartamentit në të cilin është ndërtuar shtesa anësore me sipërfaqe 131 m², objekt shqyrtimi.

³³ Shih vendimin nr. 10/2020 (JR), paragrafët 14.14 – 14.16, të Kolegjit.

³⁴ Nga bisedat me prindërit, subjekti është informuar mbi volumin dhe vlerën e paguar të punës, duke e ndarë: (i) në vitin 2006 janë kryer 20% të punimeve ose e shprehur në sipërfaqe punimesh 26 m²; (ii) në vitin 2007 janë kryer 25% të punimeve ose 33 m²; (iii) -- në vitin 2008 deri në verën e vitit 2009 janë kryer 55% të punimeve ose 72 m².

³⁵ Shpenzimet e kryera janë 661.864 lekë, për vitin 2006; 818.521 lekë, për vitin 2007 dhe 1.976.980 lekë për vitin 2008.

27.9. Nga analizimi i shpjegimet të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konfirmon konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka dhënë shpjegime të qarta dhe të plota në lidhje me kohën dhe vlerën e kryerjes së këtij investimi, përdorimin e kredisë të financuar në vitin 2009, ashtu edhe sa i përket adresës së deklaruar në kontratat e *overdraft*-it me Credins Bank ShA. Më konkretisht: (i) subjekti njëherë shprehet se ndërtimi i kësaj pasurie ka qenë realizuar që në vitin 2007, dhe i përfunduar bashkë me procesin e legalizimit në vitin 2009 dhe, për pasojë, kredia e financuar nga NBG Bank, prej 3.100.000 lekësh, nuk mund të kishte shërbyer për këtë investim. Më pas, ka shpjeguar se babai, duke mbetur pa përdorur nga kredia shuma 3.000.000 lekë, tërhoqi në mars 2010 edhe *cash*-in e lënë kolateral për kredinë e subjektit, pasi i duheshin për të bërë pagesa të tjera. Babai nuk preferoi ta bënte shlyerjen e kredisë të gjithën njëherësh, pasi nuk dihej nëse pagesat për banesën mund të dilnin jashtë preventivave të parashikuara. *Finiturat* e brendshme për shtesën e apartamentit përfunduan në pranverën e vitit 2010 dhe, rreth muajve maj – qershor, babai bëri edhe disa pagesa pjesore, deri në kompletimin e plotë të pagesës që i takonte punimeve të kryera gjatë periudhës 2008 – verë 2009, dhe ndonjë *finiture* të kryer gjatë fillimit të vitit 2010. Fillimisht, subjekti deklaroi se nuk mund të japë të dhëna për vlerën e shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie, për shkak të gjendjes shëndetësore të babait dhe, pas kalimit të barrës së provës, e gjykon të nevojshme të deklarojë hollësitë mbi këto shpenzime. (ii) Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti shprehet se ai dhe bashkëjetuesja mund ta kenë deklaruar si adresë banimi këtë apartament vetëm për efekte postare, adresë e sigurt ku mund të gjendeshin prindërit prezentë. Ndërsa, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka sqaruar se fakti i deklarimit të adresës së prindërve në kontratat e *overdraft* të viteve 2014, 2015, 2016, 2017, në Credins Bank ShA, ka ardhur vetëm si pasojë e plotësimit nga banka me të dhënat e mëparshme të disponuara nga familja. Ka qenë nëna, që ka deklaruar këtë adresë, të cilën subjekti nuk e kishte vënë re.

27.10. Ndonëse Komisioni ka vlerësuar se subjekti qëndron në këtë banesë që prej vitit 2014, kur ka deklaruar bashkëjetesën dhe, nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar akte të ndryshme për të provuar të kundërtën, si përmendur në paragrafin 27.7.2 të këtij vendimi, trupi gjykues nuk e gjen me ndikim ligjor në vendimmarrjen e tij, kohën e saktë kur subjekti ka filluar faktikisht ta përdorë këtë apartament. Përpos sa arsyetuar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin që subjekti i rivlerësimit, në vitin 2020, blen një apartament po në rrugën “{***}”, me sipërfaqe 58 m², të pamjaftueshme sipas tij, për një familje me katër anëtarë, të cilin nuk e përdor asnjëherë, dhe e këmben me apartamentin e prindërve, në të cilin rezulton të ketë investuar në vitet 2022 dhe 2023, vlerën prej 900.440 lekësh, për rikonstrukcionin e pjesshëm dhe mobilimin e tij..

27.11. Trupi gjykues vlerëson ta analizojë këtë pasuri edhe në drejtim: (a) të besueshmërisë së veprimeve financiare dhe juridike, të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të kredive të financuara, duke implikuar pjesëmarrjen e prindërve në to, si dhe; (b) të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, përpara se të arrijë në konkluzionin nëse vlerësimi i Komisionit që kjo është një pasuri e fshehur e subjektit, është ose jo i bazuar.

28. Për kredinë në shumën 20.000 euro, financuar nga NBG Bank ShA, më datë 28.01.2008, që ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë “apartament dhe verandë” në {***}, {***}, të trajtuar më sipër në këtë vendim, rezulton se ka shërbyer si garanci për kredinë, shuma 22.000 euro vënë si depozitë *cash* kolateral në ish-NBG Bank ShA, nga prindërit e subjektit, të cilët rezultojnë dorëzanës në këtë marrëdhënie kontraktore.

29. Për këtë garanci, Komisioni në vendim arriti në përfundimin se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme, në shumën (-) 5.517.350,60 lekë, për krijimin e shumës 22.000 euro. Në vendim, Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit³⁶, si dhe duke marrë në konsideratë se subjekti ka përfshirë pasuri të prindërve të tij më shumë se një herë në interes të tij, e ka zgjeruar hetimin dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës për fshehje pasurie dhe jo për mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës. Parashikimi i pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, [...] lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me elementet përbërëse të fshehjes së pasurisë dhe të deklarimit të rremë për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas të cilit, përcaktohet si fshehje apo deklarim i rremë, çdo deklarim i subjektit të rivlerësimit, që tenton të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta, ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit, rezultat që do të ishte i kundërt nëse do të bazohej në të dhënat e faktet e vërteta. Ky parashikim kushtetues është reflektuar në përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronjat “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në këto dispozita ligjore, si dhe duke marrë në konsideratë: (i) mungesën e burimeve të ligjshme të babait të subjektit për të justifikuar shumën 22.530 euro; (ii) deklarimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e kësaj shume; (iii) periudhën e depozitimit të kësaj shume në bankë, e cila përkon me momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes së subjektit, si dhe marrjen e kredisë vetëm 1 muaj më vonë; (iv) përdorimin e kësaj shume si garanci për kredinë e marrë nga subjekti; (v) tërheqjen e saj nga prindërit në vitin 2010 dhe përdorimin e pretenduar të subjektit për të shlyer kredinë prej 3.100.000 lekësh, e cila rezulton e marrë nga subjekti, si dhe për apartamentin në rrugën “{***}”, për të cilin ngrihen dyshime që është pasuri e fshehur e subjektit – vlerëson se kjo shumë mund të jetë në pronësi të fshehur të subjektit. Komisioni do t’i trajtojë konstatimet e mësipërme në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.
30. Subjekti i rivlerësimit i kundërshton këto konkluzione, me pretendimet se: (i) Komisioni nuk mund të ngarkojë subjektin *a priori* për fshehje pasurie, të çdo pasurie të prindërve, pasi kjo do të ishte në disproporcion me parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe me parimin që “barra e provës i kalon subjektit”. Dyshimet mbi “fshehje të pasurisë” nuk mund të jenë në diskrecion arbitrar të Komisionit, sipas vlerësimit të “bindjes së brendshme”, vetëm se subjekti ka përdorur këtë vlerë në formën e garancisë, pasi sipas kësaj logjike, të gjithë subjektet e rivlerësimit që kanë lënë kolateral pasuritë e prindërve për marrjen e një kredie, automatikisht u është ngarkuar barrë prove për fshehje, fakt që nuk ka ndodhur. Ky arsyetim u gjet i drejtë nga Kolegji në vendimin nr. 20/2022 (JR), paragrafi 13.15 i tij. (ii) Komisioni është i paqartë kur shprehet lidhur me momentin kohor të depozitimit të kësaj shume në llogari bankare për herë të parë, sesi mund të ndërlihet kjo me dyshimet e “qenësishme” për fshehje. Subjekti ngre pikëpyetjen mbi arsyen se përse Komisioni u ndikua nga tendenca për “fshehje” dhe nuk ndërmori një arsyetim logjik që kjo shumë u vendos në llogari bankare, sepse kërkohej si e tillë, në mënyrë që të konsiderohej si *cash collateral*. (iii) Sipas analizës financiare të Komisionit, rezulton se prindërit e subjektit, si përpara periudhës së rivlerësimit, ashtu edhe më pas, nuk kanë jetuar me të ardhura të ligjshme. Natyrshëm, lind pyetja, si kanë mundur prindërit e subjektit të punojnë dhe të mos arrijnë të sigurojnë të ardhura? Pavarësisht se nuk ka asnjë rrethanë bindëse se përse Komisioni

³⁶ Vendimet nr. 21/2020 (JR), nr. 7/2020 (JR) dhe nr. 10/2022 (JR), të Kolegjit.

duhet të ngarkonte subjektin lidhur me dyshimet për fshehje, rezulton se prindërit e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite.

31. Trupi gjykues i Kolegjit, në kuadër të analizimit të shkaqeve të ankimit, në raport me aktet e administruara në dosje, konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

31.1. Referuar informacionit të përcjellë nga American Bank of Investments ShA (ish-NBG Bank ShA) me shkresën nr. {***} prot., datë 02.02.2021, rezulton se R. H. ka pasur pranë kësaj banke llogari depozite në monedhën euro, e hapur më datë 28.12.2007, kur dhe ka depozituar në *cash* shumën 22.530 euro, e cila, më datë 31.12.2007, ka kaluar në depozitë.

31.2. Për të përfituar kredinë në shumën 20.000 euro nga NBG Bank ShA, në cilësinë e dorëzanësit, paraqiten prindërit e subjektit të rivlerësimit, R. dhe N. H. Në nenin 9, pika 9.02 e kontratës së kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2008, përcaktohet se kredimarrësit / dorëzanësit marrin përsipër detyrimin për të bllokuar në favor të bankës shumën prej 22.000 eurosh, si garanci financiare për sigurimin e përmbushjes së detyrimeve kundrejt bankës.

31.3. Me kontratë hipoteke nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2009, Neritan Hoxha hipotekon në favor të Bankës Kombëtare të Greqisë (NBG Bank), pasurinë “sipërfaqe 300 m² truall” dhe “100 m² ndërtesë”, të ndodhur në {***}, për të siguruar: (i) kredinë në shumën 20.000 euro, akorduar z. Neritan Hoxha, si dhe; (ii) kredinë në shumën 3.100.000 lekë, akorduar z. Neritan Hoxha, z. G. H., z. R. H. dhe znj. D. H. Me kontratën e hipotekës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.01.2010, R. dhe N. H., hipotekojnë në favor të Bankës Kombëtare të Greqisë pasurinë e ndodhur në rrugën “{***}” Tiranë, me sipërfaqe 131 m², për të siguruar dy kreditë e lartpërmendura.

31.4. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se kredia e subjektit është garantuar me depozitën e prindërve, ka kryer një hetim në lidhje me këtë depozitë, pasi bazuar në të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme, për rrjedhojë, ngrihen dyshime se kjo depozitë, prej 22.530 eurosh, është në fakt e subjektit të rivlerësimit.

31.5. Në pyetësin nr. 1, Komisioni ka kërkuar informacion dhe dokumentacionin provues për burimin e ligjshëm të shumës 22.000 euro. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e tij ka sqaruar se burimi i kësaj shume ka qenë: (i) të ardhurat nga emigracioni në Greqi i babait, nga viti 1997 deri në vitin 2000; për disa kohë, ka qenë dhe nëna së bashku me vajzën, A. H. Nga këto të ardhura, është krijuar depozitë pranë NBG Bank, dega Kretë, Greqi, në shumën 5.000.000 dhrahmi greke, që sipas shpjegimeve të prindërve, janë tërhequr kur janë kthyer në Shqipëri; (ii) depozitat në bankat e nivelit të dytë në emër të prindërve, të vëllait G. H., që kanë pasur si burim të ardhurat nga punësimi, si dhe; (iii) kursimet familjare. Subjekti ka sqaruar se babai ka vijuar të ushtrojë aktivitetin e peshkimit, por nuk disponon formular deklarimi për periudhën 1999 – 2008, megjithatë, në referencë me të ardhurat e deklaruara në formularin e fundit 1998 – 1999, të ardhurat minimalisht kanë qenë rreth 600.000 lekë në vit. Babai gjithashtu ka punuar në {***} Tiranë, për periudhën qershor 2006 – shkurt 2010. Nëna, shpjegon subjekti, ka bërë punë të ndryshme, por nuk ka qenë e siguruar, ndërsa në vitin 2004, ajo ka përfituar të ardhura nga shitja e pronës së privatizuar nga ish-Ndërmarrja Bujqësore Belsh. Vëllai G. H. ka qenë i punësuar në {***} Qarku Lezhë për periudhën 01.07.2000 – 01.11.2002, si dhe në disa subjekte tregtare në pozicione pune të mirëpaguara, ku dhe ka përfituar edhe bonuse të konsiderueshme, për shkak

të rezultateve të mira të arritura në punë. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit disa akte shkresore lidhur me pajisjen me leje kalimi për në Greqi, kërkesa drejtuar NBG Bank në Greqi dhe Ambasadës Greke, vërtetime punësimi nga institucione/subjekte të ndryshme dhe lëvizje llogarie bankare të vëllait G. H., vërtetim kontributësh për babain R. H., lëvizje llogarie bankare të subjektit, kontratat e nënshkruara nga nëna e subjektit dhe tetë persona të tjerë për blerjen dhe shitjen e magazinës në Belsh.

31.6. Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, për të verifikuar mundësinë financiare të babait të subjektit në cilësinë e kryefamiljarit, për krijimin e shumës 22.530 euro më datë 28.12.2007, ka kryer një analizë financiare për periudhën 1999 – 21.12.2007, nga e cila rezultoi se prindërit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në vlerën (-) 8.241.452,90 lekë. Duke marrë në konsideratë: (i) mungesën e burimit të ligjshëm të prindërve; (ii) kohën e krijimit të saj; (iii) qëllimin e përdorimit si garanci për kredinë e marrë nga subjekti; (iv) pretendimin e subjektit për marrjen e kredisë në shumën 3.100.000 lekë, ndërkohë që prindërit kishin kursime në këtë llogari; (v) përpjekjen e subjektit për të përfshirë të ardhurat e çdo familjari për krijimin e burimeve të ligjshme të pasurive, që përdoren vetëm për interesa të tij, Komisioni ka ngritur dyshime se të ardhurat e kësaj llogarie janë të ardhura të subjektit të rivlerësimit, të fshehura në emër të prindërve, duke i kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

31.7. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

31.7.1. Prindërit nuk kanë statusin e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi shuma 22.530 euro as nuk i është dhënë hua, dhe as nuk i është dhuruar subjektit, për t'i ngarkuar barrën e provës për të justifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave, që kanë shërbyer për krijimin e saj. Referuar qëndrimin të mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën e tij³⁷, që ka shërbyer dhe si qëndrim orientues, subjekti pretendon se detyrimi i tij për të provuar ligjshmërinë e kësaj shume tejkalon parashikimet ligjore.

31.7.2. Subjekti e gjen të padrejtë konstatimin e Komisionit mbi faktin se edhe pse prindërit kishin kursime në llogaritë e tyre, subjekti vendosi të marrë kredi në shumën prej 3.100.000 lekësh. Pavarësisht marrëdhënies së ngushtë prind – fëmijë, secili prej tyre ka punuar dhe ka krijuar kursimet/pasuritë e veta. Fakti që subjekti ka vendosur t'i drejtohet bankës, ka të bëjë me komoditetin që krijon ajo, në lidhje me kohëzgjatjen dhe shlyerjen e kredisë me këste të përballueshme mujore. Vendosja si garanci e *cash* kolateralit është shumë më e shpejtë në kohë, pa procedura të zgjatura dhe pa shpenzime ekstra, ndryshe nga ajo e barrës hipotekore mbi një pasuri të paluajtshme. Përfshirja e prindërve si “dorëzanës me kolateral” është një praktikë e ndjekur dhe e orientuar nga banka. Subjekti sqaron se ishte informuar nga babai se më datë 17.12.2007 kishte depozituar në Tirana Bank ShA shumën 16.000 euro, të cilën e tërhoqi, dhe së bashku me depozita të tjera dhe kursimet në banesë, çeli llogari bankare në euro pranë NBG Bank ShA më datë 28.12.2007, dhe depozitoi shumën 22.530 euro.

31.7.3. Shuma e lënë si *cash* kolateral nga prindërit ka shërbyer vetëm për qëllimin e garantimit të kredisë dhe është çliruar nga banka, më datë 01.03.2010, pasi është tërhequr nga babai dhe

³⁷ Vendimi nr. 20, datë 08.09.2020 (JR), paragrafët 21 - 21.3; vendimi nr. 21, datë 10.09.2020 (JR), paragrafët 72 - 77; vendimi nr. 4, datë 09.02.2021 (JR), paragrafët 143 - 146, të Kolegjit.

është mbajtur *cash* në banesë, duke u përdorur për ndërtimin e shtesës së apartamentit të prindërve, i ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, si dhe për shlyerjen e kredisë së marrë në NBG Bank ShA, në vitin 2009. Marrja e kredisë në shumën 3.100.000 lekë dhe mospërdorimi i kursimeve të prindërve lidhet me faktin se depozita 22.000 euro ishte tashmë e përdorur si *cash* kolateral për kredinë e marrë në janar të vitit 2008, dhe nuk kishte përse të thyhej para afatit të maturimit. Thyerja e saj në vitin 2010 u bë nën rrethana të tjera, që kanë të bëjnë me humbjen e qëllimit të vërtetë të kredisë 3.100.000 lekë dhe të veprimeve të tjera financiare të prindërve.

31.7.4. Lidhur me mundësinë financiare të prindërve për krijimin e depozitave, në analizën financiare të Komisionit nuk janë marrë parasysh disa të ardhura, për të cilat janë vënë në dispozicion aq prova sa subjekti ka mundur të sigurojë, për shkak të kohës së largët dhe për shkak të mosdetyrimit për të deklaruar. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar të ardhurat e prindërve nga emigracioni³⁸, si dhe të ardhurat e babait nga aktiviteti i peshkimit: (i) *Për të ardhurat nga emigracioni*, ndodhur në kushtet e pamundësisë objektive, subjekti kërkon që këto të ardhura, të konvertuara në shumën 1.970.500 lekë, të konsiderohen të ligjshme, si dhe referon në qëndrimin e mbajtur nga GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, për të ardhurat e fituara ekskluzivisht nga babai në emigracion, përpara se subjekti të ishte prokuror. (ii) *Për të ardhurat e babait nga aktiviteti i peshkimit*, subjekti i referohet argumenteve të analizuara për pasurinë në rrugën “{***}”, {***}, si dhe parashikimeve të nenit 4, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 8313 datë 26.03.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, për të provuar vijueshmërinë e biznesit nëpërmjet marrjes së certifikatës së regjistrimit dhe pagesës së detyrimit tatimor vjetor. Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ngarkoi bashkitë si organet përgjegjëse për administrimin e taksave vendore dhe, për tatimpaguesit me qarkullim deri në 2 milionë lekë në vit, paguhej kuotë fikse. Subjekti paraqet shkresën nr. {***} prot., datë 13.05.2024, të Bashkisë Belsh, sipas së cilës, personi fizik “R. H.” ka paguar tatimet për periudhën 2011 – 2024. Në kushtet kur për vitet 2000 deri 2009 nuk ka të dhëna nga organet tatimore, subjekti pretendon: (i) referimin të fitimit të vitit 1999, me rritje në masën 10% në vit, e cila do të shkonte në të njëjtën linjë me rritjen ekonomike përgjatë viteve 2000, deri në fund të vitit 2006; (ii) duke filluar nga viti 2007, babai, si çdo biznes i vogël, ka paguar kuotë fikse për qarkullim 0 deri 2 milionë lekë. Për të përcaktuar sasinë e të ardhurave në këtë interval, subjekti bazohet te qarkullimi i viteve 2015 – 2023, për të cilat ka informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, duke përdorur normat e fitimit mesatar për vitet 2015 deri 2023, në masën 68.42%.

31.8. Komisioni në vendim ka vlerësuar se për të ardhurat nga emigracioni nuk provohet, jo vetëm krijimi i tyre, por as vlera përkatëse, duke mbetur në nivel deklarativ. Ndërsa, pretendimin që të ardhurat nga aktiviteti i peshkimit të bazohen në të dhënat e viteve 2015 – 2023, duke përjashtuar të dhënat e viteve 2009 – 2014, Komisioni në vendim e vlerëson të pambështetur në

³⁸ Nga përgjigjja e Ambasadës Greke në Shqipëri, me shkresën e datës 27.05.2024 konfirmohet se më datë 01.08.1997 është lëshuar vizë për z. R. H. Për sa i përket llogarisë bankare në Greqi, në shumën 5 milionë dhrahmi, subjekti ka paraqitur kërkesat që avokatja i ka drejtuar bankës në data të ndryshme. Referuar prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.05.2024, R. H. autorizon avokaten në Selanikë M. Dh. H., ta përfaqësojë në Bankën Kombëtare Greke, në të gjitha filialet e saj dhe të kërkojë informacion për llogarinë bankare të cilën ai ka pasur te kjo bankë, të kërkojë dhe të marrë çdo informacion që ka të bëjë me këtë llogari bankare, çdo lloj vërtetimi ose dokumenti me të cilin të deklarohen shumat e depozituara dhe të tërhequra nga kjo llogari, mbetjen në qoftë se ekziston dhe, në përgjithësi, të informohet për çdo detaj, që ka të bëjë me këtë llogari bankare.

dokumentacionin e kohës për të provuar krijimin e tyre. Në vendim, Komisioni ka konkluduar se kjo mënyrë e llogaritjes së të ardhurave nga subjekti nuk ka asnjë mbështetje ekonomike dhe financiare, pasi nga të dhënat e organeve tatimore, babai i subjektit ka deklaruar të ardhura nga ky aktivitet pas vitit 2015, ndërkohë për vitin 2009, ai ka deklaruar një fitim prej 10.000 lekësh dhe, për vitin 2014 rezultojnë një humbje prej 68.605 lekësh. Për rrjedhojë, argumentimi i subjektit për të llogaritur në mënyrë hipotetike të ardhurat me një marzh fitimi të viteve 2015 e në vijim, nuk mund të merret në konsideratë. Gjithashtu, sipas Komisionit, në lidhje me këto të ardhura, nuk ka asnjë të dhënë për krijimin e tyre, por as për pagimin e detyrimeve tatimore për periudhën kur është krijuar kjo depozitë.

31.9. Subjekti i rivlerësimit në ankim e ka konsideruar të gabuar këtë konkluzion, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se: (i) Dokumentacioni i depozituar tregon vijueshmërinë e aktivitetit privat të peshkimit, që shoqërohet në mënyrë të pashmangshme dhe absolute, edhe me pagesën e detyrimeve tatimore, përndryshe nuk mund të ushtrohet. (ii) Komisioni duhet të kishte pranuar përlllogaritjet e kryera dhe të dërguara nga subjekti, të cilat janë bazuar në metodologji statistikore dhe financiare, siç janë metoda e analogjisë dhe metoda e rritjes proporcionale. Komisioni nuk mund ta konsideronte këtë metodë hipotetike, për sa kohë përdoret gjerësisht nga ekonomistët në planifikime dhe në buxhetime. Këto mënyra përdoren për të kuantifikuar elemente ekonomike dhe financiare, aty ku ka mungesë të dhënash konkrete dhe të drejtpërdrejta. Mungesa e të dhënave për të ardhura të realizuara nga biznesi i babait të subjektit, sikurse rezultojnë qartë nga përgjigjet e përcjella nga organet tatimore, nuk vijnë për shkakun e tij, por për arsye madhore ose objektive, jashtë mundësive të subjektit. (iii) Jo në pak raste, Komisioni ka kryer përlllogaritje bazuar në të dhënat konkrete për ato vite, për të cilat ka pasur informacion nga zyrat e tatimeve dhe/ose bashkitë e rrethëve ku ushtrohet biznesi. (iv) Për të përcaktuar xhiron vjetore, subjekti është bazuar te pagesa e tarifës fikse për të konkluduar te fasha e të ardhurave 0 - 2 milionë lekë në vit. Ndërsa, për të përcaktuar marzhin e fitimit, është bazuar në metodën e serive statistikore, pra në të dhënat e xhiros për vitet 2015 deri në vitin 2023, për 9 vjet radhazi, çka përbën një bazë më se të mjaftueshme për të përlllogaritur një marzh fitimi edhe për vite të mëparshme. Për vitet 2009 dhe 2014, nuk është e nevojshme të bëhen përlllogaritje. (v) Komisioni nuk ka dhënë as edhe një variant më të mirë apo më të saktë të përlllogaritjeve, nga analiza që subjekti ka depozituar me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, duke injoruar tërësisht çdo metodë financiare të përdorur botërisht në përlllogaritjen e të dhënave.

31.10. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me to, dhe për sa arsyetuar më sipër në këtë vendim, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk mund t'i ngarkojë atij barrë prove për fshehje pasurie, të çdo pasurie të prindërve, sipas vlerësimit të "bindjes së brendshme". Kolegji, në jurisprudencën e tij, ka arsyetuar se Komisioni, në kuadër të parashikimit në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, ka detyrimin të analizojë dhe evidentojë saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me pasuritë apo burimin e krijimit të tyre, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane, që mund të ngrejë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të këtyre pasurive, që mund të rezultojnë të jenë krijuar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në kushtet e rrethanat konkrete, të analizuara drejt nga Komisioni, ngrihen dyshime se *cash collateral* prej 22.530 eurosh i përket subjektit të rivlerësimit. Sa i përket mundësisë financiare të prindërve për krijimin e kësaj shume, ata rezultuan me pamjaftueshmëri, pasi të ardhurat e pretenduara nga emigracioni, nuk u provuan me dokumentacion dhe mbeten në nivel deklarativ,

ndërsa për të ardhurat nga aktiviteti i peshkimit, nuk ka asnjë të dhënë për krijimin e tyre, por as për pagimin e detyrimeve tatimore për periudhën kur është krijuar kjo depozitë. Në këto kushte, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për mundësinë e krijimit të kësaj depozite nga prindërit e tij, në Kolegjin konfirmohet diferencë negative e konstatuar nga Komisioni.

31.11. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni është i paqartë kur shprehet lidhur me momentin kohor të depozitimit të kësaj shume në llogari për herë të parë, se si mund të ndërlidhet kjo me dyshimet e “qenësishme” për fshehje, trupi gjykues gjen të drejtë konstatimin e Komisionit, pasi rezulton që shuma 22.530 euro të jetë depozituar nga babai i subjektit në bankë më datë 28.12.2007, dhe të jetë përdorur më pas si garanci për kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit. Ndonëse subjekti i rivlerësimit pretendoi procedura më lehtësuese për marrjen e kredisë nëpërmjet vendosjes së garancisë *cash* kolateral, në raport me hipotekimin e një pasurie të paluajtshme, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk parashtrroi ndonjë kërkesë të ngutshme të shoqërisë ndërtimore për shlyerjen e kështit të dytë, kur vetë palët nuk kanë parashikuar një detyrim të tillë në kontratën e sipërmarrjes së datës 13.01.2007. Nuk duket se subjekti i rivlerësimit kishte pengesë kohore për të siguruar kredinë që në fillimet e saj, nëpërmjet hipotekimit të pasurisë në emër të tij, të ndodhur në {***}, gjë të cilën e realizoi më pas, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës hipotekë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2009. Kjo situatë, vlerësuar së bashku me faktet e rezultuara mbi kredinë në vlerën 3.100.000 lekë, në të cilën rezulton bashkëkredimarrës, shton dyshimet se subjekti i rivlerësimit nuk është i vërtetë në deklaratimet e tij ndaj Komisionit dhe, me të drejtë, ato janë konsideruar në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

32. *Për kredinë e marrë në vitin 2009, në të cilën subjekti është në cilësinë e bashkëkredimarrësit.* Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, marrjen dhe kthimin e kësaj kredie, duke u bazuar në dokumentacionin e kohës, nga ku rezulton që të gjitha veprimet janë kryer nga llogaria bankare e subjektit. Fakti se shumat e depozituara janë kryer nga familjarët e tij, vlerësohet se është irelevant, pasi ato janë bërë për efekt të faktit se subjekti ka qenë në punë në Elbasan, si dhe nga ana e tij nuk u provua burimi i ligjshëm i të ardhurave të familjarëve të tij. Nga analiza financiare, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shlyerjen e kredisë, për vitin 2010, në vlerën 1.249.298,93 lekë; për vitin 2011, në vlerën 217.993,57 lekë, dhe; për vitin 2012, në vlerën 2.555.880,4 lekë.
33. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e kryer nga Komisioni për këtë kredi, duke e konsideruar tërësisht të pabazuar në prova dhe në rrethanat faktike të ndodhura. Subjekti e konsideron absurd faktin që Komisioni vlerëson irelevant depozitimin shumave nga familjarët e subjektit, duke u shprehur se ato janë bërë pasi subjekti ka qenë në punë në Elbasan, dhe se prej tij nuk u provua burimi i ligjshëm i të ardhurave të familjarëve. Një konkluzion i tillë është tërësisht i pavërtetë, jo vetëm sepse bie në kundërshtim me veprimet juridike të kryera, por dhe nga vetë logjika që punësimi i subjektit në Elbasan, nuk do ta privonte nga kryerja e veprimeve atje, për sa kohë që distanca Tiranë – Elbasan është vetëm 40 minuta, por edhe se bankat kanë degët e tyre në çdo qytet. Subjekti i kërkon Kolegjit që të heqë nga analiza financiare për vitet 2009 deri 2012, shpenzimin për kryerjen e pagesave të kësaj kredie. Shlyerjet do të duhet t'i ngarkohen familjes së tij të origjinës. Komisioni i ka zeruar ato me arsyetimin se kjo kredi është marrë dhe shlyer prej subjektit dhe, për pasojë, është kredi dhe shlyerje e fshehur prej tij, duke pamundësuar kështu analizën financiare, por kjo logjikë arsyetimi nuk përputhet me të gjitha shpjegimet dhe aktet e subjektit të rivlerësimit.

34. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

34.1. Në deklaratën periodike vjetore 2009, subjekti deklaron: *Kredi te NBG Bank, me afat 15 vjet, vlera 3.100.000 lekë. Kontrate kredie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2009 [...] (bashkëkredimarrës me familjarët, për efekt të ardhurash, pasi familjarët nuk kishin të ardhurat që kërkonte banka).*

34.2. Referuar informacionit të përcjellë nga ABI ShA (ish-NBG Bank ShA), subjekti i rivlerësimit rezulton bashkëkredimarrës në kredinë 3.100.000 lekë, e financuar nga kjo bankë më datë 13.10.2009. Nëpërmjet kontratës së kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2009, të nënshkruar mes Bankës Kombëtare të Greqisë ShA, në cilësinë e kredidhënësit, kredimarrësve Neritan Hoxha, R. H., G. H. dhe D. H. dhe dorëzanesit N. H., është financuar shuma 3.100.000 lekë me afat shlyerjeje 15 vjet, me qëllim blerjen e një apartamenti në rrugën “{***}”, Tiranë, duke përdorur si kolateral pasurinë e ndodhur në {***} Tiranë, blerë në vitin 1998.

34.3. Komisioni, pasi ka konstatuar se: (i) kredia është disbursuar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit më datë 14.10.2009; (ii) nga dokumenti “kërkesë për transferim fondesh”, po në këtë datë i është paguar shuma 3.100.000 lekë shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti nga Neritan Hoxha”; (iii) kredia rezulton e likuiduar brenda tri viteve, me likuidime pjesore (më datë 18.03.2010 është depozituar shuma 1.155.000 lekë, më datë 12.04.2012 është depozituar 1.050.000 lekë, më datë 28.12.2012 është depozituar shuma 859.000 lekë) – i kërkon subjektit, ndër të tjera: (i) arsyen që pagesa, si dhe apartamenti i blerë nga shoqëria “{***}” ShPK nuk është deklaruar, (ii) dokumentet e fitimit dhe regjistrimit të pasurisë, (iii) dokumentacionin provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave për shlyerjen e kredisë etj.

34.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka shpjeguar se prindërit dhe banka i kanë kërkuar që të ishte bashkëkredimarrës, për shkak të pagës, funksionit dhe të qenët klient i rregullt i bankës në shlyerjen e kredisë ekzistuese. Në këto kushte, ai konsiderohej person me stabilitet ekonomik, duke siguruar garanci për bankën, për kredinë e kërkuar nga prindërit. Kredia nuk është përdorur prej tij, ndaj dhe nuk është deklaruar në deklaratat periodike pasardhëse, asaj të vitit 2009. Nga faturat/mandatarkëtimet e ruajtura nga prindërit, rezulton se këstet janë shlyer nga vëllai dhe motra, që jetonin me prindërit. Si burim për shlyerjen e kredisë, kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet e familjes, pa përfshirë subjektin, i cili në atë kohë kishte filluar të banonte në apartamentin në zonën e “{***}”. Qëllimi i kredisë, sipas subjektit, ka qenë blerja e një apartamenti nga prindërit në rrugën “{***}”, Tiranë, fakt që provohet edhe nga kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.06.2009, mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe porositesit R. H., me objekt blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 100.3 m² (550 euro/m²), si dhe 26 m² verandë, në rrugën “{***}”, kundrejt çmimit 55.165 euro, dhe 7.150 euro çmimi verandës, në total, 62.315 euro.

Sipas shpjegimeve të prindërve (nënës), kjo kontratë është bërë për t’u paraqitur në bankë për marrjen e kredisë, me qëllim blerjen e një apartamenti që ata ia kishin premtuar motrës, që ajo të fillonte jetën e saj e pavarur. Duke qenë se kjo gjë nuk u realizua, kredia e financuar nga banka, sipas subjektit, nuk u përdor për “blerjen e apartamentit të premtuar” dhe, për shkak të

njohjes familjare me administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK, z. A. Ç. i është kërkuar nga prindërit ky favor (kontrata e sipërmarrjes), dhe vlera e monetare e kredisë së transferuar në llogari të shoqërisë i është dorëzuar prindërve. Kjo, sipas sqarimeve të subjektit, shpjegon edhe faktin e shlyerjes së shpejtë, para kohe, të kësaj kredie nga prindërit. Në asnjë moment, prindërit nuk janë bërë as pronar/posedues të apartamentit, sipas kontratës së sipërmarrjes. Ky apartament ishte prenotuar në vitin 2005, dhe i është shitur në vitin 2021 një personi tjetër³⁹, ndërsa kontrata e sipërmarrjes me babain daton më 24.06.2009.

34.5. Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, ka konstatuar se në lidhje me këtë kredi, subjekti ka dhënë deklarime kontradiktore, të cilat nuk përputhen me deklaratimet e tij ndër vite, më konkretisht, shpjegimet e subjektit në lidhje me situatën e supozuar se kredia është marrë për blerjen e një apartamenti për motrën, deklarohen për herë të parë në përgjigjet e pyetësorit nr. 1. Gjithashtu, subjekti deklaron për herë të parë që vlera e kredisë nuk është përdorur, por është kthyer duke likuiduar kredinë. Ndërkohë që në shpjegimet dhënë më parë, në deklaratën periodike vjetore 2009, gjatë kontrollit të ILDKPKI-së, në mars 2016 dhe në përgjigjet e pyetësorit, ka sqaruar se është bashkëkredimarrës për kredinë për efekt të ardhurash, pasi familjarët nuk kishin të ardhurat që kërkonte banka, dhe shlyerja e kësaj kredie është kryer nga familjarët, dhe si burim kanë qenë kursimet e tyre dhe të ardhurat nga aktiviteti privat i babait në peshkim. Ai ka sqaruar se kjo kredi nuk është përdorur prej tij, dhe kështu e shlyerjes së kredisë janë bërë nga prindërit dhe familjarët.

34.6. Po kështu, Komisioni ka konstatuar se subjekti, edhe në përgjigjet e pyetësori nr. 1 është kontradiktor në lidhje me shlyerjen e kredisë, pasi fillimisht deklaron se burimi ka qenë të ardhurat e prindërve të tij, dhe më pas deklaron se kjo kredi nuk është përdorur, duke u kthyer. Ky deklaram i subjektit nuk përputhet edhe me deklaratimet e babait të tij më datë 12.12.2012, kur ka deklaruar si burim kursimet e tij dhe hua. Subjekti është kontradiktor në deklaratimin e tij se familjarët nuk kishin të ardhurat që kërkonte banka, ndërkohë që babai i tij deri më 1 mars 2010 ka pasur depozitë në vlerën 24.613 euro, pranë së njëjtës bankës, vlerë e cila, për më tepër, është përdorur si garanci për kredinë e marrë nga subjekti. Deklarimet kontradiktore të subjektit vijojnë, pasi ai ka deklaruar se nuk ka jetuar me prindërit e tij, ndërkohë që është marrë dhe shlyer kjo kredi (shtator i vitit 2009 deri 2012), deklarim i cili nuk përputhet me përgjigjet në pyetësorin standard, se *“apartamenti është bërë i banueshëm që nga fundi i vitit 2009⁴⁰, mbase nga muaji nëntor i atij viti. Kam filluar të jetoj aty me ditë, kryesisht fundjavave në fillim. Kryesisht jetoja në banesën në {***} dhe me prindërit, ndërsa nga nëntori i vitit 2010, kam jetuar në këtë apartament në zonën e {***}”*.

34.7. Nisur nga dokumentacioni në dosje, Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, ka konstatuar se nga subjekti dhe babai janë kryer veprime fiktive në lidhje me këtë kredi. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion për kthimin e shumës nga shoqëria tek ai apo familjarët e tij. Në këtë periudhë, ka qenë në ndërtim apartamenti në rrugën “{***}” dhe kjo shumë mund të ketë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të ndërtimit të këtij apartamenti, dhe duket se nga subjekti është bërë përpjekje për të kryer deklaram të pasaktë, si dhe për të fshehur përdorimin real të kësaj kredie. Ky konstatim përforcohet edhe nga fakti se kjo kredi është marrë

³⁹ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti depoziton kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2005; kontratë e shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.01.2021, nënshkruar mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. M. S.

⁴⁰ I referohet apartamentit në {***}, zona e “{***}”.

në të njëjtën periudhë kur është krijuar pasuria “apartament me sipërfaqe 131 m²”, duke u ngritur dyshime që mund të jetë përdorur për përfundimin e këtij apartamenti. Ndonëse subjekti ka depozituar dokumentacion provues se depozitimet në llogarinë e tij për shlyerjen e kredisë janë kryer nga familjarët e tij, nuk provohet se ata kishin të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e këtyre depozitimeve. Duke marrë në konsideratë: (i) përpjekjen e subjektit për të fshehur përdorimin real të kësaj kredie; (ii) mungesën e të ardhurave të mjaftueshme të ligjshme, të familjarëve të subjektit për shlyerjen e saj; (iii) deklaratimet kontradiktore të subjektit në lidhje me burimin e shlyerjes së kësaj kredie, si dhe të faktit që; (iv) kredimarrës është subjekti, pasi kjo kredi është depozituar në llogarinë e tij dhe jo të ndonjë familjari të tij – Komisioni ka përfshirë në analizë financiare marrjen dhe shlyerjen e kësaj kredie. Nga analiza financiare, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për shlyerjen e kësteve të kredisë për vitin 2010, në vlerën 1.249.298,93 lekë, për vitin 2011, në vlerën 217.993,57 lekë dhe, për vitin 2012, në vlerën 2.555.880,4 lekë.

Në përfundim, në lidhje me kredinë në shumën 3.100.000 lekë, Komisioni ka konstatuar se: (i) kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, i cili ka bërë edhe transferimin e saj te shoqëria “{***}” ShPK; (ii) subjekti, gjatë hetimit, është përpjekur të japë deklaratime të pasakta, me qëllim fshehjen e përdorimit real të kësaj kredie; (iii) kjo kredi mund të jetë përdorur për përfundimin e apartamentit me sipërfaqe 131 m² në rrugën “{***}”, Tiranë; (iv) subjekti është përpjekur për të disatën herë për të shmangur veten nga përfshirja në një marrëdhënie, e cila mund ta penalizojë në procesin e tij të rivlerësimit të pasurisë; (v) prindërit e subjektit nuk kanë pasur nevojë për të marrë kredi, për sa kohë ato kishin një depozitë dhe nuk kishin qëllim siç deklaroi subjekti për blerjen e ndonjë pasurie; (vi) prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për shlyerjen e kësaj kredie; (vii) kredia është shlyer në llogarinë e subjektit, ndërkohë që llogaria mund të hapej në emër të kredimarrësve të tjerë, pa asnjë pengesë ligjore.

34.8. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

34.8.1. Analiza e Komisionit është tërësisht e pabazuar në prova dhe në rrethanat faktike të ndodhura. Kredia është disbursuar në llogarinë e tij bankare, në të cilën është bashkëmbajtëse edhe nëna, më datë 15.10.2009, dhe në të njëjtën datë, është transferuar te shoqëria ndërtimore. Fakti që kredia nuk është paguar nga subjekti, por nga familjarët, provohet nga mandatet e pagesave të kryera, situatë që është lehtësisht e verifikueshme nga lëvizjet e llogarisë së kredisë në NBG Bank ShA. Shumat e shlyera nga babai e kanë burimin te gjendja *cash* në banesë e administruar nga prindërit dhe konkretisht: (i) nga kthimi i shumës mbi 3 milionë lekë nga administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, brenda një jave nga disbursimi i kredisë më datë 15.10.2009; (ii) depozita e lënë si *cash* kolateral për kredinë e subjektit, tërhequr nga babai me pjesë, nga data 1 deri më 16 mars 2010.

34.8.2. Për të mbështetur deklaratimet e tij, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. A. Ç., dhe deklaratën noteriale të nënës së tij, N. H., të cilët deklarojnë ato që pretendon edhe subjekti i rivlerësimit lidhur me arsyet e marrjes së kredisë dhe kthimin e saj. Duke u bazuar në praktikën e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë⁴¹,

⁴¹ *Shih vendimin nr. 199, datë 29.04.2010, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.*

lidhur me fuqinë juridike të akteve zyrtare, subjekti pretendon se, bazuar në nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 4 e nenin 62 pika 1, shkronja “ll”, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, këto deklarata noteriale përbëjnë akte zyrtare, me fuqi të plotë provuese dhe vijnë në përputhje të plotë edhe me aktet e tjera të paraqitura prej tij në cilësinë e provës, si dhe me gjithë deklaratimet dhe shpjegimet e tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklaratat periodike, dhe gjatë hetimit administrativ në Komision.

34.8.3. Lidhur me konstatimin e Komisionit se prindërit e subjektit nuk kanë pasur nevojë për të marrë kredi, për sa kohë kishin një depozitë në të njëjtën bankë në vlerën 24.000 euro, subjekti sqaron se kjo vlerë ndodhej e ngurtësuar si *cash* kolateral dhe, në momentin e nevojës për të blerë apartamentin për motrën, u gjykua të merrej një kredi, përveç depozitës së ngurtësuar të babait, e cila mund të merrej prej tij në çdo moment që prindërit do të kishin nevojë. Në vitin 2009, tregu i pasurive të paluajtshme ishte rritur dhe një apartament kushtonte më shumë se 25 mijë apo 30 mijë euro. Kur prindërit do të ishin gati për të blerë një apartament, depozita e tyre, e vendosur si *cash* kolateral do të thyhej dhe do të zëvendësohej me kolateral pronë, veprim i cili ndodhi në vitin 2010.

34.8.4. Për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme për shlyerjen e kësteve në vitet 2010, 2011 dhe 2012, subjekti ka shpjeguar se kredia nuk është shlyer prej tij, arsye për të cilën nuk është deklaruar as në deklaratat periodike vjetore. Banka, sipas subjektit, do t’i drejtohej atij, vetëm në rast se kredia nuk do të shlyhej rregullisht nga bashkëkredimarrësit e tjerë. Në këto kushte, subjekti i ka kërkuar Komisionit të mos përfshijë në analizën e tij financiare shpenzimet për pagesat e kredisë, të cilat do të duhet t’i ngarkohen familjes së origjinës. Komisioni, sipas subjektit, ka konstatuar se prindërit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kësaj kredie, por nuk ka paraqitur një analizë financiare të tyre. Në analizën financiare të përgatitur nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2008 – 2012, rezulton se familja ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar këstet e kredisë prej 3.100.000 lekësh. Në këtë analizë janë përfshirë si shpenzim pagesat e kësteve të kredisë (principal dhe interesa), ndërsa si të ardhura: të ardhura të babait si person fizik, interesat bankare të depozitës së ngurtësuar të babait në NBG Bank ShA; paga e vëllait; shuma 3 milionë lekë, kthyer prindërve nga shoqëria “{***}” ShPK.

34.9. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor dhe i pavërtetë në qëndrimet që ka mbajtur në Komision, duke vështirësuar në këtë mënyrë realizimin e një analize ligjore dhe financiare të situatës faktike, në të cilat prezantohen rrethanat në këtë çështje. Së pari, është e provuar dhe e pranuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprim fiktiv sa i përket nënshkrimit të kontratës së kredisë, ndërkohë që paraprakisht ishte në dijeni që qëllimi i përcaktuar në të, për blerjen e një apartamenti në rrugën “{***}”, nuk përputhej me qëllimin e vërtetë të përfitimit të kësaj kredie, ndërkohë që ky apartament ishte porositur që në vitin 2005 nga një person tjetër.

Në kuadër të këtij procesi, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklaratime kontradiktore, sa i përket këtyre rrethanave: (i) ka deklaruar se nuk ka jetuar me prindërit e tij, ndërkohë që është marrë dhe shlyer kjo kredi (shtator i vitit 2009 deri 2012), pasi kishte filluar të jetonte tek apartamenti te zona e “{***}”, ndërkohë që në përgjigjet e pyetësorit standard, deklaroi se ky apartament është bërë i banueshëm që nga fundi i vitit 2009, mbase nga muaji nëntor i atij viti. Kam filluar të jetoj aty me ditë, kryesisht fundjavave në fillim. Kryesisht jetoja

në banesën në {***} dhe me prindërit, ndërsa nga nëntori i vitit 2010, kam jetuar në këtë apartament në zonën e {***}; (ii) lidhur me shlyerjen e kredisë, mbahen qëndrime të ndryshme, të tilla si: -- burimi kanë qenë të ardhurat e prindërve dhe, më pas deklaroi se kjo kredi nuk është përdorur duke u kthyer; -- babai në deklaratimet e tij më datë 12.12.2012, deklaroi si burim për shlyerjen, kursimet e tij, të familjes dhe hua marrë nga të njohurit, -- subjekti më pas deklaroi të ketë shërbyer dhe *cash* kolateral, i tërhequr nga babai në mars 2010. Mbeti i paqartë fakti se, përse shuma e përcjellë në shoqërinë “{***}” ShPK, nëpërmjet sistemit bankar, nuk është kthyer në të njëjtën formë, si dhe nuk u provua me dokumentacion, pretendimi i subjektit se shuma 3.100.000 lekë ishte kthyer nga shoqëria brenda javës. Në këto kushte, nisur nga periudha kohore kur janë kryer këto veprime, me të drejtë Komisionit i ka lindur dyshimi se kjo kredi mund të jetë përdorur për ndërtimin e banesës në rrugën “{***}”.

34.10. Pavarësisht se kontrata e kredisë bankare është nënshkruar nga subjekti dhe familjarët e tij, dhe depozitimet në llogarinë bankare të subjektit janë shlyer nga familjarët, përpos sa arsyetuar më sipër, në kushtet kur: (i) kredia është disbursuar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit; (ii) nga aktet e administruara, nuk provohet se prindërit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për kryerjen e këtyre depozitimeve. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion për të provuar ekzistencën dhe ligjshmërinë e të ardhurave të familjarëve; (iii) përpjekjet e subjektit për të mos qenë i vërtetë lidhur me destinacionin real të kredisë prej 3.100.000 lekësh; (iv) përpjekjet e tij për ta shmangur veten nga efektet e kësaj kredie, dhe duke dhënë shpjegime të ndryshme lidhur me burimin e likuidimit të saj, e bëjnë deklaratimin e subjektit të pasaktë, në tentativë për të fshehur qëllimin real të saj, duke vështirësuar në këtë mënyrë kontrollin e verifikimit të pasurisë. Për sa sipër, trupi gjykoës konsideron të drejtë përfshirjen e marrjes dhe shlyerjes së kësaj kredie në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Nga kontrolli i analizës, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në datën 18.03.2010 nuk kishte mundësi të kryente pagesën pjesore të kredisë, për një diferencë negative në shumën (-) 1.249.803 lekë. Në vitet 2011 dhe 2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të përballonte shpenzime, për diferencën negative në vlerën (-) 217.859 lekë, në vitin 2011, dhe 2.555.770 lekë, në vitin 2012, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

35. Në përfundim të arsyetimit më sipër, për pasurinë “apartament me sipërfaqe 131 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, regjistruar në emër të babait të subjektit, duke marrë në konsideratë, kryesisht faktin që subjekti i rivlerësimit ka përfshirë vazhdimisht prindërit në veprimet financiare dhe juridike të kryera në kuadër të krijimit të pasurive të tij, veprime të cilat kanë shërbyer për përfitimet e kredive të financuara nga ish-Banka Kombëtare e Greqisë ShA (sot, “Abi Bank” ShA) në vitet 2008 dhe 2009; deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me periudhën e ndërtimit të kësaj pasurie; veprimet fiktive të kryera me qëllimin përfitimin e kredisë 3.100.000 lekë, më datë 25.09.2009; si dhe në kushtet kur subjekti dhe familja e tij jetojnë në këtë adresë – të krijojnë bindjen se ky apartament është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, duke e vendosur atë në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

B/6. Për analizën financiare të periudhës së rivlerësimit 2004 – 2016

36. Në përfundim të analizës financiare për periudhën prej fillimit të detyrës në vitin 2004 deri në vitin 2016, Komisionit i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur

mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, në vlerën (-) 4.753.315,59 lekë.

37. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se me ndihmën e një eksperti kontabël ka rishikuar analizën financiare të Komisionit, në kuadër të barrës së provës, nga e cila ka rezultuar me pamundësi financiare, në total për të gjithë periudhën e rivlerësimit, në vlerën (-) 877.162 lekë, për të përballuar shtimin e pasurive të paluajtshme, shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve, të shpërndarë në vite, dhe jo në një vit të vetëm, masë e cila, vlerësuar nga praktikantët e Kolegjit⁴², nuk përbën shkak disiplinor proporcional për shkarkim nga detyra.
38. Për analizën financiare për periudhën e rivlerësimit 2004 – 2016, trupi gjykues, në mbështetje të arsytimit dhe konkluzioneve më sipër në këtë vendim, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën e Komisionit dhe konfirmon mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve gjatë periudhës në analizë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
39. Për sa arsyetuar më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit është gjendur në situatat e parashikuara në nenin 33, pikat “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të trupit gjykues gjen zbatim neni 61, pika 3 e këtij ligji, për deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

B/6. Problematika të tjera, të konstatuara në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë

40. Nga analizimi i vendimit të Komisionit dhe i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në kuadër të këtij kriteri, vlerëson të marrë në shqyrtim problematikat lidhur me pasurinë automjeti “Ford Fiesta”, si dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenin 48, të ligjit nr. 84/2016.
41. *Për pasurinë “automjet”, tip “Ford Fiesta”*

41.1. Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore të Komisionit, konstaton se kjo pasuri është blerë nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.12.2006, kundrejt çmimit 500.000 lekë, ndërsa me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.12.2011, nga subjekti i është shitur znj. M. M. (bashkëjetuesja aktuale) në vlerën 350.000 lekë. Këtë automjet, ajo e deklaroi në deklaratën e pasurisë *vetting*.

41.2. Në kuadër të hetimit të kryer, Komisioni ka analizuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kohën e njohjes dhe fillimin e bashkëjetesës, të cilën subjekti e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2014, në rubrikën ku deklarohet rrethi i personave të lidhur. Nga analizimi i të dhënave TIMS, sipas së cilave ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe M. M. rezultojnë të kenë udhëtuar së bashku nga data 25.12.2007 e në vijim, si dhe shpjegimeve të dhënave gjatë hetimit administrativ, sa i përket njohjes, lidhjes dhe bashkëjetesës, Komisioni i konsideruar si përpjekje e tij për të dhënë një deklaram të pasaktë, me qëllim justifikimin e veprimeve fiktive të kryera midis tij dhe bashkëjetueses, në lidhje me automjetin, tip “Ford Fiesta”.

⁴² Vendimet nr. 38/2021 (JR), nr. 17/2022 (JR), nr. 2/2023 (JR), nr. 4/2023 (JR) dhe nr. 19/2022 (JR).

41.3. Ndryshe nga Komisioni, trupi gjykues nuk konstaton qëndrime kontradiktore të subjektit në shpjegimet e tij lidhur me kohën e njohjes me bashkëjetuesen, fillimin e lidhjes dhe bashkëjetesës⁴³. Megjithatë, në kushtet kur momente të tilla janë të vështira për t'u konfirmuar, trupi gjykues e fokusoi analizën e tij vetëm te veprimet e kryera mes tyre, në lidhje me këtë automjet.

41.4. Për këtë automjet, nga të dhënat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, rezultoi se subjekti ka prerë polica sigurimi në emër të tij, në cilësinë e përdoruesit për periudhat 25.02.2012 – 24.02.2013 dhe 07.03.2013 – 06.03.2014. Po kështu, bashkëjetuesja ka prerë polica sigurimi për këtë automjet, në cilësinë e përdorueses për periudhën 2010 – 2011. Pra, bashkëjetuesja rezulton përdoruese përpara se ta blinte automjetin, dhe subjekti rezulton përdorues dhe pas shitjes së tij.

41.5. Fakti që subjekti ka vijuar ta përdorë këtë mjet, provohet edhe nga të dhënat e rezultuara nga procedimi penal nr. {***}, viti 2017⁴⁴. Referuar akteve të fashikullit penal, rezulton se në Komisionin e Policisë Belsh është bërë kallëzim penal nga shtetasi L. D., për vjedhjen e targave të mjetit “Ford Fiesta”, në pronësi të znj. M. M., që përdorej prej tij për një periudhë kohe prej 8 muajsh. Targat e mjetit, sipas kallëzuesit, ishin vjedhur në pikën e servisit ku ai para dy muajsh e kishte çuar për shkak të defektit. Në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka sqaruar se me këtë person ai ka qenë në shkollë të mesme (gjimnaz) bashkë, shoqëri të cilën e ruajnë akoma dhe automjeti i ishte lënë atij në ruajtje për shkak të një defekti. Subjekti ka paraqitur në Komision edhe deklaratën noteriale të datës 29.06.2024, të shtetasis L. D.

41.6. Për sa më sipër, ndonëse subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij, ndër të tjera, i është referuar vendimit unifikues nr. 932, datë 22.06.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁴⁵, lidhur me veprimet fiktive, si dhe detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 3, pika 6, dhe nenin 6, të ligjit 10076/2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, dhe dispozitave përkatëse të Kodit Rrugor për prerjen e policave të sigurimit për përdorimin e automjetit, trupi gjykues nuk i gjen të besueshme veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me të, pasi znj. M. e ka përdorur këtë automjet përpara se ta blinte, si dhe subjekti ka vijuar ta përdorë edhe pas shitjes, fakt i përforcuar nga rrethanat e rezultuara nga procedimi penal lidhur me këtë automjet, në të cilin z. L. D. (shok i subjektit) deklaroi se e ka përdorur prej 8 muajsh, për më tepër kur, nga shitja e këtij automjeti, është pretenduar krijimi i gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2011. Këto rrethana janë marrë në konsideratë nga trupi gjykues sipas nenit 2, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të vlerësimit tërësor të pasurisë.

42. Lidhur me adresën në rrugën “{***}”, Tiranë

⁴³ Subjekti ka deklaruar se me bashkëjetuesen është njohur në kohën kur ajo punonte në Komisionin e Policisë Elbasan, gjatë periudhës shkurt 2005 deri korrik 2006. Në korrik 2006, bashkëjetuesja ka filluar punë në Tiranë, ku banonte edhe subjekti, dhe fillimisht janë shoqëruar si miq. Miqësia vijoi më tej me lidhjen, e cila u konsolidua në mesin e vitit 2009. Ndërkohë, bashkëjetesa filloi në vitin 2014.

⁴⁴ Procedimi penal është regjistruar më datë 16.02.2017 dhe, për shkak se nuk ishte bërë i mundur zbulimi i autorëve, më datë 22.02.2017 ishte marrë vendimi “Për pezullimin e hetimeve për procedimin nr. {***}, të vitit 2017”.

⁴⁵ Në këtë vendim, Gjykata e Lartë shprehet: “Në rastet e fiktivitetit dhe te simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre”.

42.1. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi pranë NBG Bank, rruga “{***}”, pallatet te kryqëzimi, ngjyrë e kuqe, shkalla {***}, apartamenti nr. {***}⁴⁶. E njëjta adresë është deklaruar edhe nga nëna e tij.

42.2. Në këto kushte, Komisioni i ka kërkuar informacion subjektit mbi pronarin e kësaj pasurie, kohën kur është përdorur kjo pasuri, dokumentacionin e blerjes dhe burimin e ligjshëm që ka shërbyer për të. Subjekti ka sqaruar se kjo adresë duhet të jetë deklaruar nga nëna e tij gjatë veprimeve për marrjen/shlyerjen e kredisë në lekë në NBG Bank ShA, për shkak të të qenët bashkëkredimarrës. Subjekti ka sqaruar se nuk ka jetuar ndonjëherë në këtë adresë, por atje kanë banuar për disa kohë prindërit, së bashku me motrën A. H.⁴⁷. Nga prindërit është informuar se pronari ka qenë një person i quajtur H., mbiemrin e të cilit nuk e mbajnë në kujtesë. Subjekti nuk e ka njohur apo takuar ndonjëherë pronarin e këtij apartamenti, dhe as nuk e ka përdorur ndonjëherë këtë apartament, duke qenë në pamundësi, në këto kushte, për të vënë në dispozicion ndonjë informacion apo të dhënë tjetër.

42.3. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni konstaton, ndër të tjera, se subjekti i kishte të gjitha mundësitë të merrte të dhëna të plota në lidhje me këtë apartament, duke vënë në dispozicion të Komisionit kopje të certifikatës së pasurisë së këtij apartamenti, si dhe dokument që të vërtetojë marrjen me qira të këtij apartamenti. Në shpjegimet e tij, subjekti ka sqaruar se, duke mos jetuar asnjëherë në këtë banesë dhe, për shkak të kohës së gjatë, nuk arrin të identifikojë vendndodhjen e saj për të bërë të mundur marrjen e dokumentacioni pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Edhe nëse do të kishte siguruar të dhënat kadastrale të kësaj pasurie, marrja e informacionit pa aprovim apo miratim të pronarit të pasurisë do të ishte në kufijtë e cenimit të mbrojtjes së të dhënave personale. Kalimi i një barre të tillë prove, që detyron subjektin të marrë informacion mbi të dhënat pasurore të një pasurie, e cila nuk i përket dhe nuk është objekt i procesit të rivlerësimit, cenon hapur mbrojtjen e të dhënave personale të palëve të treta, të cilat nuk kanë pasur marrëdhënie me subjektin.

42.4. Komisioni në vendim ka vlerësuar se: “[...] Prindërit e subjektit, por edhe subjekti kanë të drejtën ligjore për të marrë informacion, pasi nuk kemi të bëjmë me një pasuri që nuk lidhet me ta, por me një pasuri që kanë pasur të paktën një marrëdhënie qiradhënieje. Për subjektin ka qenë shumë e lehtë të shkojë në këtë banesë, të kontaktojë pronarin dhe të kërkojë të dhëna të plota, pasi marrëdhënia e krijuar nga prindërit e tij është një marrëdhënie e njohur nga Kodi Civil. Nëse nga ana e pronarit do të refuzohej dhënia e këtyre të dhënave, subjekti mund të paraqiste një kërkesë në Komision për marrjen e provave dhe Komisioni, në zbatim të parashikimeve të nenit 49-50 të ligjit nr. 84/2016, do të siguronte të gjithë informacionin e nevojshëm për qartësimin e kësaj pasurie. Komisioni vlerëson se këto shpjegime të subjektit, si dhe përpjekja e tij për të shmangur dhënien e një informacioni të plotë, është bërë më qëllim fshehjen e kësaj pasurie, të cilën subjekti mund ta ketë blerë me kontratë porosie dhe më pas ta ketë tjetërsuar, pa qenë nevoja e regjistrimit pranë ASHK-së. Megjithatë nuk u arrit të provohet

⁴⁶Referuar akteve përcjellë nga ABI Bank ShA me shkresën nr. {***} prot., datë 02.02.2021, subjekti i rivlerësimit Neritan Hoxha, nga fleta e printuar “Customer record”, rezulton adresa “{***}, pall. te kryqëzimi, ngjyrë e kuqe, shk. {***}, k. {***}, ‘mobile’ {***}”. Në këtë adresë rezulton edhe adresa për klientin e bankës, N. H.

⁴⁷ Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., N. H. deklaroi se këtë apartament e kanë marrë me qira, ku kanë jetuar në periudhën qershor – korrik 2007, ajo, bashkëshorti dhe vajza e tyre A. për shkak të situatës familjare.

fshehja e kësaj pasurie, Komisioni vlerëson se refuzimi për të dhënë shpjegime nga ana e subjektit duhet të klasifikohet sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, si dhe do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë”.

42.5. Subjekti i rivlerësimit në ankim, ndër të tjera, pretendon se është i padrejtë ngarkimi i një barre prove të tillë, për sa kohë subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamundësi objektive për të marrë informacion shkresor lidhur me këtë banesë. Nëse Komisioni do të kishte pasur dyshime të caktuara, do të duhej të kishte hetuar dhe verifikuar në mënyrë shteruese çdo rrugë administrative për kërkimin e dokumentacionit, të cilin, fakti që nuk arriti ta sigurojë, nuk do të thotë që automatikisht të përbëjë barrë prove për subjektin.

42.6. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk është angazhuar mjaftueshëm për të provuar të kundërtën e barrën së provës dhe as nuk i ka drejtuar Komisionit kërkesën për marrjen e provës, lidhur me faktin se kujt i përket banesa në rrugën “{***}”, Tiranë, për të qartësuar përfundimisht situatën e tij para organit rivlerësues. Barra e provës në këtë proces për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisioni i përket subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur prova e fakte të nevojshme për këtë qëllim. Mungesa e predispozicionit të subjektit të rivlerësimit për të paraqitur dokumentacionin provues lexohet si qëndrim refuzues i subjektit të rivlerësimit dhe klasifikohet sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë bashkëpunues provohet edhe nga depozitimi me parashtrimet në Kolegj, i akteve të pronësisë mbi këtë apartament⁴⁸. Këto rrethana janë marrë në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor të pasurisë.

43. Problematikat e konstatuara në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë, që lidhen kryesisht me veprime fiktive të kryera nga subjekti i rivlerësimit, si dhe mungesa e bashkëpunimit për të dhënë informacione në drejtim të kontrollit të plotë të pasurisë, u përfshinë në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Duke e konsideruar të mjaftueshëm arsyetimin në këtë vendim, për të arritur në vlerësimin përfundimtar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues e çmoi të panevojshëm analizimin e shkaqeve të tjera të ankimit lidhur me mobilimin e banesave apo pasuritë e paluajtshme në emër të bashkëjetueses, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to nuk do të përmbyste vlerësimin lidhur me këtë çështje.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

*C/1. Për kallëzimin nr. {***}, regjistruar më datë 30.03.2012*

44. Komisioni në vendim ka vlerësuar se *subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga pika 2 e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*
45. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton këtë konkluzion me të njëjtat pretendime si në rezultatet e hetimit administrativ në Komision, të cilat do të evidentohen më poshtë.
46. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, lidhur me këtë kallëzim penal, konstaton dhe vlerëson si vijon:

⁴⁸ *Kontratë shitblerje nr. {***}/*** rep./kol., datë 22.07.2008; dokumente të tjera pronësie, si vërtetim hipotekor, hartë treguese dhe plan rievimi etj., si dhe prokurë e përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2007.*

46.1. Më datë 25.03.2012 është marrë njoftim se në lagjen “{***}”, në objektin e z. H. B. janë dëmtuar punëtorët, A. Sh. dhe Q. S., banorë të qytetit të Gramshit, të cilët prej një jave ishin duke punuar me shkëputje në objektin në ndërtim. Më datë 25.03.2012, kanë qenë duke bërë një mur guri mbajtës dhe, në përfundim të punës, kur do të largoheshin, shkëputet një pjesë dheu, e cila rrëshqet dhe i zë një pjesë të këmbëve. Menjëherë ka ndërhyrë pronari i objektit, si dhe punëtorë të tjerë, të cilët i kanë ndihmuar dhe dërguar në spital.

46.2. Subjekti i rivlerësimit, më datë 24.04.2012, ka vendosur mosfillimin e procedimit për materialin hetimor nr. {***}, datë 30.03.2012. Pas analizimit të akteve të ekspertimit mjekoligjor nr. {***}, dhe nr. {***}, datë 24.04.2012, për dy të dëmtuarit, Q. S. dhe A. Sh., subjekti në këtë vendim ka arsyetuar se dëmtimet e këtyre personave nuk hyjnë në kategorinë e plagosjes së rëndë dhe, për pasojë, mungojnë elementet e nevojshme, që fakti të parashikohet nga ligji si vepër penale, dhe plotësohen kushtet për mosfillimin e procedimit penal.

46.3. Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ ka konstatuar se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me pajisjen e z. H. B. me leje ndërtimi nga organet kompetente, për kryerjen e punimeve. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, ka prapësuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi bazën e materialit të referuar nga Komisariati i Policisë Gramsh, ka regjistruar materialin hetimor për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Përveç sa argumentuar në vendimin për mosfillimin e procedimit penal, se mungojnë elementet e nevojshme që fakti të parashikohet nga ligji si vepër penale, subjekti sqaron se të dëmtuarit nuk e kanë kundërshtuar këtë vendimmarrje të prokurorit, konfirmuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan⁴⁹. Subjekti ka shpjeguar se materiali hetimor i dërguar nga Komisariati i Policisë referon për këtë ngjarje dhe jo për vepra të tjera penale, si dhe se vendimmarrja e tij është gjetur e drejtë dhe ligjore nga Zëvendësdrejtuesi i Prokurorisë dhe, më pas, edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë.

46.4. Komisioni ka vlerësuar se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk janë bindëse dhe se ai nuk mund të paraqesë si argument referimin e veprës penale. Organi i prokurorisë është një organ i pavarur dhe, për rrjedhojë, nuk mund të mbështetet në kryerjen e hetimeve në referimet e kryera nga organet e tjera, në rastin në fjalë nga Komisariati i Policisë. Nga analizimi i dokumentacionit të referuar, konstatohet se dëmtimi i personave është bërë gjatë kohës që po ndërtonin një objekt, për rrjedhojë, subjekti duhet të kryente të gjitha veprimet hetimore për të verifikuar nëse në këtë objekt po ndërtohej me leje, konform legjislacionit në fuqi apo kishim të bënim me një ndërtim pa leje, i cili klasifikohet si vepër penale.

46.5. Trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë kallëzim penal. Vepra penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar në nenin 199/a të Kodit Penal, është miratuar nga ligjvënësi si një nga dispozitat e këtij Kodi në vitin 2008, në këto kushte, ka qenë në fuqi në kohën e regjistrimit të këtij kallëzimi. Kallëzimi është një prej mënyrave me të cilat fillon një procedim penal. Në dallim nga padia në një gjykim civil, e cila e kufizon gjykatën, për sa i përket kufijve të shqyrtimit të çështjes, kallëzimi nuk e pengon organin e akuzës që ta shtrijë hetimin edhe për vepra të tjera të papërmendura në të, nëse konstatohen elemente të tyre. Kallëzimi penal nuk e kufizon prokurorin vetëm te cilësimi juridik apo faktet e referuara nga

⁴⁹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 05.07.2024.

kallëzuesi. Organi i akuzës ka një rol proaktiv në kryerjen e një hetimi, në zbulimin e veprave penale, autorëve të këtyre veprave dhe vënien e tyre përpara përgjegjësisë. Për sa më sipër, me të drejtë, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga pika 2 e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

*C/2. Për kallëzimin nr. {***}, regjistruar më datë 09.10.2013*

47. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin që në këtë ngjarje kishte edhe një person të plagosur rëndë, ka vlerësuar se *subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) [...] nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore [...], në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) vendimi i mosfillimit të procedimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.*
48. Subjekti i rivlerësimit e gjen të pavend dhe të pambështetur në ligj dhe në prova konkluzionin e Komisionit me pretendimet se: (i) Nëse aktet e dosjes do të ishin studiuar me kujdes nga një profesionist i fushës, nuk do të kishte nevojë për shpjegime nga subjekti, pasi përgjigjet gjenden në aktet e dosjes hetimore. (ii) Gjendja e rëndë shëndetësore apo e rrezikshme për jetën, siç është shprehur edhe eksperti mjekoligjor në aktin e tij, e ka bërë objektivisht të pamundur pyetjen e të dëmtuarit. (iii) Konstatimi i Komisionit se subjekti nuk ka administruar asnjë dokument nga organet tatimore për të provuar punësimin e të dëmtuarit, si dhe të punonjësve të tjerë, është i pabazuar, pasi Komisioni nuk ka marrë parasysh shpjegimet dhe provat pjesë të dosjes hetimore, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. (iv) Është e pavend dhe jologjike të pretendosh që për çdo ngjarje apo fakt të ndodhur, prokurori të kërkojë dokumentacionin e shoqërisë dhe të verifikojë lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të saj. (v) Prokurori ushtron ndjekjen penale, duke hetuar faktin penal dhe vërtetuar elementet e veprës penale, të parashikuar si të tillë në Kodin Penal; nuk është inspektorat pune, inspektorat teknik, agjent doganor/tatimor apo organ administrativ, që të verifikojë nëse subjektet e veprës penale janë pajisur me dokumentacion apo ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me këtë dokumentacion, përveçse kur ky dokumentacion është pjesë përbërëse e ekzistencës së elementeve të veprës penale, si ato të parashikuara nga disa nene të Kodit Penal⁵⁰. (vi) Konkluzioni i Komisionit është i pabazuar në prova, pasi nga provat e dosjes hetimore provohet e kundërta e përfundimit të nxjerrë nga Komisioni.
49. Trupi gjykues nga analizimi i akteve të dosjes, konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

49.1. Sipas informacionit për referimin e veprës penale te prokurori më datë 07.10.2013, rezulton se në sallën operative të Komisarariatit të Policisë Gramsh është njoftuar se në spitalin e

⁵⁰ Neni 170/c, “Ushtrimi pa licencë i veprimeve bankare”; neni 170/ç, “Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare”; neni 173, “Kontrabanda me mallra të licencuar”; neni 201/b, “Transportimi i mbetjeve”; neni 201/c, “Aktivitetet e rrezikshme”; neni 201/ç, “Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”; neni 284, “Kultivimi i bimëve narkotike”.

qytetit të Gramshit ka ardhur i dëmtuar shtetasi A. K., me banim në fshatin {***}, Komuna {***}. Oficeri i policisë gjyqësore (në vijim “OPGj”) ka shkuar në urgjencën e spitalit dhe ka marrë takim me të afërmit që e shoqëronin, pasi vetë i dëmtuari nuk mund të jepte shpjegime për shkak të gjendjes shëndetësore në të cilën ndodhej. I dëmtuari ishte i punësuar në shoqërinë “{***}” ShPK, me veprimtari shfrytëzimin e pyjeve për lëndë drusore. Personat e marrë në pyetje nga OPGj-ja, punëtorë pranë kësaj firme, kanë deklaruar se janë me kontratë pune e të siguruar, si dhe janë njohur me rregullat e sigurimit teknik çdo fillim muaji nga inxhinierja, duke firmosur procesverbalin përkatës.

49.2. Nga aktekspertimi mjekoligjor nr. {***}, datë 18.10.2013, i Institutit të Mjekësisë Ligjore, është arritur në konkluzionin se dëmtimet *hyjnë në kategorinë e plagosjeve të rënda, pasi ato kanë pasur rrezik për jetën e shtetasit A. K., në momentin e shkaktimit të tyre, po të mos i jepej atij ndihma e parë dhe e kualifikuar mjekësore.* Në fashikullin penal janë administruar: kontrata individuale e punës së të dëmtuarit, lidhur më 01.08.2013; librezë e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe; 3 (tri) procesverbale instruktimi të punonjësve në punë, të datave 01.08.2013, 01.09.2013 dhe 01.10.2013.

49.3. Sipas përmbajtjes së kontratës individuale të punës, të nënshkruar mes administratorit të “{***}” ShPK, dhe punëmarrësit A. K., në nenin 9 i titulluar “Kushtet e punës”, përcaktohet: *Punëdhënësi ka për detyrë t’i sigurojë punëmarrësit kushte të favorshme për punë për sigurimin dhe mbrojtjen në punë sigurimin e kushteve higjieno-sanitare normale e sigurimin teknik, mjete mbrojtëse dhe të gjitha kushtet e tjera të punës, që caktohen në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë (në përputhje me nenet 39 - 75).*

49.4. Më datë 11.11.2013, prokurori Neritan Hoxha merr vendimin për mosfillimin e procedimit penal për materialin hetimor nr. {***} regj., datë 11.11.2013, që bën fjalë për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se dëmtimi nuk ka ardhur si shkak i shkeljes së rregullave në punë, pasi siç deklarojnë punëtorët e kolegët e të dëmtuarit, ata janë njohur me rregullat e sigurimit teknik, por ka ardhur si pasojë e rrëshqitjes së një trangu druri, i cili, sipas punëtorëve, mund të ketë shërbyer si shkak për lëvizjen e objektit që mendohet se ka goditur të dëmtuarin. Në vendim citohet se: *Referuar akteve të ndodhura në dosjen hetimore, organi i akuzës arrin në konkluzionin se mungon lidhja shkakësore ndërmjet veprimeve/mosveprimeve të subjektit të kësaj vepre penale dhe pasojës së ardhur në këtë ngjarje, dëmtimi i rëndë i shtetasit A. K.*

49.5. Me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për këto konstatime: (i) *nuk është urdhëruar kryerja e aktekspertimit teknik në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj;* (ii) *nuk është thirrur për të deklaruar i dëmtuari, z. A. K.;* (iii) *nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë nga organet tatimore për të verifikuar deklarimin e punësimit të dëmtuarit dhe punonjësve të tjerë të pyetur në këtë procedim;* (iv) *subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit.* Për sa më sipër, Komisioni shprehet se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, në përfundim të tyre, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Për rrjedhojë, vendimi i mosfillimit është i paargumentuar dhe jobindës në

konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje.

49.6. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në vendimin e mosfillimit të procedimit penal ka arsyetuar se mungonte lidhja shkakësore ndërmjet veprimeve/mosveprimeve të subjektit të kësaj vepre penale dhe pasojës së ardhur, dëmtimi i rëndë i z. A. K., sipas parashikimit të nenit 13 të Kodit Penal se “*askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore*”. Prokurori ka arritur në këtë konkluzion mbi bazën e dëshmimeve të dëshmitarëve okularë në vendin e ngjarjes, të cilët kanë parë e shpjeguar dinamikën e saj. Në këto rrethana, nga ana e subjektit të rivlerësimit është vlerësuar se nuk ka qenë e nevojshme kryerja e aktit të ekspertimit teknik, për sa kohë ishin të sqaruara rrethanat e ngjarjes dhe shkaqet e ndodhjes së saj. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se pjesë e fashikullit të këtij materiali hetimor janë edhe aktet e administruara nga OPGj-ja, si vijon: (i) kontratë individuale pune, datë 01.08.2013, e punëmarrësit A. K.; (ii) vërtetim i komisionit mjekësor në lidhje me aftësinë për punë të tij; (iii) kopje e librezës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nr. {***} e të dëmtuarit, ku figuron pagesa e sigurimeve për muajt gusht – shtator 2013; (iv) procesverbale për instruktimin e punonjësve në punë, nënshkruar nga inxhinierja dhe punonjësit, ndër ta edhe A. K. Sa më sipër, subjekti pretendon se konkluzioni i tij është mbështetur në të dhëna të verifikuara dhe që gjejnë pasqyrim në dosjen penale.

49.7. Në vijim të prapësimeve, ashtu si pasqyruar në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, subjekti ka shpjeguar se mosmarrja e deklaramentit të të dëmtuarit ka ardhur për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, i cili është dërguar në Spitalin Ushtarak në Tiranë për ndihmë më të specializuar, ku dhe ka qëndruar deri në datën e bërjes së aktit mjekoligjor, më datë 18.10.2013. Vendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është kundërshtuar nga i dëmtuari dhe është gjetur i drejtë e i bazuar nga Drejtuesi i Prokurorisë. Për sa i përket faktit se subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet /licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, kryerja e këtyre veprimeve verifikuese nuk ka asnjë rëndësi thelbësore, që të ndikojë në cilësinë e këtij hetimi, në vendimmarrjen e prokurorit apo, aq më tepër në cilësimin juridik të veprës penale.

49.8. Trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për të sqaruar shkaqet e aksidentit / ngjarjes, e për pasojë, do të duhej të vazhdonte hetimet dhe t'i jepte zgjidhje të plotë çështjes. Vendimi i mosfillimit të procedimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. Subjekti i rivlerësimit ka arritur në konkluzionin se mungon lidhja shkakësore, sa i përket respektimit të rregullave të mbrojtjes në punë, me ardhjen e pasojës, duke u bazuar formalisht në disa procesverbale instruktimi në punë, pa thelluar hetimin në drejtim të verifikimit nëse i dëmtuari ishte pajisur atë ditë me mjetet mbrojtëse në punë, *kaskë mbrojtëse, syze mbrojtëse, doreza, veshje etj.*, gjë që do të zbardhej nga urdhërimi i kryerjes së aktit të ekspertimit teknik, për të përcaktuar nëse ka pasur shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë.

49.9. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pabazueshmërinë e konstatimeve të Komisionit, sa i përket mosadministrimit të dokumentacionit nga organet tatimore, për të provuar punësimin e të dëmtuarit apo verifikimin e pajisjes së shoqërisë me lejet / licencat /

autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, trupi gjykues i gjen të pabazuara, pasi nga vetë praktika e ndjekur nga subjekti i rivlerësimit në një rast tjetër të ngjashëm [procedimi penal nr. {***}, viti 2015, në ngarkim të të pandehurit A. K.], ai, përveçse ka regjistruar procedimin penal, ka urdhëruar edhe kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, ndër të tjera: (i) të kërkohej informacion dhe dokumentacion pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Elbasan për pajisjen me lejen e shfrytëzimit të parcelës dhe nëse ishte ushtruar kontroll periodik në aktivitetin e subjektit shfrytëzues; (ii) të kërkohej informacion në tatime, sigurime shoqërore për shoqërinë; (iii) të kryhej një akt ekspertimi teknik për të përcaktuar nëse ka shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë etj. Në këtë procedim është kërkuar, ndër të tjera, informacion edhe nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, dega Elbasan, lidhur me inspektimet e kryera.

49.10. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbyste barrën e provës dhe se dokumentacioni në dosjen hetimore (procesverbalet e instruktimit, kontrata e punës apo kopje e librezës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) është i pamjaftueshëm për të konkluduar në mungesë të lidhjes shkakësore mes veprimit / mosveprimet dhe pasojës së ardhur, për të cilën është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Për sa më sipër, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit se kryerja e këtyre veprimeve verifikuese nuk ka asnjë rëndësi thelbësore në cilësinë e këtij hetimi, vendimmarrjen e prokurorit apo cilësimin juridik të veprës penale, përveçse jobindëse, janë edhe të pabazuara. Në këto kushte, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, nëpërmjet moskryerjes së veprimeve hetimore të nevojshme dhe marrjes së një vendimi të paargumentuar dhe jobindës, është i drejtë, dhe këto mangësi të subjektit afektojnë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

*C/3. Për procedimin penal nr. {***}/2008*

50. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se në këtë procedim penal kishte edhe viktima të veprës penale, çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se ai nuk i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
51. Subjekti i rivlerësimit në ankim e kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, duke e konsideruar atë të pavend dhe të pabazuar në ligj dhe në prova, e duke pretenduar se: (i) Komisioni është mjaftuar me një përsëritje literale të gjetjeve në aktin “Relacion mbi rezultatet e hetimeve të datës 23.06.2024”, ndërkohë që subjekti ka dhënë shpjegimet të qarta e të detajuara në lidhje me gjetjet, duke rrëzuar barrën e provës së kaluar nga Komisioni. (ii) Nga provat e administruara në dosje, rezultojnë e provuar dhe pa asnjë dyshim, se nuk ka qenë e nevojshme administrimi i listëpagesave të shoqërisë nga organet tatimore, për të verifikuar deklarin e punësimit të ligjshëm të viktimave, të të dëmtuarëve dhe punonjësve të tjerë të pyetur, dhe është i pabazuar në prova ky konstatim i Komisionit, duke rrëzuar barrën e provës edhe për këtë gjetje / konstatim të Komisionit.; (iii) Bazuar në nenin 3, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, prokurori ushtron ndjekjen penale, duke hetuar faktin penal dhe vërtetuar elementet e veprës penale, të parashikuar si të tilla në Kodin Penal; nuk është as inspektorat pune, as inspektorat teknik, as agjent tatimor/doganor dhe as organ administrativ që të verifikojë nëse janë pajisur subjektet e veprës penale me

dokumentacion apo ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me këtë dokumentacion, me përjashtim kur lejet / licencat /autorizimet janë pjesë përbërëse e ekzistencës së elementeve të veprës penale.

52. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes lidhur me këtë procedim penal, konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

52.1. Më datë 14.01.2008 ka ndodhur një shpërthim në uzinën e çelikut, {***}, nën administrimin e shoqërisë turke “{***}” ShA. Grupi hetimor i ngritur ka shkuar në vendngjarje dhe, nga këqyrja ka konstatuar se në furrën e prodhimit të çelikut ka ndodhur një shpërthim, ku është dëmtuar pjesërisht furra e shkrirjes së skrapit, si dhe kanë pësuar dëmtime shëndetësore disa punonjës⁵¹ të uzinës, të cilët ishin duke punuar në momentin që ka ndodhur shpërthimi, nga i cili ka gjetur vdekjen edhe shtetasi Xh. N., si dhe kanë pësuar dëmtime shëndetësore disa punonjës të uzinës. Më pas, nga plagët e marra nga shpërthimi, ka gjetur vdekjen në spital edhe shtetasi V. J. Fillimisht, për këtë procedim kanë qenë ngarkuar tre prokurorë, D. B., B. N. dhe Neritan Hoxha, më pas veprimet hetimore u kryen nga këta dy të fundit.

52.2. Më datë 15.01.2008, prokurorët B. N. dhe Neritan Hoxha kanë urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2008, për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, e parashikuar nga neni 289/2 i Kodit Penal. Në regjistrin e njoftimit të veprave penale shënohen emrat e personave nën hetim, A. U., M. F. dhe E. Z. Po në këtë datë, i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për inxhinierin e sigurimit teknik në uzinën e prodhimit të çelikut, z. E. Z. Gjykata, me vendimin nr. {***}, datë 18.01.2008, i cili ka marrë formë të prerë, ka pranuar kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe ka caktuar masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”. Pas kërkesës së prokurorëve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 01.02.2008, vendosi pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

52.3. Të njëjtat kërkesa, prokurorët kanë bërë dhe për dy personat e tjerë, M. F. dhe A. U., për të cilët kanë kërkuar vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, për të cilët gjykata, po ashtu ka vendosur të caktojë masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”. Gjykata, po ashtu ka pranuar kërkesën e prokurorëve për caktimin e masës së sigurimit ndaj tyre, atë të “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, parashikuar nga neni 232 i Kodit të Procedurës Penale.

52.4. Sipas aktekspertimit teknik, datë 16.01.2008, të kryer nga grupi i ekspertëve të fushës përkatëse (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), është arritur në konkluzionin se: -- shpërthimi nuk është pasojë e shkeljes së rregullave të sigurimit teknik në punë, -- shkak i mundshëm i shpërthimit të ndodhur është prania e lagështirës në muraturën e furrës nga rrjedhjet që nuk mund të dallohen me sy, sepse ndodhen në pjesën e brendshme të furrës, e cila, në kohën e shpërthimit, ka qenë në proces normal pune.

52.5. Organi i akuzës ka konstatuar se akti nuk është i plotë, pasi ekspertët nuk i janë përgjigjur pyetjes “a ka shkelje të rregullave të mirëmbajtjes së furrës, nëse po, ku konsistojnë ato?”. Me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe një konkluzioni sa më shkencor, është marrë vendimi për kryerjen e një ekspertimi shtesë nga të njëjtët ekspertë, për t’u dhënë përgjigje

⁵¹ V. Sh., V. M., E. M., M. D., A. I., E. S.

pyetjeve lidhur me: (i) zbatimin e rregullave të sigurimit teknik para marrjes së punës në dorëzim si, kontrolli i gjendjes së makinerive, pajisjeve të linjave të aparateve matëse dhe, nëse ka shkelje, cili person është përgjegjës; (ii) faktin nëse prania e lagështirës mund të dallohej dhe fenomeni të parandalohet, po të ishte kontrolluar furra para marrjes së punës (turnit) në dorëzim dhe, nëse ky proces nuk është kryer sipas rregullave të sigurimit teknik, cili është personi përgjegjës. Me aktin shtesë të datës 31.01.2008, ekspertët kanë ritheksuar përfundimet e ekspertizës se shpërthimi i ndodhur nuk është pasojë e shkeljes së sigurimit teknik në punë por prania e lagështirës në muraturën e furrës nga rrjedhjet që nuk mund të dallohen me sy, pasi ndodhen në pjesën e brendshme të furrës, e cila në kohën e shpërthimit ka qenë në proces normal pune.

52.6. Nga organi i akuzës, me vendimin e datës 30.05.2008, është vendosur kryerja e një riekspertimi tjetër me grup ekspertësh të fushës përkatëse (të ndryshëm nga të parët). Sipas aktekspertimit teknik, datë 21.07.2008, është arritur në konkluzionin se shkaku i eksplozionit ka qenë lagështira e muraturës në pjesën e vrojtuar si mjaft të dëmtuar, ndërsa shkaku i lagështirës së muraturës ka qenë rrjedhja e ujit nga paneli anësor me ftohje uji direkt në muraturë. Sipas mendimit të ekspertëve në këtë akt ekspertimi, nuk ka mungesë të respektimit të rregullave teknologjike e të sigurimit teknik në punë, që të jetë përgjegjëse për ndodhjen e aksidentit dhe nuk ka pasur gabim njerëzor, si përgjegjës i ngjarjes.

52.7. Më datë 05.11.2008, prokurorët B. N. dhe Neritan Hoxha marrin vendimin për pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 15.01.2008, shuarjen e masave të sigurimit për personat nën hetim, kthimin e pasaportave të sekuestruara, kthimin e librit të instruktimit të punonjësve, si dhe të përmbledhjes së rregullave të sigurimit teknik të shoqërisë “{***}” ShA. Në këtë vendim, ndër të tjera arsyetohet se: *Nga analiza e të gjitha provave të administruara, si këqyrja e vendit të ngjarjes, sekuestrimi i provave shkresore⁵², pyetja e deklaruesve, aktekspertimet teknike etj., rezulton se shkaktimi i vdekjes së shtetasve V. J. dhe Xh. N., si dhe plagosja e rëndë e shtetasit M. D., nuk ka ardhur si pasojë e shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë.*

52.8. Në rezultatet e hetimit administrativ, nga analizimi i fashikullit penal, Komisioni ka konstatuar se: (i) nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar faktin se viktimat dhe të dëmtuarit kishin marrë instruktimin e rregullave të mbrojtjes në punë; (ii) nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë nga organet tatimore, për të verifikuar deklarin e punësimit të viktimave, të dëmtuarve dhe punonjësve të tjerë të pyetur në këtë procedim; (iii) nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar aftësinë profesionale të viktimave dhe të dëmtuarve; (iv) subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet / licencat / autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit. Në këto kushte, Komisioni i kalon barrën e provës për konstatimin se, *duket se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.* Në prapësimet mbi këto rezultate, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

⁵² Me procesverbalin “Për sekuestrimin e provave materiale”, datë 14.01.2008, nga OPGj-ja është sekuestruar: 1. Libër i instruktimit të punonjësve të Uzinës së Çelikut, me 31 fletë; 2. Rregullat e sigurimit teknik të fabrikës, prill 2004. Kjo sekuestro është vlefshuar nga prokurorët B. N. dhe Neritan Hoxha, me vendimin e datës 15.01.2008. Procesverbal, datë 14.01.2008, “Për sekuestrimin e kartonëve (kohëshënues) të punëtorëve të turnit të dytë, të datës 14.01.2008, në {***}”. Në listën e kartonëve rezulton me nr. Xh. N., me numër kartoni nr. {***}, lista emërore e 60 punonjësve të uzinës së çelikut që, më datë 14.01.2008, kanë qenë në punë turni i dytë, ndër të cilët V. J., përgjegjës turni, dhe Xh. N., teknik shkrirjeje.

52.8.1. Nga OPGJ-të, është bërë shoqërimi dhe pyetja e një sërë punonjësish të kësaj uzine, si dhe është bërë sekuestrimi i rregullores së sigurimit teknik në punë për të gjitha repartet e prodhimit të çelikut. Për këtë ngjarje, janë marrë vendimet për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor për të gjithë të dëmtuarit, me qëllim përcaktimin e shkallës së dëmtimeve të pësuar, si dhe për personat e vdekur për të përcaktuar shkakun e vdekjes. Gjithashtu, janë marrë vendimet për kryerjen e ekspertimit teknik, duke përcaktuar ekspertë të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, si dhe me grup ekspertësh të fushës përkatëse, sipas mendimit të të cilëve, nuk ka pasur mungesë të respektimit të rregullave teknologjike e të sigurimit teknik në punë, që të jetë përgjegjëse për ndodhjen e aksidentit. Ka rezultuar se firma “{***}” ka nxjerrë rregullat e sigurimit teknik për të gjitha repartet, të cilët janë firmosur nga përgjegjësi për sigurimin teknik, inxhinier E. Z., dhe drejtori M. G. Nga të dhënat e regjistrit të sigurimit teknik, rezulton se nga inxhinieri është bërë instruktimi, informimi dhe kualifikimi për rregullat e mbrojtjes në punë për të gjithë punëtorët e firmës.

52.8.2. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se Inspektorati Shtetëror i Punës, Drejtoria Rajonale Elbasan, me Urdhrin nr. {***} datë 16.01.2008, ka urdhëruar pezullimin e punës. Ky urdhër i është komunikuar Drejtorit të Përgjithshëm të “{***}” ShA, si dhe Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Shtetëror të Punës (në vijim “IShP”). Ky i fundit ka miratuar pezullimin e punës për një kohë të pacaktuar, deri në momentin që shoqëria të paraqesë dokumentacionin në përputhje me vendimin nr. 513, datë 30.07.2004, të Këshillit të Ministrave⁵³. Pas kërkesës së paraqitur nga “{***}” ShA, Drejtoria Rajonale Elbasan e IShP-së, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.06.2008, ka miratuar dhënien e lejes për fillimin e punës në repartin e çelikut. Nga analiza e të gjitha provave të administruara, si këqyrja e vendngjarjes, sekuestrimi i provave shkresore, pyetja e deklaruesve, aktekspertimet teknike etj., rezulton se shkaktimi i vdekjes së punonjësve V. J. dhe Xh. N., si edhe plagosja e rëndë e punëtorit M. D., nuk kanë ardhur si pasojë e shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë.

52.8.3. Vepra penale *Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë*, parashikuar nga neni 289/2 i Kodit Penal, kërkon njëkohësisht plotësimin e dy kushteve, ardhjen e pasojave të parashikuara në këtë dispozitë, si dhe që shkakun i ardhjes së tyre, të jetë shkelja e rregullave në punë nga personi i ngarkuar për marrjen e masave në respektimin e tyre. Në kushtet kur mungon kushti i dytë, mungojnë elementet e nevojshme që fakti të parashikohet nga ligji si veprë penale dhe, rrjedhimisht, plotësohen kushtet për pushimin e procedimit penal.

52.8.4. Subjekti i rivlerësimit, në vijim ka sqaruar se pjesë e fashikullit të këtij procedimi penal kanë qenë libri i instruktimit të punonjësve të uzinës së çelikut i përbërë prej 31 fletësh, si dhe rregullorja e sigurimit teknik të fabrikës, prill 2004, dokumente të sekuestruara me procesverbalin e datës 14.01.2008 nga OPGJ-ja, dhe të vleftësuar nga prokurorët me vendimin e datës 15.01.2008. Ekspertët e caktuar nga organi i prokurorisë për kryerjen e riekspertimit teknik, në analizën që bëjnë mbi këtë ngjarje, i referohen edhe neneve të rregullores së sigurimit teknik dhe librit të instruktimit. Në përfundim të hetimit nga prokurorët, në përputhje me nenin 190 të Kodit të Procedurës Penale, është urdhëruar kthimi i dokumenteve të sekuestruara shoqërisë “{***}” ShA. Gjithashtu, nga OPGJ-ja, me procesverbalin e datës 14.01.2008, janë sekuestruar 60 kartonë kohëshënues të punëtorëve të turnit të dytë, më datë 14.01.2008 (dita e

⁵³ *Vendimi nr. 513, datë 30.07.2004, i Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e veprimtarisë dhe për dokumentacionin e procedurën për dhënien e lejes nga inspektori i punës, para vënies në punë të ndërmarrjes”.*

ngjarjes), që kanë qenë duke punuar. Sekuestrimi i këtyre dokumenteve është vleftësuar nga prokurorët e çështjes me vendimin e datës 15.01.2008. Në fashikullin hetimor është administruar edhe lista emërore e punëtorëve të uzinës së çelikut, që kanë qenë në punë turni dytë në atë datë, nënshkruar nga drejtori i uzinës dhe vulosur, në të cilën është përcaktuar edhe pozicioni i punës për secilin prej tyre.

52.8.5. Për sa më sipër, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka qenë i nevojshëm administrimi i listëpagesave të shoqërisë nga organet tatimore për të verifikuar deklarin e punësimit të viktimave, të të dëmtuarve dhe punonjësve të tjerë të pyetur. Si argument shtesë, subjekti përmend faktin që shoqëria i është nënshtruar edhe kontrollit nga ISHP-ja, Drejtoria Rajonale Elbasan. Korrespondencën me këtë të fundit, organi i prokurorisë e ka administruar në dosje. Për konstatimin e Komisionit se prokurori nuk ka hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet / licencat / autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, subjekti, ashtu si për kallëzimin më sipër, ka pretenduar se kryerja e këtyre veprimeve verifikuese nuk ka asnjë rëndësi thelbësore me ndikim në cilësinë e hetimit apo vendimmarrjes së prokurorit, apo cilësimin juridik të veprës penale, duke marrë në konsideratë edhe konkluzionet e ekspertëve në dy aktet e ekspertimit të kryera. Subjekti i rivlerësimit ka përmendur se vendimmarrja e tij është gjetur e drejtë dhe ligjore nga Drejtuesi i Prokurorisë, dhe nuk është kundërshtuar në gjykatë nga subjektet procedurale.

52.9. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se për këtë procedim penal, Komisioni ka konstatuar ndër të tjera se nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë nga organet tatimore për të verifikuar deklarin e punësimit të viktimave, të të dëmtuarve dhe punonjësve të tjerë të pyetur në këtë procedim. Trupi gjykues konstaton se në dosjen hetimore është administruar shkresa nr. {****} prot., datë 25.06.2008, e ISHP-së, Drejtoria Rajonale Elbasan, e cila ka miratuar *dhënien e lejes për fillimin e punës në repartin e çelikut, në respektim të të gjitha masave dhe kushteve të përcaktuara në paketën e sigurisë dhe shëndetit në punë*. Ndonëse kërkesa drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan do të jepte një tablo më të qartë lidhur me regjistrimin e punonjësve, ligji nr. 9634, datë 30.10.2006, “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, përkatësisht neni 15 i tij, “Mjetet e ndërhyrjes në rastin e shkeljes të legjislacionit të punës”, parashikon se inspektori, ndër të tjera, është i autorizuar të urdhërojë marrjen e masave të menjëhershme për detyrimin e punëdhënësit, për të paraqitur dokumentin e degës përkatëse të tatimeve për deklarin dhe pagesën e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë punëmarrësit apo dhe të pezullojë punën, kur nuk zbatohen detyrimet për të paraqitur vërtetimin e zyrës përkatëse të punësimit për regjistrimin e punëmarrësve pranë kësaj zyre. Në këto kushte, konstatimi i Komisionit duket i tejkaluar.

52.10. Nga ana tjetër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime në drejtim të faktit nëse viktimat dhe të dëmtuarit ishin të pajisur me mjetet mbrojtëse të nevojshme në punë, pajisje personale mbrojtëse të përshtatshme për rreziqet e mundshme në ambientet e punës si, temperatura e lartë apo rreziqet mekanike respektive, në funksion të pozicionit të punës. Po kështu, nuk rezulton të jetë administruar dokumentacioni për të vërtetuar aftësinë profesionale të viktimave dhe të të dëmtuarëve. Hetimi merr një rëndësi më të madhe kur pasojat e ngjarjes janë vdekja dhe plagosja e rëndë e punëtorëve. Prokurori, në raste të tilla, duhet të jetë kritik dhe i kujdesshëm në ndërmarrjen e veprimeve hetimore, si në zbardhjen dhe zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes, ashtu edhe në impaktin publik që kanë këto ngjarje. Për rastin konkret,

fakti që hetimet janë ndjekur nga dy prokurorë, nuk e përjashton përgjegjësinë individuale të subjektit për moskryerjen e plotë dhe efektive të veprimeve të nevojshme hetimore.

52.11. Trupi gjykues i Kolegjit, edhe në këtë rast vlerëson se mangësitë e konstatuara në hetim afektojnë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

*C/4. Për procedimin penal nr. {***}/2009*

53. Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) Subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore. Në rrethanat kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. (ii) vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
54. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit duke e konsideruar atë të pabazuar në ligj dhe në prova, me pretendimet se: (i) Komisioni, në arsyetimin e tij është mjaftuar me një përsëritje fjalë për fjalë të gjetjeve të tij në relacionin mbi rezultatet e hetimeve, ndërkohë që subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me to, duke rrëzuar barrën e provës. (ii) Për një njohës të legjislacionit penal e procedural penal, është qartazi e provuar dhe argumentuar përse nuk është kryer akti i ekspertimit. Në këto rrethana, edhe konstatimi i Komisionit është i pabazuar në prova e ligj. (iii) Prokurori ka kryer veprimin e urdhëruar nga Drejtuesi i Prokurorisë, aktin e ekspertimit mjekoligjor për të dëmtuarin, për të përcaktuar kategorinë e dëmtimeve shëndetësore të tij. Prokurori nuk ka pasur asnjë indicie për të dyshuar në lidhje me konkluzionin e ekspertit mjekoligjor për kategorinë e dëmtimeve të shtetasit E. Ç., për të vijuar me hetimin në këtë drejtim. (iv) Vendimi i pushimit nga prokurori nuk është kundërshtuar nga i dëmtuari. (v) Është e pavend dhe alogjike të pretendosh që, për çdo ngjarje apo fakt të ndodhur, prokurori duhet të kërkojë dokumentacionin e shoqërisë dhe të verifikojë lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të saj. (vi) Konkluzionin përfundimtar të Komisionit, subjekti i rivlerësimit e gjen të pabazuar në prova dhe, jo vetëm kaq, por nga provat pjesë e dosjes hetimore, provohet e kundërta e këtij konkluzioni. Arsyetimi i vendimit dhe konkluzion i prokurorit ka qenë i bazuar në të dhënat e mbledhura nga veprimet hetimore dhe provat pjesë e fashikullit të hetimit.
55. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore lidhur me këtë procedim penal, konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

55.1. Më datë 16.11.2009, në lagjen “{***}”, Elbasan, në pikën e inerteve të firmës “{***}”, është dëmtuar duke punuar, punëtori i kësaj firme, E. Ç., dhe është dërguar në spitalin kirurgjik për ndihmë mjekësore, duke qenë jashtë rrezikut për jetën. Puna e të dëmtuarit konsistonte në mbushjen e karrocave me material dhe, atë ditë, meqë makineritë nuk ishin në funksionim, i dëmtuari kishte shkuar për të ndihmuar një shokun e tij në pastrimin e përzierësit dhe materialeve. Në kohën që kanë qenë duke pastruar, aty ka ardhur punonjësi V. S., i cili përpara

se të ulte poshtë kovën e përzierësit, ka njoftuar kolegët të bënin kujdes. Gjatë këtij procesi, kova ka takuar në një gur dhe kavoja është kthyer mbrapsht, duke e ngritur sërish kovën. Nga kjo, punëtori E. ka rënë brenda përzierësit dhe V. është përprjekur të ndalojë funksionimin e makinerisë. Nga shpejtësia, ka shtypur gabimisht një buton tjetër, i cili ka vënë në funksionim rrotullimin e kovës, dhe E. ka rënë brenda në kazan, çka ka bërë që të dëmtohej.

55.2. Më datë 18.11.2009, prokurori M. T. urdhëron regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, si dhe urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore. Mbas studimit të materialit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2009, prokurori, më datë 30.12.2009, ka marrë vendimin për pushimin e çështjes penale.

55.3. Më datë 15.01.2010, Drejtuesi i Prokurorisë ka marrë vendimin për shfuqizimin e vendimit të pushimit, datë 30.12.2009, dhe ka ngarkuar për kryerjen e veprimeve të tjera procedurale prokurorin Neritan Hoxha. Në këtë vendim shfuqizimi, drejtuesi i prokurorisë shprehet se: *Nga ana e prokurorit janë kryer shumë veprime hetimore, por nuk është kryer ekspertimi mjekoligjor në lidhje me dëmtimet e shkaktuara shtetasit E. Ç. Kryerja e veprimit hetimor, siç është ekspertimi mjekoligjor, është e domosdoshme, me qëllim hetimin e plotë të këtij procedimi penal. Për këto arsye, vendimi i pushimit nuk është i bazuar në ligj, pasi nuk janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, mbi të cilat duhet të vendoset në lidhje me zgjidhjen e çështjes.*

55.4. Me vendimin e datës 01.03.2010, është vendosur kryerja e ekspertimit mjekoligjor dhe sipas aktdëshmisë mjekoligjore nr. {***}, datë 17.03.2010, të Institutit të Mjekësisë Ligjore, konkludohet se dëmtimet hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve, që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë, më tepër se 9 (nëntë) ditë.

55.5. Më datë 25.03.2010, subjekti i rivlerësimit merr vendimin për pushimin e procedimit penal, duke konsideruar se dëmtimet hyjnë në kategorinë e plagosjes së lehtë, në kuptim të Kodit Penal. Vepra penale e parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal kërkon njëkohësisht dy kushte, së pari, ardhjen e disa pasojave të parashikuara në këtë dispozitë, të cilat janë vdekja e një personi ose plagosja e rëndë e tij, dhe, së dyti, këto pasoja të kenë ardhur si shkak i shkeljes së rregullave në zbatim të tyre. Në këtë rast, sipas subjektit, mungojnë elementet e nevojshme që fakti të parashikohet nga ligji si vepër penale dhe të plotësohen kushtet për pushimin e procedimit penal.

55.6. Nga verifikimi i fashikullit penal, Komisioni ka konstatuar se: (i) Nuk është urdhëruar kryerja e aktekspertimit teknik, në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj. (ii) Në aktdëshmi ligjore mjekësore, datë 17.03.2010, përcaktohet se më 16.11.2009 është shtruar pacienti E. Ç., në gjendje jo të mirë. Pasi tregohet gjendja e pacientit, vijohet duke deklaruar se, po në këtë ditë është nisur për në spitalin e Ohrit. Nga subjekti, nuk rezulton të jenë vijuar hetimet në lidhje me gjendjen shëndetësore të të dëmtuarit për të përcaktuar përfundimisht nëse jemi përpara plagosjes së rëndë ose jo, në mënyrë të tillë që të vendosej pushimi i procedimit. (iii) Nuk është thirrur për të deklaruar i dëmtuari z. E. Ç. (iv) Në dokumentin lista emërore e punëtorëve në periudhën qershor – gusht, rezulton personi F. B., i cili ka deklaruar se nuk është punonjës i shoqërisë, por kishte shkuar të takonte disa shokë. (v) Në dokumentin lista emërore e punëtorëve, periudha shtator – nëntor 2009, rezulton se emri “E. Ç.” është shtuar me dorë dhe ka një firmë në nëntor 2009. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të verifikuar, së pari, nëse ky emër është shtuar pas aksidentit, si dhe së dyti, nëse

firma është e tij. (vi) Nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar faktin se i dëmtuar kishte marrë instruktimin e rregullave të mbrojtjes në punë. (vii) Nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë nga organet tatimore, për të verifikuar deklarin e punësimit të të dëmtuarve dhe punonjësve të tjerë të pyetur në këtë procedim. (viii) Nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar aftësinë profesionale të shtetasit V. S., si dhe marrjen nga ana e tij të instruktimit të rregullave të mbrojtjes në punë; (ix) Subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet / licencat / autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit. Për këto arsye, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe, për rrjedhojë, vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje.

55.7. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se ka vepruar në zbatim të detyrës së lënë nga Drejtuesi i Prokurorisë, duke marrë vendimin e datës 01.03.2010, për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor dhe duke caktuar ekspertin mjekoligjor. Referuar aktekspertimit mjekoligjor nr. {***}, datë 17.03.2010, ka rezultuar se tek i dëmtuari E. Ç. është konstatuar frakturë e hapur e këmbës së djathtë dhe krahut të djathtë, dëmtime të cilat janë shkaktuar me mjet mprehës. Këto dëmtime, sipas subjektit, hyjnë në kategorinë e atyre, që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, pra hyjnë në kategorinë e plagosjes së lehtë, në kuptim të Kodit Penal. Nga prokurori, është kryer i vetmi veprim procedural, i urdhëruar nga Drejtuesi i Prokurorisë. Pas administrimit të tij, është vendosur pushimi i procedimit penal me argumentin se, nga veprimet hetimore të kryera, rezultoi se mungojnë elementet e nevojshme, që fakti të parashikohet nga ligji si vepër penale, pasi dëmtimet e shtetasit E. Ç. nuk hyjnë në kategorinë e plagosjes së rëndë, por plagosje e lehtë, sipas konkluzionit të aktekspertimit mjekoligjor. Vendimmarrja e subjektit është gjetur e drejtë dhe ligjore nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe i dëmtuari nuk e ka kundërshtuar atë në gjykatë.

55.8. Subjekti, në vijim ka shpjeguar se përshtkrimi i faktit është bërë i njëjtë me atë të prokurorit M. T., relacionin e OPGJ-së, si dhe vendimin e Drejtuesit për shfuqizimin e vendimit të pushimit. Shpjegimet e personave të pyetur janë të mbajtura me shkrim dore. Për sa kohë dëmtimet janë kategorizuar si plagosje e lehtë, për qëllime të hetimit, nuk është më e nevojshme kryerja e aktit të ekspertimit teknik, pasi mungesa e pasojës, si element i anës objektive të veprës penale përbën shkak për moskryerjen e veprimeve të tjera hetimore. Për sa i përket konstatimit, se emri i të dëmtuarit është i shkruar me shkrim dore, referuar akteve të administruara në dosje, i dëmtuari nuk është i vetmi që ka emrin të shënuar me shkrim dore dhe emri i tij gjendet në listën e personave të instruktuar. Siç dhe referon vetë Komisioni, z. F. B. rezultonte në dokumentin “lista emërore e punëtorëve”, në periudhën qershor – gusht, ndërsa ngjarja ka ndodhur më 16 nëntor 2009. Në dosjen hetimore është administruar dokumentacioni i shoqërisë “{***}” ShPK, rregullorja e sigurimit teknik, si dhe lista emërore e punonjësve për periudha të ndryshme. Fakti nëse i dëmtuari kishte marrë instruktimin e rregullave të mbrojtjes në punë do të ishte verifikuar nga organi i akuzës, nëse do të plotësohej elementi i anës objektive të kësaj veprës penale, plagosja / dëmtimi i rëndë i të dëmtuarit. Procedimi penal është pushuar pikërisht për këtë arsye, mungesës së elementeve të veprës penale. Lidhur me faktin se subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet / licencat / autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, subjekti nuk i ka vlerësuar me rëndësi këto veprime verifikuese, për hetimin, vendimmarrjen apo cilësimin e veprës penale.

55.9. Referuar nenit 24/4 të Kodit të Procedurës Penale, “Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët”, dhe nenit 3/c, të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk përbëjnë objekt refuzimi, vendimet e marra në rrugë hierarkike, në zbatim të ligjit procedural penal. Bazuar në këto parashikime ligjore, për trupin gjykues duket që subjekti i rivlerësimit ka respektuar detyrën e përcaktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë. Prokuroria funksiononte mbi parimin e varësisë hierarkike dhe detyrat e lëna nga prokurori më i lartë ishin detyruese për prokurorin më të ulët.

Megjithatë, legjislacioni i zbatueshëm nuk e kufizonte prokurorin të kryente, përveç këtij veprimi, edhe veprime të tjera hetimore në kuadër të zbardhjes së ngjarjes, cilësimin e veprës penale, përgjegjësisë së autorëve të saj dhe zgjidhjes së çështjes. Ashtu si arsyetuar edhe nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se nga subjekti i rivlerësimit: (i) nuk është urdhëruar kryerja e aktekspertimit teknik, në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj; (ii) nuk rezulton të kenë vijuar hetimet në lidhje me gjendjen shëndetësore të të dëmtuarit për të përcaktuar përfundimisht nëse jemi përpara plagosjes së rëndë ose jo, në mënyrë të tillë që të vendosej pushimi i procedimit; (iii) nuk është thirrur për të deklaruar i dëmtuari, z. E. Ç.; (iv) nisur nga mënyra e evidentimit të emrave në listat e punëtorëve, subjekti nuk ka kryer hetim për të verifikuar vërtetësinë e tyre; (v) nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar faktin nëse i dëmtuari dhe shtetasi V. S. kishin marrë instruktimin e rregullave të mbrojtjes në punë apo për të vërtetuar aftësinë profesionale të tyre; (vi) nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë nga organet tatimore për të verifikuar deklarimin e punësimit të të dëmtuarve dhe punonjësve të tjerë të pyetur në këtë procedim; (vii) subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet / licencat / autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit. Mungesa e këtyre veprimeve hetimore, për pasojë, e bën të paargumentuar dhe jobindës vendimin për pushimin e procedimit penal. Për sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se hetimet nuk ishin të plota dhe se subjekti duhet t’i vazhdonte ato, për pasojë, edhe vendimi i pushimit ishte i paargumentuar dhe jobindës, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

*C/5. Për procedimin penal nr. {***}/2005*

56. Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë faktin se kishte një të vdekur, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart; në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) vendimi i pushimit të procedimit penal është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
57. Përpos pretendimeve të ngritura në kallëzimet / procedimet e tjera, lidhur me mungesën e arsytimit të vendimit, mbi shpjegimet e dhëna nga subjekti në drejtim të cenimit e mundësisë për ankim efektiv apo kërkesën alogjike që, për çdo ngjarje të ndodhur, prokurori të administrojë dokumentacionin e shoqërisë dhe të verifikojë lejet / licencat / autorizimet e nevojshme për

kryerjen e aktivitetit të saj, për këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit ka ngritur këto shkaqe ankimore: (i) Nëse Komisioni ka vlerësuar se mund të kishte elemente të ndonjë vepre tjetër penale, të parashikuar nga Kodi Penal, duhet ta parashtronte në vendim që t'i krijonte mundësinë subjektit të paraqiste argumente dhe arsyet ligjore për mungesën e një vepre tjetër penale, të aluduar nga Komisioni. (ii) Në analizë të fakteve dhe legjislacionit në fuqi në kohën e veprës penale, mbikëqyrësi i punimeve, përgjegjës sipas ligjit, duhet të ishte ai i caktuar / emëruar në objektin ku po kryheshin punime dhe jo mbikëqyrësi i shoqërisë “{***}” ShPK, pasi ngjarja nuk ka ndodhur në ambientet e kësaj shoqërie, por në ndërtesën me investitor privat. (iii) Lidhur me konstatimin e Komisionit për ndërtim pa leje ndërtimi, neni 199/a i Kodit Penal, “Ndërtimi i paligjshëm”, është shtuar në Kodin Penal në vitin 2012. Referuar parimit të ligjshmërisë, kjo vepër penale nuk ishte parashikuar ende si e tillë. (iv) Në kushtet kur personat A. K. dhe A. S. kanë qenë të punësuar si ustallarë privatë dhe nuk kanë qenë të punësuar te ndonjë subjekt (sipërmarrës), nuk ka qenë e nevojshme të kërkohej administrimi i listëpagesave nga organet tatimore për të verifikuar deklarin e punësimit të ligjshëm të viktimave, të të dëmtuarëve dhe punonjësve të tjerë të pyetur. Si rrjedhim, nuk ka as elemente të veprës penale të punësimit të paligjshëm, e cila, sipas nenit 170/a të Kodit Penal, kërkon si kusht për ekzistencën e kësaj vepre aplikimin e një mase të mëparshme administrative ndaj punëdhënësit. (v) Rezulton e provuar dhe pa asnjë dyshim se nuk ka qenë e nevojshme administrimi i listëpagesave të shoqërisë nga organet tatimore për të verifikuar deklarin e punësimit të ligjshëm të viktimave, të dëmtuarëve dhe punonjësve të tjera të pyetur, dhe është i pabazuar në prova ky konstatim i Komisionit, duke rrëzuar barrën e provës edhe për këtë gjetje / konstatim të Komisionit.

58. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve në dosje lidhur me këtë procedim penal, konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

58.1. Në sipërfaqen e tokës të z. J. T. në fshatin {***}, në të cilin po ndërtohej një objekt dykatësh, më datë 16.12.2005, po hidhej beton me pompë me një mjet të firmës “{***}”, i drejtuar nga shtetasi G. K. Për të bërë punimet në objektin që po ndërtonte, investitori J. T. kishte punësuar shtetasit A. K., A. H., B. R., I. S., M. Ll., si punëtorë ndërtimi, dhe shtetasin J. Xh. si elektrikist, të cilët drejtoheshin nga z. A. S. Gjatë kohës së hedhjes së betonit, shembet një pjesë e soletës së katit të dytë dhe, punonjësit që ishin duke punuar rrëzohen dhe pësojnë dëmtime trupore. Njëri prej tyre, elektrikisti J. Xh., ka gjetur vdekjen, ndërsa dy të tjerë, B. R. dhe A. H., kanë pësuar dëmtime.

58.2. Më datë 20.12.2005, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.

58.3. Referuar dokumentit “akt teknik ekspertize”, të inxhinierit F. S., shkaqet kryesore të shembjes së soletës kanë qenë: *ngarkimi i skelës së armaturës mbajtëse të soletës me ngarkesa më të mëdha se ngarkesat e lejuara, që ka ndodhur për disa arsye: 1. Tubacionet e skelës janë vendosur në distanca më të mëdha se ato normale, nga 80-100 cm të lejuara, në 115-150 cm në fakt, duke u ngarkuar jashtë aftësive të tyre mbajtëse. 2. Zgjatimi i tubave të skelës në të dyja anët me fileto është jashtë kushteve teknike, duke ulur aftësinë mbajtëse të tyre e, veçanërisht vertikalisht. 3. Përdorimi i skelerive të amortizuara dhe jo të mirëmbajtura. 4. Përqendrimi i zbrazjes së betonit nga pompa, duke rritur ngarkesën në puntela të veçanta që kanë humbur aftësinë mbajtëse. 5. Mungesa e kontrollit të specializuar teknik, para e gjatë betonimit.*

58.4. Subjekti i rivlerësimit, më datë 17.03.2006, merr vendimin për pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 20.12.2005. Në këtë vendim, subjekti arsyeton se: *Vepra penale e "Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë", e parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, kërkon së pari ardhjen e disa pasojave të parashikuara në këtë dispozitë, të cilat janë: a) vdekja e një personi; b) plagosja e rëndë e një personi, pasoja të cilat të kenë ardhur nga mosrespektimi i rregullave në punë, të përcaktuara në ligj, në aktet e Këshillit të Ministrave apo në rregulloret e sigurimit teknik, disiplinës, apo mbrojtjes në punë. [...] Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, [...] Këshilli i Ministrave ka nxjerrë Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", me ndryshimet përkatëse. [...]. Mbikëqyrësi bën kontrollin për zbatimin e punimeve (pika 3); materialet në objekt përdoren vetëm me miratimin e mbikëqyrësit të punimeve (pika 9); asnjë punim nuk do të betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit të punimeve (pika 13), si dhe; mbikëqyrësi mban përgjegjësi ligjore për gjithçka që ka miratuar (pika 15). Për sa i përket rastit konkret, objekti në fshatin {***}, me investitor shtetasin J. T., nga hetimi rezulton se ky objekt ndërtohet pa leje ndërtimi dhe projekt zbatimi. Gjithashtu, për këtë objekt nuk ka të emëruar një mbikëqyrës të punimeve, i cili të bëjë kontrollin për zbatimin e punimeve në këtë objekt, në përputhje me kushtet teknike dhe rregullat e sigurimit teknik, apo të kontrollojë materialet që u përdorën në ndërtimin e këtij objekti, duke marrë masat për mënjanimin e pasojave të ardhura. Për sa më sipër, duke ndjekur analizën e faktit të ndodhur, në datën 16.12.2005 rezulton që mungojnë elementet e nevojshme që fakti të parashikohet nga ligji si vepër penale dhe, rrjedhimisht, plotësohen kushtet për pushimin e procedimit penal.*

58.5. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se: (i) objekti po ndërtohej pa leje ndërtimi dhe pa projekt zbatimi; (ii) një prej të dëmtuarve ka ndërruar jetë, duke pasur një viktimë; (iii) nga ana e investitorit, nuk është marrë asnjë masë, sipas parashikimeve ligjore, në lidhje me ndërtimin, detyrim ligjor i cili i përkiste këtij të fundit; (iv) nga deklaratimet e investitorit, por dhe të dëshmitarëve, është konstatuar se investitori ka caktuar një drejtues punimesh; (v) ndërkohë që po hidhej beton, punëtorët ishin duke punuar; (vi) për hedhjen e betonit ishte angazhuar një shoqëri juridike. Për sa më sipër, sipas Komisionit, rezultojnë elemente të nevojshme për të pasur vepër penale, elemente të cilat nuk janë analizuar nga subjekti.

58.6. Lidhur me veprimet hetimore, Komisioni ka konstatuar se: (i) nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar aftësinë profesionale të personave që kanë hedhur betonin, si dhe marrjen nga ana e tyre të instruktimit të rregullave të mbrojtjes në punë; (ii) subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë së betonit me të gjitha lejet / licencat / autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit; (iii) subjekti nuk rezulton të ketë urdhëruar akt ekspertimi në lidhje me gjendjen teknike të automjetit (betonieres); (iv) nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë së betonit nga organet tatimore, për të verifikuar deklarinimin e punësimit të punonjësve që po hidhnin beton; (v) nuk është pyetur i dëmtuari tjetër, B. R. Për këto arsye, sipas Komisionit, subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe vendimi i pushimit të procedimit penal është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura. Konkluzionet e tij mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. Konkluzioni i subjektit, në aspektin arsyetues, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm, të pasqyruar në një paragraf. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të barrës së provës, ka prapësuar si në vijim:

58.6.1. Në deklarimet e tij, investitori J. T. ka deklaruar se për ndërtimin e objektit nuk kishte leje ndërtimi. Ai ka punësuar si kryeusta z. A. S. dhe se, ditën që po hidhej betoni i soletës së katit të dytë, aty ishin edhe shumë punëtorë të cilët nuk ua dinte emrat. Të pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit, shtetasit G. K. dhe V. C. kanë deklaruar se janë të punësuar në shoqërinë “{***}”, dhe në datën 16.12.2005 kanë qenë duke hedhur beton në ndërtesën ku ka ndodhur ngjarja, në fshatin {***}. Shtetasit A. K. dhe A. S. kanë deklaruar se punojnë në ndërtim si ustallarë privatë dhe, së bashku me I. S. kanë filluar ndërtimin e objektit. Në datën 16.12.2005, pasi kishin bërë gati armaturën për hedhjen e betonit për soletën e katit të dytë, rreth mesditës ka filluar hedhja e betonit me anë të pompës. Si punëtorë, atë ditë kanë qenë edhe F. H., M. Ll., B. R., si dhe elektrikisti J. Xh. Sipas këtyre personave, projektin e ndërtesës e kishte sjellë pronari nga Greqia dhe, për ndërtimin e tij nuk kishte një projekt inxhinieriko-teknik dhe as një përgjegjës për zbatimin e tij.

58.6.2. Vepra penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, e parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, kërkon mosrespektim të rregullave të përcaktuara në ligj, aktet nënligjore apo rregulloret përkatëse, nga personat e ngarkuar me respektimin e tyre. Nga hetimi ka rezultuar se objekti po ndërtohej pa leje ndërtimi dhe nuk kishte të emëruar një mbikëqyrës të punimeve, i cili të bënte kontrollin për zbatimin e punimeve në përputhje me kushtet teknike dhe rregullat e sigurimit teknik, apo të kontrollojë materialet që u përdoren në ndërtimin e këtij objekti, duke marrë masat për mënjanimin e pasojave të ardhura. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka marrë pjesë në këqyrjen e vendit të ngjarjes.

58.6.3. Në vendimin e pushimit të procedimit penal, sipas subjektit, është bërë një analizë e faktit, provave të mbledhura dhe legjislacionit në fushën e ndërtimit. Nga prokurori është konkluduar se përgjegjësia ligjore i përket subjektit “mbikëqyrës i punimeve”, i licencuar, ndërkohë që nga hetimet nuk rezultoi një i tillë. Në këtë çështje ka një viktimë, ka elemente të shkeljes së rregullave në punë, të analizuara nga eksperti në aktin e ekspertimit, por mungon subjekti i posaçëm për këtë vepër penale, pra nuk ka një “drejtues punimesh” në kriteret që përcakton ligji / aktet nënligjore. Ligji njih dy subjekte, zbatuesin e punimeve dhe mbikëqyrësin e punimeve, të cilët janë persona fizikë ose juridikë të pajisur me licencën përkatëse, dhe jo çdo “usta” apo “kryeusta”. Udhëzimi përcakton se në rastin e investitorëve privatë emri i mbikëqyrësit depozitohet së bashku me kërkesën për leje ndërtimi. Urbanistika ligjore dhe policia e ndërtimit detyrojnë emërimin e mbikëqyrësit, në rastet kur ky emërim anashkalohet nga investitori. Në udhëzim janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e mbikëqyrësit. Subjekti ka sqaruar se vendimmarrja e tij është gjetur e drejtë nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe nuk e është kundërshtuar në gjykatë.

58.7. Trupi gjykues i Kolegjit, në rastin konkret, vëren se arsyetimi dhe pretendimi i subjektit se: *në këtë çështje ka një viktimë, ka elemente të shkeljes së rregullave në punë, të analizuara nga eksperti në aktin e ekspertimit, por mungon subjekti i posaçëm për këtë vepër penale, pra nuk ka një “drejtues punimesh”*, duket si sjellje e tij në drejtim të trajtimit të çështjeve penale, që lidhen me hetimin e veprave penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, të cilat kanë sjellë si pasojë humbjen e jetës së qytetarëve, me një neglizhencë të dukshme e me një qasje gati të paracaktuar drejt mungesës së përcaktimit të përgjegjësisë, përderisa në të gjitha këto raste, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të shmangë nga hetimi dhe përgjegjësia një kategori shumë të mundshme për të qenë e tillë, siç janë shoqëritë juridike / sipërmarrëse / ndërtuese. Ndonëse qëndron ajo që pretendon subjekti i rivlerësimit, se “ndërtim i paligjshëm” nuk ishte parashikuar në atë kohë si vepër penale, por është shtuar me ligjin nr. 10 023, datë

27.11.2008, nga aktet rezulton e provuar se në ndërtimin e objektit ishte angazhuar edhe një shoqëri ndërtimore, “{***}” ShPK, dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar lidhur me gjendjen teknike të pajisjeve të kësaj shoqërie, të përfshira në ndërtimin e objektit, nëpërmjet aktekspertimit. Po kështu, subjekti nuk ka ndërmarrë veprime të tjera hetimore, siç është verifikimi i listëpagesave të dy punonjësve të kësaj shoqërie, shtetasit G. K. dhe V. C., si dhe instruktimi i tyre me rregullat e mbrojtjes në punë. Për më tepër, kur akti i ekspertimit teknik kishte përcaktuar se ndër shkaqet kryesore të shembjes së soletës ishte edhe mungesa e kontrollit të specializuar teknik, para e gjatë betonimit.

59. Kryerja e veprimeve hetimore, të tilla si verifikimi pranë organeve tatimore për të provuar punësimin e dy shtetasve, G. K. dhe V. C., pranë shoqërisë ndërtimore, si dhe verifikimin e dokumentacionit të kësaj të fundit mbi pajisjen me leje / licencë përkatëse për shërbimin e ofruar, ndihmon në evidentimin e ligjshmërisë në ushtrimin e aktivitetit të saj, në drejtim të punësimit të ligjshëm dhe deklaramit në institucionet tatimore të punonjësve të saj. Hetimi i plotë e vendosja e autorëve përpara përgjegjësisë duhen vlerësuar edhe në drejtim të parandalimit të këtyre praktikave në të ardhmen. Trupi gjykues edhe në këtë rast vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe vendimi i pushimit të procedimit penal është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C/6. Për masën e sigurimit personal ndaj shtetasve G. K. dhe I. S.

60. Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal, duke shfaqur mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, referuar pikës 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.
61. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke e konsideruar atë të pabazuar, me pretendimet se: (i) kërkesat për të dy të arrestuarit kanë qenë të argumentuara dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe provat e administruara deri në atë fazë të hetimit, dhe nuk shfaqin asnjë mangësi në aspektin e arsytimit ligjor; (ii) janë dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me gjetjet/prendimet për këtë çështje penale. Subjekti është munduar të qartësojë Komisionin për arsyet dhe argumentet e bazuara në ligj e prova deri në atë fazë të hetimit.
62. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve i dosjes lidhur me këtë procedim penal, konstaton dhe vlerëson si më poshtë:
- 62.1. Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se më datë 28.04.2020 është marrë njoftim se në ambientet e IEVP Peqin është plagosur me armë zjarri punonjësi i policisë, H. P. (jashtë rrezikut për jetën), i cili ka qenë ulur në një bordurë në oborrin e këtij institucioni. Pas marrjes së këtij njoftimi, është ngritur menjëherë grupi hetimor dhe janë kryer veprimet e para procedurale. Pavarësisht kontrollit të imtësishëm, nuk është bërë e mundur gjetja e ndonjë predhe armë zjarri ose copëza metalike të ngjashme, me të cilat mund të jetë dëmtuar punonjësi. Nga shpjegimet e disa punonjësve të policisë së burgut, është mësuar se në të njëjtën kohë janë dëgjuar të shtëna me breshëri, të cilat vinin nga kodra e fshatit Progër. Në atë çast, punonjësi i policisë, H. P., kishte shfaqur shqetësime dhe kishte lajmëruar kolegët që ishin me të. Nga hetimet ka rezultuar se në automjetin e z. G. K. është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një

automatik kallashnikov, si dhe një krehër pa fishekë. Me këtë armë, ai ka qëlluar dhe, nga këqyrja e vendit të ngjarjes, u gjetën dhe sekuestruan 15 copë gëzhoja.

62.2. Pas kërkesës së OPGj-së në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, më datë 29.04.2020, prokurori Neritan Hoxha merr vendimin për lejimin e përgjimit ambiental. Po kështu, i dërgon kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, “Për vleftësimin e vendimit për lejimin e përgjimit ambiental”, kërkesë e cila pranohet me vendimin nr. {***}, datë 30.04.2020.

62.3. Në procesverbalin e datës 29.04.2020, “Mbi veprimet e përgjimit ambiental të pjesshëm”, personi nën hetim G. K., i thotë personit tjetër nën hetim, z. I. S., që të deklarojë se ka qëlluar vetëm ai (G. K.), ndërkohë që I. S. thotë: *I gjuajta nja dy plumba*. Pas këtij deklarimi, G. K. vijon të thotë që të deklarojë që s’ka prekur armën me dorë ndonjëherë. Në vijim, shtetasi I. S. thotë: *“po ku i gjujtëm ne [...], ne kemi gjujt në ajër”*. G. K., në vijim të bisedave thotë: *“o vëlla, po kemi shti bashkë sa her o burr, kemi shti anej sa herë, për lepra sa herë”*. Personi nën hetim, G. K., më shumë se njëherë i thotë personit tjetër, I. S., *nesër do dalësh*. Në përgjimin ambiental përmendej që kanë qenë tre persona, duke përmendur emrin E., që në procesverbal theksohet me *bold*.

62.4. Subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, datë 30.04.2020, për veprat penale “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”, në formën e mbajtjes së armëve luftarake në ambientet publike/automjete, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, dhe “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, si dhe regjistrimin e personave nën hetim, G. K. dhe I. S.

62.5. Më datë 01.05.2020, subjekti i rivlerësimit i ka drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan kërkesën për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, për personin nën hetim, G. K., i dyshuar se ka konsumuar elementet e veprës penale “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “Arrest në burg”, si dhe vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për personin nën hetim, I. S., i dyshuar se ka konsumuar elementet e veprës penale “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal, si dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”.

Në këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *Në lidhje me masën e sigurimit për të arrestuarin G. K., i kërkojmë gjykatës që, duke marrë parasysh rëndësinë e faktit, sanksionin që parashikohet për këtë veprë penale (krim), rrezikshmërinë e personit (i dënuar më parë), mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe rrethanat personale e familjare të tij, ndaj tij, të arrestuarit G. K., duhet të caktohet si masë sigurimi ajo e “Arrestit në burg”, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, pasi çdo masë tjetër është e papërshtatshme. Të njëjtin arsyetim bën dhe për të arrestuarin tjetër, I. S., për të cilin ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”. Ndryshim i vetëm në arsyetimin e subjektit për dy të arrestuarit është që ky i fundit nuk ka qenë i dënuar më parë.*

62.6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 01.05.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 20.05.2020, ka vendosur miratimin e vendimit nr. {***}, datë 01.05.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për personin nën hetim, G. K.

62.7. Më datë 04.05.2020, subjekti i rivlerësimit paraqet përpara Drejtuesit të Prokurorisë, kërkesë “Për zëvendësimin si prokuror”, me arsyetimin se me urdhrin e datës 31.01.2020, të Drejtuesit, ishte krijuar “Seksioni i posaçëm”, i cili, midis të tjerash, kishte për kompetencë edhe hetimin e veprës penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal. Kjo kërkesë është pranuar nga Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin e datës 04.05.2020 dhe subjekti është zëvendësuar me një prokuror tjetër.

62.8. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se nga analizimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit nga subjekti, nuk janë analizuar kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230, për caktimin e masës së sigurimit personal, si dhe nuk janë analizuar dhe marrë në konsideratë të dhënat nga përgjimi ambiantal. Subjekti, me një paragraf të vetëm (i përsëritur për të dy shtetasit), pa analizuar rrethanat konkrete të secilit prej të dyshuarve, në mënyrë të përgjithshme ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” për G. K. dhe, për I. S. ka kërkuar “arrest në shtëpi”. Subjekti nuk rezulton të ketë analizuar se cilat kanë qenë arsyet që I. S. duhej t’i caktohej masa e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”. Duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin e masës së sigurimit penal, si dhe ka favorizuar I. S. në caktimin e masës së sigurimit.

62.9. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

62.9.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në vendimin nr. {***}, datë 01.05.2020, ka pranuar kërkesat e prokurorit, si për sa i përket vleftësimit si të ligjshëm të arrestimit të tyre, ashtu edhe caktimit të masave të sigurimit, sipas kërkimeve të prokurorit. Ky vendim është ankimuar nga i arrestuari, G. K., dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 20.05.2020, ka vendosur miratimin e tij. Materiali i transkriptuar i përgjimit ambiantal, së bashku me CD-në, janë përcjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan më datë 20.05.2020, me shkresën nr. {***} prot., kohë kur dosja hetimore ndiqej nga një prokuror tjetër. Në kushtet kur nuk ishte vënë në dispozicion transkriptimi i përgjimit, nuk mund të merrej në konsideratë në kërkesën drejtuar gjykatës.

62.9.2. Fakti penal ka ndodhur më datë 28.04.2020, gjatë pandemisë së COVID-19 dhe, për shkak të situatës së krijuar, nga Prokurori i Përgjithshëm është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 3, datë 19.03.2020, “Për disa masa procedurale në Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në funksion të parandalimit të përhapjes COVID-19”, ndër të tjera, me qëllim për marrjen e masave procedurale në funksion të parandalimit të përhapjes së COVID në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP). Fokusi i udhëzimit ka qenë marrja e masave për të parandaluar përhapjen e koronavirusit dhe një nga masat procedurale të fazës së hetimit paraprak ishte vlerësimi i kërkesave për të mënjanuar në maksimum futjen e personave nga jashtë në IEVP, si rrjedhojë e zbatimit të masës së sigurimit “Arrest në burg”. Në zbatim edhe të këtij udhëzimi, në rastin konkret për të arrestuarin I. S., duke analizuar rrethanat konkrete të veprës penale, rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit, provat e mbledhura deri në atë fazë të hetimit, kriteret e përcaktuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, përshtatshmërinë e masës me nevojën e sigurimit, si dhe sanksionin e veprës penale, është vlerësuar si masë më e përshtatshme ajo e “Arrestit në shtëpi”.

62.9.3. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se argumentet e tij në kërkesën e paraqitur në gjykatë janë gjetur në përputhje me ligjin dhe, në këto kushte, nuk qëndron pretendimi i Komisionit që,

subjekti i rivlerësimit ka favorizuar shtetasin I. S., në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij. Sipas subjektit, në qëndrimet e organit të akuzës, përveç rrethanave konkrete, merren në konsideratë edhe qëndrimet e prokurorëve dhe të gjykatës në çështje të ngjashme. Në mbështetje të këtij argumenti, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe qëndrime të prokurorëve të tjerë në kërkesat e paraqitura në gjykatë për masa sigurimi personale “Detyrim për t’u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore”, për veprën penale “Moskallëzimi i krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, si dhe vendimet përkatëse gjyqësore. Po kështu, subjekti sjell në vëmendje se Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 26.10.2020, ka caktuar si masë sigurimi personal “Arrest në shtëpi” ndaj të pandehurit G. K., i akuzuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, në formën e mbajtjes së armëve luftarake në ambiente publike / automjete, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, që parashikon një masë dënimi me burgim nga pesë deri në shtatë vjet. Pra, gjykata i ka caktuar të njëjtën masë sigurimi që subjekti i ka kërkuar gjykatës për veprën penale të moskallëzimit të këtij krimi, ndërkohë që Komisioni e “akuzon” se ka favorizuar personin nën hetim, I. S. Po kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 28.09.2020, ndër të tjera, ka zëvendësuar masën e sigurimit nga “Arrest në burg” në “detyrim për t’u paraqitur para OPGJ-së”, për të pandehurin G. K., vendim i cili është ndryshuar më vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës të cituar më sipër. Pra, gjykata ka caktuar një masë sigurimi edhe më të lehtë për veprën penale të parashikuar në nenin 278/1 të Kodit Penal, se ajo që kishte kërkuar subjekti për veprën penale të parashikuar në nenin 300 të Kodit Penal.

62.10. Trupi gjykues i Kolegjit, pavarësisht ecurisë gjyqësore të këtij procedimi penalvëren se konstatimet e Komisionit se subjekti i rivlerësimit, në kuptim të neneve 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka analizuar rrethanat konkrete të secilit prej të dyshuarve, por në mënyrë të përgjithshme ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” për G. K., dhe për I. S. ka kërkuar “arrest në shtëpi”, pa identifikuar rrethanat lehtësuese apo rënduese në nevojën e caktimit të këtyre masave të ndryshme, qëndrojnë. Subjekti i rivlerësimit duhet t’i kishte analizuar shprehimisht këto dispozita, të cilat përbëjnë bazën ligjore të caktimit të masës së sigurimit personal. Prokurori duhet të kishte analizuar nevojën për masë sigurimi, rrezikun e ikjes, pengimit të hetimit apo përsëritjes së veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të personit nën hetim, sjelljen para dhe pas kryerjes së saj, gjendjen familjare shoqërore dhe ekonomike të secilit prej tyre, si dhe çdo rrethanë tjetër lehtësuese apo rënduese, si dhe arsyetimin se përse çdo masë tjetër do të ishte e papërshtatshme, pra vlerësimin e proporcionalitetit mes masës së sigurimit dhe situatës faktike. Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionin se subjekti ka afektuar indikatorin e përcaktuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, sa i përket mangësisë në aspektin e arsytimit ligjor.

*C/7. Për procedimin penal nr. {***}, datë 18.11.2018, ndaj shtetasve A. P. dhe K. Ll.*

63. Komisioni nuk ka vlerësuar bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për këtë çështje penale, si sa i përket llojit të masës së sigurimit personal të kërkuar prej tij dhe mungesës së arsytimit ligjor në kërkesën drejtuar gjykatës për caktimin e saj, ashtu edhe kryerjes së veprimeve hetimore të nevojshme dhe mungesës së argumentimit të vendimit të pushimit të procedimit penal. Komisioni ka çmuar se *subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) Subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore. Në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht,*

subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. (ii) Vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni, në lidhje me këtë dosje penale, bazuar edhe në informacionin e administruar nga organet ligjzbatuese, vlerëson se veprimet e subjektit janë bërë me qëllim favorizimin e shtetasit A. P.

64. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit me pretendimet se:

64.1. Lidhur me masën e sigurimit personal ndaj të arrestuarit A. P., argumentet e subjektit të rivlerësimit janë gjetur në përputhje me ligjin nga gjykata, dhe pretendimi i Komisionit për favorizim nuk qëndron. Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka dhënë sqarime shteruese dhe bindëse, si dhe ka depozituar kërkesa të kolegëve prokurorë dhe të tijat, për raste të ngjashme.

64.2. Konkluzioni i Komisionit se subjekti, në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal, nuk ka analizuar kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, duke shfaqur mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, sipas nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, është sa i pabazuar në aktet e dosjes hetimore dhe në shpjegimet e provat e paraqitura nga subjekti, aq edhe dashakeqës e tendencioz, me qëllim për të deformuar të vërtetën.

64.3. Kërkesat për të dy të arrestuarit kanë qenë të argumentuara dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe provat e administruara deri në atë fazë të hetimit. Që ky vlerësim i prokurorit ka qenë i drejtë, është reflektuar më tej edhe në shqyrtimin në themel të kërkesave për të dy të arrestuarit.

64.4. Zbatimi korrekt i ligjit, në respektim të kërkesave ligjore, me përgjegjshmëri dhe në përputhje me provat e administruara deri në atë fazë të hetimit, nuk mund të quhet favorizim.

64.5. Komisioni e konsideron vendimin e pushimit të procedimit penal të cenueshëm, pa përcaktuar të cenueshëm nga cili, pasi gjykata, si organ i ngarkuar me ligj për kontrollin e veprimtarisë së prokurorit, e ka gjetur të drejtë kërkesën e subjektit, të bazuar në prova, duke e vlerësuar hetimin të plotë.

64.6. Konkluzionet e Komisionit janë të pabazuara, si në ligjin e aplikueshëm, ashtu edhe në provat e administruara. Nga Komisioni, në mënyrë të përsëritur nuk janë marrë në konsideratë argumentet dhe parashtrimet e subjektit, të detajuara, dhe në disa raste, edhe janë deformuar / shtrembëruar faktet apo keqinterpretuar provat dhe, si rrjedhim, Komisioni ka dalë në rezultate të gabuara apo të paragjykuara.

65. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

65.1. Më datë 16.11.2018, punonjësit e Sektorit të Shërbimeve të Specializuara “Shqiponja” pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan dhe specialistët e Seksionit të Hetimit të Narkotikëve dhe Trafiqeve, nga kontrolli i ushtruar në ambientet një lokali në lagjen “{***}” në qytetin e Elbasanit, i kanë gjetur dhe sekuestruar shtetasit A. P., në cilësinë e provës materiale,

dy paketime ambalazh plastik, me ngjyrë si të bardhë, që ngjasonte me lëndën narkotike kokainë, me një peshë 0,8 gramë, bashkë me ambalazhin. Nga kontrolli i kryer në ambientet e lokalit, në sirtarin e banakut ku punon K. Ll., është gjetur një mjet mprehës thikë me teh metalik, me dorezë me veshje plastike me ngjyrë të zezë, me këllëf. Në këto kushte, është bërë arrestimi në flagrancë i tyre; A. P. për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, dhe K. Ll. për veprën penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal.

65.2. Subjekti i rivlerësimit më datë 18.11.2018, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për këto dy vepra penale, si dhe emrat e personave nën hetim. Ndërsa të nesërmen, më datë 19.11.2018, i ka dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan kërkesën për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal. Në këtë kërkesë, arsyetohet se, *në lidhje me masën e sigurimit për të arrestuarin A. P. i kërkon gjykatës që, duke marrë parasysh rëndësinë e faktit, pavarësisht sanksionit që parashikohet për këtë veprë penale (krim), por referuar sasisë së vogël të lëndës narkotike, rrezikshmërinë e personit (i padënuar më parë), mënyrën e kryerjes të veprës, ndaj të arrestuarit A. P. duhet të caktohet si masë sigurimi ajo e “Detyrimit për t’u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K. Pr. Penale. Në lidhje me masën e sigurimit për të arrestuarin K. Ll., i kërkojmë gjykatës të marrë parasysh rëndësinë e faktit, sanksionin që parashikohet për këtë veprë penale (krim), rrezikshmërinë e personit (i padënuar më parë), mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës. Ndaj të arrestuarit K. Ll. duhet të caktohet si masë sigurimi ajo e “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, pasi çdo masë tjetër është e papërshtatshme.*

65.3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 21.11.2018, ka vendosur vleftësimin të ligjshëm të arrestimit në flagrancë, duke caktuar për të dy të arrestuarit masën e sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Në këtë vendim, citohet se: *Në lidhje me llojin e masës së sigurimit personal, që duhet të caktohet, gjykata vlerëson që ndaj të arrestuarit A. P. të caktojë si masë sigurimi, atë të kërkuar nga organi i procedimit, si masën më të përshtatshme deri në përfundim të hetimeve të kësaj çështjeje. Këtu gjykata ka në vëmendje edhe nenin 244/3 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilit: “Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori”. Për sa i përket llojit të masës së sigurimit që duhet për të arrestuarin K. Ll., gjykata vlerëson se atij duhet t’i caktohet jo masa e sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, por atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 K. Pr. Penale, si masën më të përshtatshme deri në përfundim të hetimeve të kësaj çështjeje, [...]. [...], marzhet e dënimit për veprën penale që dyshohet se ka kryer i arrestuari K. Ll., si dhe faktin që brenda të njëjtit procedim, për njërin të arrestuar organi i procedimit kërkon caktimin e masës së sigurimit personal parashikuar nga neni 234 i K. Pr. Penale, me marzhe dënim në minimum 5 vjet burg, ndërsa vepra që dyshohet i arrestuari K. Ll. parashikon dënim në minimum 1 vit burgim”.*

Gjykata konstaton se në arsyetimin e tij prokurori nuk ka analizuar në mënyrë ezauruese e reale motivet konkrete, nuk ka kryer një analizë të shkaqeve se përse çdo masë tjetër sigurimi është e papërshtatshme, pasi sikurse shihet qartë ai ka bërë një përshkrim ritual e formal të shkaqeve e kritereve të parashikuara në ligj. Masa e “Arrestit në burg”, për rrethanat konkrete të kësaj

ngjarje, vendoset përjashtimisht kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të autorit.

65.4. Komisioni, nga analizimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit personal ka konstatuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë analizuar kushtet dhe kriteret parashikuar nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, por është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal në mënyrë formale, të përgjithshme, me një paragraf, pa analizuar rrethanat konkrete të secilit prej të dyshuarve. Për këtë arsye, Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit se: “[...], duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin e masës së sigurimit penal, si dhe ka favorizuar shtetasin A. P. në caktimin e një mase sigurimi dukshëm më të lehtë”.

65.5. Në prapësimet mbi këtë rezultat hetimi, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se konstatimet e Komisionit qëndrojnë pjesërisht, por konkluzionet janë të gabuara, të pambështetura në aktet e dosjes penale. Më konkretisht, ai ka shpjeguar se:

65.5.1. Në lidhje me masën e sigurimit personal për të arrestuarin A. P., nga subjekti i rivlerësimit janë vlerësuar në mënyrë shteruese argumentet që janë marrë në konsideratë prej tij, në kërkesën e paraqitur në gjykatë për caktimin e masës së sigurimit, të cilat janë gjetur në përputhje me ligjin edhe nga gjykata dhe, për pasojë, nuk qëndron pretendimi i Komisionit që, në caktimin e masës së sigurimit personal, nga subjekti është favorizuar ky i arrestuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vlerësuar se kërkesa e prokurorit për këtë masë sigurimi është e bazuar, si masa më e përshtatshme për t’u caktuar dhe e ka miratuar atë. Sa i përket citimit të nenit 244/3 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka shpjeguar se gjykata thjesht e ka sjellë në vëmendje këtë dispozitë, por nuk ka analizuar apo arsyetuar se, në rastin konkret nevojat e sigurimit do të ligjëronin një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, por përkundrazi e ka gjetur atë të drejtë dhe të përshtatshme.

65.5.2. Kërkesa për këtë masë sigurimi është diktuar për shkak të sasisë së lëndës së dyshuar deri në ato momente si lëndë narkotike, pasi siç dhe ka pranuar gjykata në vendimin e saj, nuk ishin administruar ende aktet e ekspertimit që të konfirmonin lëndën narkotike. Sipas subjektit, në qëndrimet e organit të akuzës merren në konsideratë edhe qëndrimet e prokurorëve dhe të gjykatës në çështje të ngjashme, duke vënë në dispozicion praktika të tilla për masa sigurimi për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, si dhe vendimet përkatëse gjyqësore. Duke pasur parasysh se personat janë arrestuar në datën 17.11.2018 dhe hetimet kanë zgjatur mbi gjashtë muaj, nëse do të ishte kërkuar caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe në fund të kërkohej pushimi i akuzës, do të kishte pasojë për personin nën hetim dhe besimin e tij / familjarëve të drejtësia, pa llogaritur koston financiare për kompensim për burgim të padrejtë.

65.5.3. Në vijim të prapësimeve, subjekti shprehet se vërtet gjykata në arsyetimin e saj i referohet marzheve të dënimit për të dy veprat penale, por ka harruar që neni 283/1 i Kodit Penal parashikon edhe mundësinë e përjashtimit të subjektit të veprës penale nga përgjegjësia penale, nëse mban doza të vogla për përdorim vetjak, siç dhe u arrit në përfundim të hetimit. Ndryshe nga situata ligjore e faktike e shtetasit K. Ll., që nuk linte vend për diskutim, pasi ai kishte pranuar mbajtjen e thikës, e cila dukshëm plotësonte elementet e armës së ftohtë, e konfirmuar

nga akti i ekspertimit teknik, situata për shtetasin A. P. nuk ishte e qartë, pasi nuk ishin administruar aktet që do të përcaktonin nëse lënda e dyshuar ishte kokainë, sa ishte pesha pa ambalazh, si dhe do të përcaktohej nëse i arrestuari ishte përdorues i kësaj lënde, për të konkluduar nëse sasia e lëndës së sekuestruar konsiderohej dozë për përdorim vetjak apo jo. Për sa i përket konstatimeve të tjera të Komisionit, në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale është sanksionuar parimi i prezumimit të pafajësisë dhe çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.

65.6. Trupi gjykues i Kolegjit në analizë të shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në raport me konkluzionin e vendimit të Komisionit për këtë procedimi penal, konstaton se në aktet procedurale, të tilla si urdhri i regjistrimit të procedimit penal dhe kërkesa për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë rrethanat e ngjarjes, ashtu si referuar në raportin e shërbimit të Drejtorisë së Policisë. Më saktësisht, në aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, thuhet se: *Shtetasi A. P., në momentin që kanë hyrë punonjësit e policisë, ishte i ulur në tavolinë me shtetasit G. Th., banor i qytetit të Elbasanit.* Ndërkaq, në raportin e shërbimit të datës 16.11.2019, të përgatitur nga efektivet e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, përshkrimi i ngjarjes tregon se shtetasi A. P. ishte ulur në tavolinë, ashtu si përshkruar nga subjekti, por sapo forcat e policisë kanë hyrë në ambientin e lokalit, ai ka shkuar në banjë dhe ka mbyllur derën nga brenda. Në këto kushte, forcat e policisë kanë tentuar ta hapin derën me forcë. Pas hapjes së derës së banjës, është konstatuar se ai ishte i veshur dhe në krahun e majtë të tualetit, në tokë, u konstatuan dy qese me pluhur, të dyshuar si lëndë narkotike e llojit kokainë. Këtë konstatim, Komisioni e ka pasqyruar si në rezultatet e hetimit administrativ, ashtu edhe në vendim, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi ta ketë kundërshtuar apo shpjeguar. Subjekti i rivlerësimit duhet të kishte analizuar edhe elementet që lidhen me faktin se i arrestuari mund të ketë pasur më shumë se dy dozat e gjetura, për sa kohë nuk kishte shkuar për nevoja personale, duke ngritur dyshimin se ka pasur mundësinë për të asgjësuar një pjesë të lëndës narkotike.

65.7. Nga analizimi i kërkesës për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal, trupi gjykues gjen të drejtë konstatimin e Komisionit në vendim, se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, por është mjaftuar formalisht me një paragraf në të cilin nuk arsyetohen kushtet dhe kriteret që do të mbështetnin caktimin e masës së sigurimit personal të kërkuar. Lidhur me shtetasin A. P., subjekti i ka kërkuar Gjykatës caktimin e masës e sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore”, duke marrë parasysh rëndësinë e faktit, *pavarësisht sanksionit që parashikohet për këtë veprë penale (krim)*, referuar sasisë së vogël të lëndës së dyshuar narkotike, rrezikshmërinë e personit (i padënuar më parë), mënyrën e kryerjes së veprës penale. Ndërsa, për të arrestuarin K. Ll., i ka kërkuar Gjykatës caktimin e masës së sigurimit personal të “Arrestit në burg”, duke marrë parasysh rëndësinë e faktit, *sanksionin që parashikohet për këtë veprë penale (krim)*, rrezikshmërinë e personit (i padënuar më parë), mënyrën e rrethanat e kryerjes së veprës. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, përveç faktit që nuk arsyeton kërkesën e tij, sipas dispozitave procedurale, bën një diferencim në kërkesën e tij, ku për shtetasin A. P., nuk i referohet sanksionit të parashikuar nga Kodi Penal për veprën penale për të cilën dyshohet. Diferencimi mes dy të arrestuarve dhe veprave penale për të cilat ato janë ndaluar, është evidentuar edhe nga Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Elbasan, gjatë kontrollit gjyqësor, e cila në vendimin e saj, ashtu si cituar më sipër, shprehet se Prokuroria kërkon caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për veprën penale me marzhe dënimi, në minimum 5 vjet burg, ndërsa vepra që dyshohet i arrestuari K. Ll. parashikon dënim në minimum 1 vit burgim. Përmendja e nenit 244/3 të Kodit të Procedurës Penale nga Gjykata në vendim, ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti, nuk ka qenë thjesht për ta sjellë këtë dispozitë në vëmendje. Në vlerësim të trupit gjykues, për vetë pozicionimin e saj në arsyetimin e vendimit, logjikisht lexohet dhe vlerësohet ndryshe. Citimi i kësaj dispozite është bërë pikërisht për të treguar pamundësinë e gjykatës për të vendosur një masë sigurimi personal më të rëndë nga ajo që ka kërkuar subjekti i rivlerësimit për të arrestuarin A. P.

65.8. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit, sipas së cilit, depozitimi nga subjekti i rivlerësimit i kërkesave për caktimin e masës së sigurimit personal të prokurorëve të tjerë⁵⁴, nuk mund të merren në analogji, pasi rastet nuk janë asnjëherë të ngjashme. Subjekti në ankim pretendon se rastet mund të mos jenë të ngjashme, por arsyeja kryesore e depozitimit të tyre është për të provuar se masa e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” nuk është mbajtur vetëm për të arrestuarin A. P., dhe se në këtë rast, është marrë në konsideratë pikërisht sasia e lëndës së dyshuar si narkotike. Nga analizimi i këtyre kërkesave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se rrethanat faktike dhe ligjore të çdo çështjeje penale ndryshojnë. Pothuajse në të gjitha këto kërkesa, lloji i lëndës narkotike ka qenë kanabis, ndaj dhe masa lëndës ka rezultuar më e madhe se ajo objekt shqyrtimi, ndërsa në rastet që lënda narkotike e dyshuar ka qenë kokainë, masa ka qenë më e vogël se ajo e çështjes në shqyrtim. Për pasojë, këto elemente të ndryshme e bëjnë të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

65.9. Pas kësaj faze procedurale, deri në momentin e paraqitjes në gjykatë të kërkesës për pushimin e akuzës për personin nën hetim, A. P., trupi gjykues konstaton se:

65.10. Sipas aktit toksikologjiko-ligjor nr. {***}, datë 30.11.2018, mbi ekspertimin toksikologjik të urinës së shtetasit A. P., nga ekspertët u arrit në përfundimin se: *Në urinën e shtetasit A. P. [...] u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës (benzoilekgonina) në organizmin e njeriut, pas përdorimit të saj. Rezultati i analizës ka vlerë vetëm për momentin e ndalimit.*

65.11. Referuar aktit nr. {***}, datë 18.01.2019 të Institutit të Policisë Shkencore, *analiza me GC/MS për pluhurat, objekt ekspertimi treguan për praninë e kokainës. Peshë e pluhurave pa ambalazh në total është 0.539 gramë.*

⁵⁴ -- Procedimi nr. {***}, viti 2018, kërkuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur para OPGj-së” për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal (peshë 0,2 gramë me ambalazh, lënda e dyshuar, kokainë), miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. {***}, datë 22.09.2018. -- Procedimi nr. {***} viti 2018, kërkuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur para OPGj-së” për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal (peshë 7,3 gramë me ambalazh, lënda e dyshuar, kanabis), miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 28.12.2018. -- Procedimi nr. {***}, viti 2018, kërkuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur para OPGj-së” për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal (peshë 8,5 gramë me ambalazh, lënda e dyshuar, kanabis), miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. {***}, datë 28.10.2018; Çështjet e ngjashme të subjektit të rivlerësimit. -- Procedimi nr. {***}, viti 2018, kërkuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur para OPGj-së” për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal (peshë 7,3 gramë me ambalazh), miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. {***}, datë 28.12.2018.

65.12. Më datë 04.02.2019, subjekti i rivlerësimit merr vendimin për caktimin e ekspertit toksikologjiko - ligjor (klinikist), të cilit i kërkon të përgjigjet për pyetjen: *Sasia prej 0.539 gramë e lëndës narkotike kokainë, e sekuestruar më datë 17.11.2018, a mund të konsiderohet dozë për përdorim vetjak për shtetasin A. P.?*

65.13. Në aktekspertizën adiktologjike dhe toksikologjike klinike nr. {***}, datë 20.05.2019 për shtetasin A. P., eksperti shprehet se: *midis detajeve anamestiko-klinike mund të evidentojnë se shtetasi A. P. [...] ka një karrierë në abuzimin substancor. [...], individi në shqyrtim mendoj se plotëson kriteret diagnostike të vartësisë substancore, sipas DSM-IV (varësi psikologjike)*. Pas një përshkrimi teorik, të karakteristikave të vartësisë, eksperti në fund të akt-ekspertizës shprehet se: *Mendoj, si mjek toksikolog-adiktolog klinik, se: sasia prej 0.539 gramë lëndë drogë kokainë me prekursor është dozë për përdorim vetjak, i menjëhershëm, pa shkaktuar dëme serioze për jetën e një përdoruesi të lëndës drogë, kokainë*.

65.14. Në përfundim të hetimeve, prokurori më datë 25.06.2019 i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}, datë 18.11.2018 ndaj të pandehurit K. Ll., i akuzuar se ka kryer veprën penale të “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, e parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal, si dhe pushimin e hetimit/akuzës ndaj personit nën hetim, A. P., për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 16.09.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë.⁵⁵

65.15. Në kërkesën për pushimin e hetimit/akuzës ndaj personit nën hetim A. P., subjekti i rivlerësimit, pasi ka paraqitur rezultatet e akteve të ekspertimit të kryera në këtë çështje të përmendura më sipër, i është referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 27.03.2008, lidhur me përcaktimin nëse sasia e lëndës narkotike konsiderohet “dozë e vogël” për përdorim vetjak, për efekt të përjashtimit nga përgjegjësia penale.

65.16. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni shprehet se akti i ekspertimit adiktologjik dhe toksikologjik nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në vendimin unifikues, pasi nuk i referohet individit konkret A. P., si dhe nuk ka asnjë përshkrim të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së varësisë së personit konkret. Sipas Komisionit, subjekti duhet të kërkonte një akt të ri ekspertimi, në përmbushje të kërkesave të vendimit unifikues. Po ashtu, ndër të tjera, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka ripyetur shtetasin A. P. për të dhënë deklaramë të plota, duke marrë në konsideratë faktin se ai ka deklaruar se nuk është përdorues i rregullt i lëndëve narkotike dhe ka mohuar faktin se lënda ishte tij apo e kishte për përdorim personal. Për sa më sipër, Komisioni i ka kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit se: *Duket se vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara.*

65.17. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, nisur nga përmbajtja e aktit të ekspertimit toksikologjiko-adiktologjik, nuk qëndron konstatimi i Komisionit se ky akt nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në vendimin unifikues. Referuar vendimit unifikues, dozë e vogël për efekt përjashtimi nga përgjegjësia penale konsiderohet sasia e lëndës

⁵⁵ Kjo gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 09.03.2020, vendosi deklarinimin fajtor të pandehurit K. Ll. (Ll.), për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim. Vendim ka marrë formë të prerë.

apo substancës narkotike e psikotrope që ajo përmban si e tërë; përcaktimi nëse sasia është dozë e vogël për përdorim vetjak bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës së toksikologjisë, si dhe duhet të mbahen parasysh edhe rrethanat faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës narkotike apo psikotrope në momentin e gjetjes së saj. Fakti që ky person ishte përdorues i lëndës narkotike vërtetohet nga akti i ekspertimit toksikologjik nr. {***}, datë 30.11.2018, sipas të cilit rezultoi se në mostrën urinare të tij u zbulua prania e produkteve të metabolizimit të kokainës (benzoilekgonina) në organizimin e njeriut, pas përdorimit të saj. Nga hetimi, sipas subjektit, rezultoi se nuk ka asnjë provë që të vërtetojë ose të paktën të ngrihen dyshime se personi nën hetim, A. P., sasinë prej 0.539 gramë kokainë që i është gjetur dhe sekuestruar, ta ketë mbajtur me qëllim për të kryer veprime të tjera që parashikon ana objektive e veprës penale për të cilën hetohet. Ai ka mbajtur sasi lëndë narkotike për përdorim vetjak, ishte përdorues i kësaj lëndë, dhe ligjvënësi e ka përjashtuar nga përgjegjësia penale, për këto arsye, ky shtetas nuk mund të akuzohet e merret i pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

65.18. Nga analiza e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pushimin e hetimit/akuzës për personin nën hetim, A. P., akteve të ekspertimit, të vlerësuara në raport me arsyetimin dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 1, datë 27.03.2008, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, në kushtet kur në aktin e ekspertimit nuk është bërë përshkrimi i cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë të personit konkret, si një nga elementet e kërkuara nga vendimi unifikues. Në vendimin unifikues Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë çmuar ndër të tjera se: “[...] përcaktimi i dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë, etj.), të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti, jo vetëm sipas llojit të lëndës narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë nga droga të personit konkret – mbajtës i lëndës narkotike dhe psikotrope”. Në aktin e ekspertimit adiktologjik dhe toksikologjik klinike, të cituar më sipër, në këtë vendim, nuk rezultojnë të jetë përcaktuar përshkrimi fiziko-biologjik dhe shkalla e varësisë së personit konkret, për më tepër, në kushtet kur ky person në deklaratimet para OPGj-së më datë 17.11.2018, kishte deklaruar se nuk kishte lidhje me qeset me lëndë narkotike të gjetura, dhe pyetjes nëse ishte përdorues, i ishte përgjigjur se konsumonte me shoqërinë *cigare hashash*, si dhe, me raste ka provuar edhe lëndë narkotike të llojit kokainë; hera e fundit që e kishte konsumuar ishte para 20 ditësh.

65.19. Në dritën e rrethanave të kësaj çështjeje penale, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se kërkesa për pushimin e akuzës ndaj A. P. është e paargumentuar dhe se konkluzionet e arritura mbështeten në të dhëna të paverifikuara. Trupi gjykues, ndryshe nga sa pretendon subjekti, në analizë të vendimit të Komisionit, konstaton se ky i fundit ka arsyetuar gjerësisht pse nuk i ka gjetur bindëse shpjegimet e subjektit dhe përse nuk i ka vlerësuar të tilla, që të përmbysin barrën e provës. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij nuk është shterues, referon një pjesë të aktit të ekspertimit dhe nuk i jep përgjigje faktit se pse në të nuk ka asnjë përshkrim të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së varësisë së personit, sikundër kërkohet nga vendimi unifikues dhe sikundër i ishte kaluar barrë prove nga Komisioni.

65.20. Pa u futur në interpretimin apo në analizën se si i çmon faktet dhe rrethanat prokurori / subjekti, në drejtim të caktimit të masave të sigurisë apo pushimit të çështjes, trupi gjykues i vlerëson të drejta konstatimet e Komisionit. Zgjidhja në themel e fatit të procedimit penal, e cila ka çuar në një vendimmarrje drejt pushimit të çështjes penale, vjen si produkt i këtyre të metave

procedurale apo dhe materiale, të cilat kanë çuar në një vendimmarrje të tillë. Për sa parashtruar më lart, moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, mënyra jo e saktë e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit personal dhe të pushimit të akuzës, afektojnë indikatorët e parashikuar në nenin 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016..

66. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke e konsideruar atë të pabazuar në ligjin e aplikueshëm, në provat e administruara, si dhe në shpjegimet e dhëna prej tij. Subjekti sjell në vëmendje se, në kuptim dhe zbatim të nenit 4, pika 2, në raport me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka zhvilluar një praktikë të konsoliduar mbi rastet kur aplikohen këto dispozita dhe kur subjektet gjenden në kushtet e cenimit të besimit të publikut. Në rastin konkret, sipas tij, duke mos rezultuar i provuar asnjë rast, që potencialisht mund të ketë konfiguruar shkelje të atij intensiteti, saqë të ketë cenuar apo tronditur besimin dhe opinionin publik, e bën konkluzionin e Komisionit tërësisht të pabazuar, për aplikimin e këtyre dispozitave ligjore.

66.1. Trupi gjykues i Kolegjit, nga shqyrtimi i vendimit objekt shqyrtimi, por edhe në mbështetje të analizës më sipër në këtë vendim, çmon të bazuar konkluzionin e arritur nga Komisioni, i cili me të drejtë ka konstatuar se në disa nga këto procedime penale, subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore, që tregojnë mungesë të aftësive të tij profesionale. Nga analizimi i çështjeve për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga 289 i Kodit Penal, u konstatua mungesë veprimesh të plota hetimore dhe vendime mosfillimi/pushimi të paarsyetuara, sipas Kodit të Procedurës Penale. Në disa procedime penale, që ka pasur vdekje ose dëmtim të rëndë të punonjësve, hetimi nuk ka qenë i plotë, në mungesë aktesh ekspertimi, duke treguar që subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur mjaftueshëm për të zbardhur të vërtetën, që afekton, për pasojë, mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Ashtu siç konkludon edhe Komisioni, rezulton se në vend që të respektoheshin parimet dhe vlerat/standardet më të larta të Prokurorisë, të cilat përfshijnë detyrimin për të ndërmarrë veprime dhe për të pasur një rol aktiv në zbulimin e së vërtetës dhe për të respektuar, mbrojtur dhe mbështetur dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut, është shfaqur neglizhencë e vazhdueshme në një seri të qartë dhe të vazhdueshme vendimesh.

67. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vlerësoi se, për shkak të mangësive të konstatuara në çështjet e analizuara në vendimin objekt shqyrtimi, në kuadër të këtij kriteri, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti ka reflektuar njohuri dhe gjykim të dobët në mënyrë të përsëritur, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016. Mangësitë e konstatuara u morën në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
68. Për sa më sipër, trupi gjykues, duke analizuar problematikat për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe mangësitë në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, arrin në përfundimin se në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61 pika 5, e po këtij ligji.
69. Në përfundim, trupi gjykues në Kolegji, mbështetur në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për

kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për pasojë, çmon se vendimi nr. 786, datë 18.07.2024, i Komisionit, është i drejtë, i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 786, datë 18.07.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 21.01.2026, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi